

79
06.08.2025



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



**Ekstrakti nga procesverbali, i-IV, i Kuvendit të Komunës, i mbajtur më datën 08.05.2025,
ora 10:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës.**

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Miranda Shabani, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Artan Asllani, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtori të Drejtive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkyrytar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtës për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtës për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtës për Infrastrukturë, Ardit Sekiraça - Drejtës për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtës për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donat Zharku-Drejtës për Inspektoriat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 03.04.2025.
2. Propozim për fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Propozim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pjesën urbane në Fushë-Kosovë.
4. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
5. Informatë për shpenzimin e buxhetit janar - mars 2025.
6. Informatë për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.
7. Informatë për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Materialin e keni marrur me kohë. Kjo është seanca e katërt e vitit 2025, me këtë rend të ditës. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës dhe i përshëndes dhe i falënderoj mediat te cilat janë prezentë sot në këtë seancë, kemi televizionin e RTK-së dhe Betimin për

Drejtësi, po ashtu i falënderoj të gjithë të pranishmit tjerë te cilët janë sot këtu me ne në këtë seancë. Unë pyes, a ka dikush ndonjë propozim sa i përket rendit të ditës?

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, kërkoj nga ju që ta futeni në rend të ditës piken shtesë e cilën ka ardhur nga Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, sepse na ka ardhur një projekt nga KEDS-i për një trafo, në lagjën ku banojmë ne komunitetet dhe kemi vazhdimisht probleme me energji elektrike dhe në këtë propozim një tokë bartet në emër të KEDS-it për vendosjen e trafos. Për sqarime tjera besoj do dal drejtori dhe do ta elaboroi.

Etnik Berjani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Dua që ta ndaj me ju një rast shumë të rëndë që ka ndodhur sot në fshatin tonë, ku një qytetar i komunës sonë Fidan Reqica, ka pasur një aksident të rëndë në vendin e punës e i cili është djegur me një materie të rrezikshme afér 80% e trupit. Në këto momente të rënda ai dhe familja e tij më shumë se kurrë, kanë nevojë për mbështetjen e komunitetit dhe institucionit. Prandaj, propozoj që Kuvendi Komunal të ndaj një shumë të mjeteve financiare prej 5000€, që sado pak ti ndihmoj për shërim.

Mirsad Qyqalla: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në Komitetit për Politik dhe Financa na ka njoftuar dje Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis për pikën shtesë, të cilën po e kërkon edhe kolegu z. Bashkim Krasniqi. Unë kërkoj nëse ka mundësi deri sa të vijë koha për votimin e kësaj pike, të na sjellin material shtesë për vendosjen e saj, meqenëse kjo është pronë komunale. Ndërsa sa i përket pikës të cilën e propozoj kolegu z. Etnik Berjani për ndihmë financiare, për një qytetar të fshatit Miradi, së pari uroj që të shërohet sa ma shpejt, ne nuk jemi kundër mirëpo vazhdimisht kemi kërkuar që për rastet të cilat kanë nevojë për ndihmë nga komuna, ta bëjmë një tregulllore ose një marrëveshje sepse raste kështu siç po kërkoni ju ka edhe shumë të tjera dhe sipas ekzekutivit është problem më ju dal në ndihmë të gjithëve. Dikujt jo dhe dikujt po, e kemi vështir andaj kërkoj mos të na vendosni në këtë situatë.

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Të nderuar kolegë, media, nënkyrjetar, drejtorë dhe ju të gjithë të pranishmit. Na erdh një pikë shtesë e cila thuhet se është urgjente, për vendosjen e një trafoje, në lagjen 028. Ne për këtë pikë shtesë e kemi vetëm një propozim, mungon fleta poseduese dhe kopjen e planit në të cilën do të jepet prona komunale për vendosjen e kësaj trafoje. Po ashtu nuk e dimë hapësirën, nëse ne e votojmë këtë pronë, prona do të dalë në pronësi të KEDS-it, sepse ashtu ka vepruar edhe tek ndërtesa ime. I nderuari z. Bashkim Krasniqi, pasi që kjo është në lagjen tënde, është dashur që të na e sjellni edhe materialin përcjellës, sa është sipërfaqja aty? Sa merr KEDS-i? që ne ta dimë se çka po votojmë.

Durim Hajra: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Të nderuara media, ndoshta i shpeshton këto ardhjet e juaja sepse Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës, transparencën e ka shumë të ulët. I nderuar Kryesues gjatë gjithë mandatit kemi diskutuar, që pikat të cila arrijnë jashtë rendit të ditës, e të cilat propozohen aty për aty, me martë parasysh ligjin dhe ta kem parasysh urgjencën. Tek pika shtesë të cilën e propozoji kolegu ynë z. Etnik Berjani, këtu nuk ke çka të diskutosh, sepse është urgjente, është aksident dhe ka nevojë. Besoj që në parim të gjithë e mbështesim. Sa i përket propozimit të cilit dje na ka ardhur në Komitetit për Politik dhe Financa, po më duket e çuditshme që doli kolegu z. Bashkim Krasniqi, kjo u deshtë me u përgatiti dhe vijë në kohë me

pikat e rendit tē ditës, sepse këtu ka qenë edhe një petition pér këtë çështje. Ne jemi dakorduar që vetëm pikat te cilat janë urgjencë ti futim në rend tē ditës, ndërsa unë urgjencë tek kjo pikë nuk po shoh. Si propozim nuk është i përgatitur si duhet dhe nuk mundemi tē marrim një vendim që ta japim në shfrytëzim, një parcelë, një operatori privat kur kjo pronë është pronë komunale dhe duhet tē specifikohet sa ari është parcela. Nëse një petition tē cilin e kanë bërë banorët e juaj dhe nuk ka mundur tē hyjë as në rend dite si formë e rregullt, sinqerisht ndoshta është e fundit që mundet me u kërkua mbështetje në këtë rast nga kolegët e juaj, me keqardhje prej opozitës. Kjo po tregon se ju nuk keni partneritet tē mirëfilltë. Nëse ka qenë urgjencë është dashur që bashkërisht Kryetari i Komunës me Kryesuesin e Kuvendit ta fusin në rend dite këtë pikë. Prapë po e them nëse kjo pikë kishte qenë e përgatiten mirë, propozimi, skica, sa ka me qen hapësira që ka me u dhënë shfrytëzim. Por, në aspektin parimor nuk e mbështesim këtë pikë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Drejtor a ke mundësi me dal dhe me na svarua pikën, sepse unë kam një rregullore ku neni 20 thotë: "Secili anëtar i Kuvendit, ka tē drejtë në seancë, me ngritë një çështje, me sjellë si pikë tē rendit tē ditës dhe atë çështje Kryesuesi i Kuvendit duhet ta vlerësoj, a është urgjente apo nuk është urgjente dhe a është në shërbim tē publikut. Nëse është urgjente dhe është në shërbim tē publikut kryesuesi e hedh në votim".

Unë sa kuptova në Komitetin pér Politik dhe Financa, KEDS-i do tē financoj vet, pa e dëmtuar buxhetin e Komunës së Fushë Kosovës.

Unë po ashtu kam shumë kërkesa tē ndryshme pér ndihmë financiare pér shërim dhe janë urgjente. Unë i kam diskutuar me Kryetarin e Komunës këto kërkesa qe tri vite radhazi, por nuk i kemi sjellë në Kuvend fare, pér arsy se ne kemi një komision i cili ndan vlera deri në 2000€, nga subvencionet pér rastet e tillë. Po ashtu Kryetari i Komunës ma ka thënë në mënyrë decidive, që është e pamundur me pa këtë derë përmes Kuvendit dhe dikujt me i ndihmua dhe dikujt mos me i ndihmua sepse nuk ndihem mirë. Me datën 22.05.2025, do tē thërras seancën e rregullt në tē cilën jemi dakorduar me grupet. I kam dy kërkesa te cilat janë urgjente dhe do ti fus si pika tē rendit tē ditës. Është mirë si shefa me marr një pauzë dhe më u dakorduar. Unë si Kryesues i Kuvendit tē Komunës jam dakord vetëm se a kemi mijete pér secilin qytetar që ka nevoja tē tillë.

Laureat Gojnovci: Të nderuar, pasi që dy pikat e propozuar ishin nga kolegët dhe ne jemi dakorduar që mos tē sjellim pika tē rendit tē ditës, kërkoj një pauzë prej 30 minutave që tē dakordohemi me subjektet e tjera politike. Po ashtu edhe pér materialin tē cilin e kërkojnë pér vendosjen e trafos në lagjen 028, e lusë Drejtorin përkatës që gjatë kësaj pauze, tē na e sjell materialin.

Durim Hajra: Nuk po e kuptoj pse me marr pauzë, këtë praktik nuk e kemi pasur as më herët, ne jemi dakorduar që vetëm pikat tē cilat janë urgjente tē sjellën në kuvend. Po më bëni tē dyshoj që keni fobi prej mediave. Propozojmë që tē vazhdoj seanca.

Mirsad Qyqalla: I nderuar Kryesues i Kuvendit, unë nuk kam çka t'i shtoj pikës tē cilën e sjelli asamblistit z. Bashkim Krasniqi, sepse kjo pikë është e pakompletuar. Nuk është në rregull me na vendosë në këtë pozicion. Nuk po kuptoj pse me marr pauzë, kur e gjithë ajo çka diskutohet në këtë pauzë duhet prapë me ardhur dhe me thënë në Kuvend. Mendoj që tē gjithë atë çka duhet ta themi mund ta themi në foltore.

Hasan Ismajli: Sa i përket pikës të cilën e propozoj kolegu z. Bashkim Krasniqi, unë në diskutim me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, pash që e kishte një skicë, por atë skicë e mbanë vetëm për vete, jo edhe për ne asamblistët. Prandaj unë nuk shoh arsyen që të merret pauzë, kur këta kanë pasur mundësi të na pajisin edhe neve me material përkatës, sepse materialin e kanë, printer kanë dhe kanë munduar të na pajisin me kopje të planit, fletën poseduase dhe grafikën. Ne këtu nuk kemi çka të bisedojmë sepse nuk kemi material dhe nuk dimë se çka të votojmë. Ndërsa sa i përket propozimit të kolegut z. Etnik Berjani, i nderuar më vjen shumë keq për rastin të cilin ka ndodhur banorit të Komunës sonë, e i cili e paska gjendjen shumë të rëndë, por këtu ne kemi pasur shumë raste dhe një prej tyre e kam propozuar edhe unë, për ish kolegun tonë të ndjerë Hasan Krasniqin, i cili ka qenë me sëmundjen e kancerit, ku ka qenë edhe deputet i dy mandateve të mëhershme, punëtor shëndetësor dhe kërkesa ime ka hasur në vesh të shurdhër pikërisht nga ju. Unë në mbledhjen e ardhshme do t'i sjell edhe tri kërkesa të kësaj natyre.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Mendoj se nuk ka asgjë të keqe nëse shkojmë me një pauzë prej 10 minutave dhe dakordohen shefat e grupeve parlamentare.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çoi në votim se kush është për një pauzë prej 10 minutave.

U votua me: katërmëdhjetë për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan pauzën prej 10 minutave.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në zyrën time prezantuan, anëtarët nga komuniteti, pa asamblistën znj. Qëndresa Ademi po ashtu pa opozitën. Ne atë të cilën e patëm për ta diskutuar e diskutuam dhe për të na e sqaruar i'a kaloj fjalën Nënkryetarit të Komunës.

Nënkryetari i Komunës: I nderuar Kryesues i Kuvendit, të nderuar anëtar të Kuvendit Komunal, të nderuar pjesëmarrës, meqenëse siç u tha të dy propozimet ishin nga pjesa e opozitës, njëri për shkak të aksidentit të cilit i ka ndodhur, ne patëm nevojë që të akordohemi. Ne sjellim një propozim që pika e rendit të ditës, që ka të bëjë me ndihmën financiare të tërhiqet, si propozim. Po e bëjë unë tërheqjen dhe po e marr unë atë pjesën e dëmit politik dhe kërkoj që të mbetet si propozim vendosja e trafos në lagjen 028, për shkak që të prezikon që të humb një donacion, i cili nuk është i sigurt se do të mbetet në vijim. Ky është një propozim të cilin mundemi me e sjell para pauzës për të ruajtur qëndrueshmërinë e këtij kuvendi.

Hasan Ismajli: Nënkryetar a mundesh me na tregu arsyen pse e tërhoqët pikën të cilën e propozoi asamblisti z. Etnik Berjani?

Nënkryetari i Komunës: Po jap një sqarim, në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve deri në shumën 2000€, i takon pjesës së ekzekutivit, ne mund ta ndihmojmë sepse ka mjete në drejtorin përkatëse dhe mundemi sa do pak ti gjendemi në këtë situatë të rëndë me të cilën është familja. Pastaj ju do të keni kohë deri në seancën e ardhshme që ta trajtoni dhe të merrni vendim për ndonjë shumë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Duhet respektuar rregullore e Kuvendit. I patëm dy propozime të cilat janë jashtë rendit të ditës dhe i diskutuam. Herën e kaluar kur na kanë ardhur

dy pika tē rendit tē ditës, e kam përdorur nenin 20 tē rregullores, me qëllim që jemi dakorduar mos me fut e din shefat e grupeve parlamentare. A ka dikush ndonjë pikë tē re shtesë për rendin e ditës?

Durim Hajra: Po dua me i repliku Nënkyryetarit të Komunës. Pikën tē cilën e kundërshtuan përvendosjen e trafos ishte për arsy se nuk kishe dokumentacion të bashkangjitur, ishte propozimi i mangët, ndërsa pikën tē cilën po e tërhiqni, asnjë asamblistë nuk e dëgjova që e kontestoj, a me fut a mos me fut në rend ditës. Kishte qenë mirë Kryesues mos me hy në këso lojërash. Pikën që nuk e kontestoj askush po doni ta tërhiqni, ndërsa pikën tē cilën e kontestuan po e leni. Kjo është absurd.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Më lejoni që ta prezantoj pozicionin tim, nuk qëndron ajo që dikush pretendon këtu, sepse un po i shoh edhe pretendimet e juaja. Unë nuk mundem me hy dhe me paragjykua se çka flisni ju as nuk dua te hy. Secili keni tē drejtën e juaj, po ashtu edhe unë e kam tē drejtën, sepse në bazë tē rregullores secili anëtar ka tē drejt me propozuar dhe me tërheq. Pikën tē cilën e lamë përvendosjen e trafos ishte për arsy se po humbë donacioni dhe për këtë arsy ishte urgjente. Unë në seancën tjetër do ti sjellë edhe pikat tjera, sepse kam kërkesa me sëmundje tē ndryshme.

Hasan Ismajli: Drejtori i Shërbimeve Publike, na pajisi me material shtesë përpikën shtesë tē cilën ka ardhur. Ky Kuvend Komunal është organ ligjvënës, nuk jemi ekzekutiv dhe vjen fleta poseduese e kësaj kërkesë pa vulë dhe pa nënshkrim tē zyrtarit tē cilit e lëshon fletën poseduese dhe kjo përmua nuk është valide. I nderuar kryesues, kjo nuk e ka kopjen e planit dhe këta janë mësuar me thënë se me flet poseduese vendoset, kopja e planit cakton pikat prej ku fillon dhe ku mbaron prona. Kjo nuk është e nënshkruar as nga drejtori e as nga zyrtari dhe përmua nuk është dokument.

Vlonjat Hasani: Të nderuar koleg asamblistë, media dhe gjithë ju tjerë tē pranishëm, ajo se çka u tha më herët edhe nga shefi i grupit parlamentar dhe qëndrimet e opozitës, përveç që janë tē arsyeshme, është me patjetër tē komentohej edhe propozimi i kolegut tonë, sepse vijmë tē dy nga fshati Miradi e Epërme. Na vjen keq dhe bashkë ndjejshmë me rastin tē cilin ka ndodhur përbashkëfshatarin tonë Fidan Reqica. Nëse nuk keni pasur rast tē shkonit përtat vizituar banorin tonë, sepse nëse kishit shkuar e kishit pa që ka nevojë dhe është urgjente. Në formë arbitrarë ju po mundoheni ti kontrolloni edhe çështjet shëndetësore tē qytetarëve tonë. Ne po themi që është urgjente ka nevojë imediate për ndihmë financiare. Kjo shumë 5000€, nuk është aq shumë dhe ka mundësi komuna ti jap për ndihmë. Propozojmë që në shumën prej 5000€ deri në 10.000.00€ përkëtë rast ti ofrohet ndihmë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar kolegë, të nderuara media ju po e vëreni, që nuk ishte e rastësishme që kërkova 10 minuta pauzë tash po e vëreni, sepse ju nuk erdhët lart përtë biseduar dhe përti dhënë kaheje. Ne nuk jemi kundër asnjë, por unë kam kërkesa në zyrën time dhe përti vite e gjysmë asnjë nuk është përfundua. Seancën tjetër do ti fus edhe disa kërkesa që unë i kam në zyre. Rasti në fjalë punon në bylmet dhe pronari i Bylmetit na ka lajmëruar se qëndron deri në fund mbrapa rastit përti ndihmuar. Por, nëse shprehni vullnet me ndihmu unë nuk e refuzoj

ndihmën. Në çfarë do forme që ju më ndihmoni unë kam nevojë. Deri këtu më ka ndihmuar pronari i 'Bylmetit'. Kërkoj edhe një herë të dal z. Etnik Berjani në foltore.

Etnik Berjani: Ne siç biseduam ky është rast urgjent. Kush nuk e ka parë nuk e din rastin. Jemi marr me këtë rast edhe unë edhe Kryesuesi i Kuvendit, Vlonjati dhe të gjithë. Kryesues unë e di që edhe rastet e juaja janë emergjente, por nuk po e kuptoj pse po insiston me i fut bashkë. Unë kërkova nga ju me mbështet dhe me fut si pikë e rendit të ditës, për ti ndihmuar nëse ka vullnet, nëse nuk ka vullnet ne do mundohemi që ti ndihmojm privatisht.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë ju paralajmërova që nuk dua me i perzi me këtë rast, unë ju paralajmërova që në seancën me 22.05.2025, kur do ta kemi, do ti sjellë si pika të rregullta të rendit të ditës. Pyes a do me mbajt ende propozimin?

Etnik Berjani: Po dua ta mbaj sepse është rast urgjent dhe nuk kemi arsyе për ta larguar.

Shpend Bardiqi: Këtë pikë të cilën e votuam të gjithë, Nënkyetari i Komunës propozoi me heq. Nuk po e kuptoj, del tjetri thotë jo me heq, besomë që nuk po e kuptoj.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtu kanë propozuar shumë dhe asnjë nuk keni votuar për ti futur si pika shtesë të rendit të ditës.

Shpend Bardiqi: Ju po doni me térheq për shkak të obligimeve financiare dhe ju mundoni me e térheq sepse kjo do të sjellë probleme të mëdha, sepse ka shumë kërkesa të tilla. Mos u mundoni me na i hedhë fajet neve. Nuk po e kuptoj urgjencën e pikës tjetër edhe kjo nuk ka dokumentacion të bashkangjitur.

Mirsad Qyqalla: Kryesues ju kisha lut gjuhën me përzgjedhë. Një e dimi dhjetë nuk i dini. Ka elemente ofendimi, prandaj kursehu. Po flasim për një rast të ndjeshëm. Dua që ta theksoj se ka vullnet prej grupit tim, vetëm të kemi kujdes për të ardhmen. Unë publikisht deklarohem që deri sa të përfundon kjo legjislaturë, çdo kërkësë që vjen për ndihmë financiare grapi jonë do ta mbështet. Nëse nuk ka dokumente, Kryesues kishte qen mirë me thënë se nuk është urgjencë dhe e sjellë herën tjetër pikën për vendosjen e trafos.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Neni 20 i rregullores thotë: "Çdo anëtar i Kuvendit ka të drejtë të propozoj ndonjë pikë".

Nënkyetari i Komunës: Në momentin që kemi pasur dy propozime, prej dy anëtarëve të asamblesë komunale, të gjitha grupet kemi thënë se ne e kemi një marrëveshje për pikat të cilat vijnë jashtë rendit të ditës. Dy propozimet të cilat erdhën nuk patën material. Për asnjëren nuk keni material. Ndërsa ju po thoni njëren po e përkrahni pa material, ndërsa tjetren po thoni se po kërkojmë material. Të gjithë jemi duke dëgjuar. Ne e kemi sjellë një rast, të cilit me vjen keq të ia përmend emrin, ndërsa ne po bëjmë politikë me të. Njëherë po thoni nuk duam pikë jashtë rendit të ditës. Këtu kemi tre asamblistë të cilët janë nga fshati 'Miradia e Epërme', njëri i takon një partie politike, tjetri i takon një partie tjetër politike. Me qenë se me të aksidentuarin nuk bëhet politikë, unë pas pauzës erdha këtu dhe propozova me térheq. Ju u bëtë pishman, ne po ju themi ky propozim për rastin, ka ardhur nga z. Etnik Berjani. Këtë propozim e mbajmë, këtë propozim e votojmë, këtë propozim e mbështesim. Po ashtu pikën e dytë e mbajmë, e votojmë. Brenda pesëmbëdhjetë minutave kush e ka marr dy herë fjalën e ka shkelur. Për njëren pikë ka dalë një herë ka thënë e votoj, një herë pa material nuk e votoj.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Ne kemi biseduar edhe dje në Komitetin për Politik dhe Financa. Kanë qenë prezent të gjithë përfaqësuesit e partive politike. Dua që ta sqaroj pse kjo pikë është shumë e rëndësishme dhe pse ka ardhur urgjencë. Ne kemi një bashkëpunim shumë të mirë me KEDS-in. Përfaqësuesit e KEDS-it, e kanë parë të arsyeshme zhvendosjen e trafos në lagjen 029 dhe vendosjen e trafo-stacionit të ri në lagjen 029Po ashtu edhe ndërrimin e rrjetit në gjithë territorin e Komunës së Fushë-Kosovës. Po ashtu linja më e dobët është në lagjen 029, ku jemi të njoftuar të gjithë për këtë problem. Pas përpjekjeve të vazhdueshme me KEDS-in, më në fund e kanë fituar projektin, që ta sjellin një trafo në lagjen 029. Pastaj kanë ardhur me kërkesë tek unë dhe me kanë treguar se kërkesa është urgjente. Nëse nuk mundeni me realizua këtë, mundet me na ik oferta nëse nuk realizohet mundësia për vendosje sepse KEDS-i është kompani private dhe për këtë arsyese mendoj se duhet ta përkrahim unanimisht. Trafo ekzistuese është në pronë private, në oborrin e një shtëpie të banueshme. Unë mendoj se kjo pikë është shumë më e rëndësishme se sa pika tjeter, sepse atje po bëhet fjalë vetëm për një person ndërsa, këtu për komplet një lagje. Mendoj se janë dy pikat e rëndësishme. Këtu do bëhet zhvendosja e trafos së vjetër dhe vendosja e një trafoje të re, prej lokacionit të pronës private në pronë publike. Prona shtetërore destinimin e ka infrastrukturë, të gjitha dokumentet janë të bashkangjitura në material, vërtetimi i Drejtorisë së Urbanizmit, vërtetimi i Drejtorisë së Kadastrit edhe fleta poseduese, që tregon se kjo pronë është infrastrukturë. Ne mendojmë se i plotëson të gjitha kushtet për tu vendosur trafoja e re që të furnizohen me energji elektrike banorët e asaj lagje. Kjo është vetëm për të mirën e qytetarëve të asaj pjese. Projekti është vetëm për 28metër, jo për tërë pronën siç e përmendi dikush.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çoi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme pikën shtesë të rendit të ditës ‘Propozim për ndihmë financiare për palën Fidan Reqica’ U votua me: unanimitet, kundër nuk ka dhe asnje abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovuan si pikë shtesë të rendit të ditës ‘Propozimin për ndihmë financiare për palën Fidan Reqica’.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çoi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme, pikën shtesë të rendit të ditës ‘Propozim për marrje të vendimit për lejimin e vendosjes së trafo stacionit në pronë komunale në lagjen 029 në Fushë-Kosovë’

U votua me: katërmëbëdhjetë për, kundër nuk ka dhe nëntë abstenime, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan si pikë shtesë të rendit të ditës ‘Propozim për marrje të vendimit për lejimin e vendosjes së trafo stacionit në pronë komunale në lagjen 029 në Fushë-Kosovë’

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e çoi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: njëzet e tre për, kundër nuk ka dhe asnje abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme me dy pikë shtesë.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 03.04.2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoi anëtarët ta marrin fjalën nëse kanë ndonjë vërejtje.

Vlonjat Hasani: Kushte tekniqe nuk kemi, ligjin nuk po e respektoni, procesverbali mbahet ende me dorë, mikrofonat nuk punojnë dhe si të tillë ne nuk mundemi me mbështet këtë pikë të rendit të ditës sepse nuk është profesionale dhe nuk është në përpjekje me ligjin.

Fisnik Sllamniku: Përshëndetje për të gjithë. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit, këtu e kemi diskutuar që nuk janë kushtet, jo një mbledhje por çdo mbledhje. Ekstrakti nuk është pikë që duhet krejt minutazhën me diskutua për ekstrakt, ndërsa kur janë pikat e rëndësishme, nuk diskutoni. Ne si grup parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e përkrahim ekstrakti.

Mirsad Qyqalla: Unë nuk kam asgjë kundër kolegut z. Fisnik Sllamniku, në mungesë të video incizimeve, që e kërkon ligji, nëse ishin publikuar këto, ne nuk kishim pas nevojë për të bërë video, por kjo është e drejt e jona dhe ne e shfrytëzojmë, nuk është mirë me akuzua kolegët, sepse ne jemi duke e bërë vetëm punën tonë, e ligjin e shkelin për qëllime puro politike ekzekutivi, që çka do që të ndodh të jetë në këtë sallë, mos te del jashtë. Prandaj çdo her kemi qenë kundër ekstraktit për këtë arsy e dha prap jemi kundër, për arsy se po shkelet ligji.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e çoi në votim për aprovimin e ‘Ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur më datën 03.04.2025.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, tetë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me shumicë të votave e aprovoi ‘Ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës të mbajtur më datën 03.04.2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar dëshironi qe te shkojmë në pauzë dreke apo të vazhdojmë.

Laureat Gojnovci: Nuk po e kuptoj pse ter kjo zhurmë për një pauzë, kur vazhdimisht ne kur kemi pasur mbledhje ne këtë orar kemi dal në pauzë.

Durim Hajra: Ne grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje jemi për me vazhduar seancën.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e çoi në votim se kush është për të dal në pauzë.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, tetë vota ‘kundër’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e tre anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Pika e dytë (2) - Propozim për fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar, kuorum nuk kemi, por kisha propozuar që ta vazhdojmë diskutimin për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Sekretari i Kuvendit të Komunës: Të nderuar asnjëherë nuk kemi vazhduar seancën pa kuorum.

Mirsad Qyqalla: Unë nuk mundem me paragjykua, sepse mund të ndodh që asamblistët kthehen, ne vazhdojmë seancën, debatojmë, pastaj kur të vije tek votimi konstatoje kuorumin.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë nuk jam jurist dhe bazuar në atë, se praktikat e mëhershme kanë qen vetëm me 14 vota, përndryshe nuk ka kuorum dhe e kemi ndërprerë seancën. Mua më mbetet me konstatuar që nuk kemi kuorum dhe nuk mundem me vazhduar seancën.

Hasan Ismajli: I nderuar nëse të ka thënë juristi, ai e ka lexuar diku, unë pyes se ku shkruan kjo të cilën po e thuani?

Sekretari i Kuvendit të Komunës: Shumica e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, është katërmëbëdhjetë vet, kjo pikë ka për tu votuar. Vitin e kaluar e keni ndërprerë mbledhjen tri herë dhe nuk e keni vazhduar mbledhjen pa pasur kuorum, unë nuk jam ai i cili e ndali mbledhjen, ju mund të vazhdoni dhe ministria ta konstaton.

Durim Hajra: Ne jemi për me vazhduar mbledhjen.

Mirsad Qyqalla: Praktika është në nivel dëshire dhe vullneti, obligim nuk është. Ne kemi nevojë me u thirr në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nëse ju e gjeni në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, atëherë jemi në rregull. Ne nuk jemi me ia mbajt mbledhjen askujt pas kësaj loje. Një herë ka pasur tendencë që të ndërpritet mbledhja, pastaj e kemi lëviz pikën pyetje dhe përgjigje. Ju jeni duke e shtyrë kohën për arsyen tē pritjes së dikujt, i nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës, barra do të bie mbi ju, ne jemi këtu me fuqi të votës sonë.

Hasan Ismajli: Këtu është një problem tjetër, na kanë ardhur dy pika, që proceduralisht nuk kanë pasur të drejt me ardhur fare, revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, ndërsa Planin Zhvillimor komunal e kemi në përfundim. Ju nuk keni të drejtë të bëni revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, sepse kjo revidohet në përputhshmëri me Planin Zhvillimor Komunal dhe ky plan është mbrapa. Pika tjetër është pika tre, ku këtyre iu kanë mbetur do parcela, që me vijë administrative është pjesë e Komunës së Graçanicës dhe këta po duan që ta fusin në pronat e Komunës së Fushë-Kosovës dhe iu kanë mbetur disa kompani ndërtimi, të cilat janë të interesuara sepse aty ndërtojnë afér dhe kanë interesin e vet kompanitë, po ashtu është interes i këtyre me përfitua, në mungesë të votave dhe këta nuk i kanë votat dhe janë duke u munduar prej fillimit me peshku, sepse këtu në mesin e kolegëve nga pjesa e opozitës ka mesazhe të cilat u'a dërgojnë që të votohet. Mua personalisht tri herë më than dhe në mungesë të votave këta po dëshirojnë të dalin, por zyrtari ligjor i cili e ka për detyrë me ia shpjegua ligjin kryesuesit, thotë kjo është praktik, ndërsa unë e di që ligji nuk është me praktik. Kemi pasur kuorum kur kemi filluar seancën, është votuar rendi i ditës. Në Kuvendin e Republikës së Kosovës shpesh herë mbesin nga 20 deputet, pika shterret dhe nëse nuk ka kuorum, ndërpritet seanca vazhdon ditën tjetër, ndërsa me thënë zyrtari ligjor nuk mundet pa katërmëbëdhjetë vet, dua ta di ku e ka lexuar që ta lexoj edhe unë.

Durim Hajra: Sa i përket asaj, se qysh shkoj mbarëvajtja e kuvendit, u tha edhe nga parafolësit, qëllimi i opozitës ishte që të zvarritet sa ma shumë dhe kur të vije koha e pauzës me përdor dhe i' a arriten. Por, unë nuk besoj që do ua lëmë edhe pak muaj çka na kanë mbetur qeverisje me ua mbylli pazaret, të cilat i kanë lënë me dosta e me jarana, me prona publike dhe me hapësira publike. Interes i qytetarëve është që seanca me shkuar mirë, interes i qytetarëve është edhe me ditë se çka po flitet në këtë seancë, interes i qytetarëve është që pikat të cilat kanë ardhur nga ju me u diskutua jo me këqyr me ngulfat edhe debatin. I nderuar Kryesues sa i përket kësaj pike, që ju realisht edhe e hapët diskutimin, drejtori erdhi në foltore me marr fjalën, e me vazhduar pika e rendit të ditës, unë mendoj se nëse e marrim parasysh praktikën e mirë, jo veç të Kuvendit Komunal të Fushë-Kosovës, por cili do kuvend komunal, kjo pikë duhet të vazhdoj i nderuar Kryesues dhe kur konstatohet se nuk ka vota për të kaluar kjo pikë e rendit të ditës, mbetet në domenin tënd a me vazhduar seanca sot, apo një ditë tjetër. Qëndrimi im është që të vazhdohet diskutimi, janë dy pika të rëndësishme të cilat kanë ardhur.

Laureat Gojnovci: E ndjej si obligim edhe ndaj organit më të lartë Komunal, po ashtu edhe ndaj kolegëve, po thirren, jo janë mediat dhe po presin me u lodhë mediat, unë i inkuadroj mediat për çdo seancë nga Kuvendi Komunal nga ky moment e deri në përfundim të mandatit tonë me kanë prezent. Këta numra i ka kjo mazhoranc. Nuk munden me pikë numrat prej qillit, edhe pas pauzës këta numra do jenë, por thjeshtë u kërkua një pauzë, siç kemi mbajtur pauza në seancat e tjera.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Neni 46 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale thotë, kuorumi për të gjitha takimet e Kuvendit të Komunës dhe Komuniteteve të tij është së paku gjysma e numrit të anëtarëve të Kuvendit Komunal, neni 46 paragrafi 2 thotë, kuorumi duhet të verifikohet, para çdo marrje të vendimi. Po ashtu neni 48 thotë çdo anëtar i kuvendit ka të drejt vote përfshirë edhe Kryesuesin e Kuvendit të Komunës, po ashtu kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi mbetet i barabartë për ose kundër ndonjë propozimi. Neni 46 paragrafi 1 thotë nuk mundesh me shkuar tek votimi pa pasur kuorum, ne anën tjetër nuk mundemi me marr votim pa pasur kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar tash do ti marrim 30 minuta pauzë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar, unë po ia kaloj fjalën Drejtorit të Urbanizmit.

Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit: Përshëndetje për të gjithë. Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës e viti 2020-2028, ka kaluar periudhën 4 vjeçare, që është në zbatim, në bazë të Udhëzimit Administrativ dhe Ligjit në fuqi për planifikim, ne e kemi pasur një propozim për fillimin e procedurave të revidimit. Kjo ka të bëjë vetëm me iniciimin e procedurës për revidimin e kësaj harte, ku kemi të përshkruar edhe bazën ligjore në propozimin të cilin e keni marrë. Kemi lëshuar një gabim teknik, mirëpo gjatë viteve kemi një raport vjetor, të punë së cilës u bë me hartën zonale komunale. Sipas ligjit të planifikimit hapësinor, në momentin që ajo zhatohet prej 40%, e fitojmë të drejtën. Po ashtu edhe një arsyё tjetër është se tani për tani Plani Zhvillimor Komunal, i vjetri nuk është në harmoni me hartën zonale. Ne kemi pasur vazhdimisht probleme se planet hapësinore, nuk i kemi pasur të aprovuara në të njëjtën periudhë kohore. Periudha tetë vjeçare, HZK-është 2020-2028, PZHK-ja është e vjetra, problemi i njëjtë do të na paraqitet me Planin Zhvillimor të ri 2025-2033, ndërsa HZK-ja mbetet deri në vitin 2028. Këtu është qëllimi që të harmonizohen të dy planet. Tek Ligji për Planifikim Hapësinorë, e keni të përshkruar edhe rangimin e planeve hapësinore, te cilat janë në kompetencë të nivelit lokal, propozimet duhet me ardhur prej organit kompetent komunal, në këtë rast është Drejtoria e Planifikimit Urban, në pajtim me nenin 5 Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës dhe planet ne kemi ardhur me këtë propozim për të filluar një procedurë për revidimin, plotësim ndryshimin e revidimit të Hartës Zonale. Në ligj është termi revidim, në udhëzim administrativ është plotësim ndryshim, por është e njëjtë procedurë. Unë jam i gatshëm të përgjigjem në pyetjet e juaja.

Durim Hajra: Pas shqyrtimit të materialit i cili na ka ardhur nga drejtoria përkatëse për propozim vendimin për revidim të hartës zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, për vitin 2020-2028, i vërejtëm disa shkelje në aspektin ligjor dhe që e bënë që ky propozim vendim të jetë i paligjshëm, i pa përshtatshëm, i pa pranueshëm në formën si është paraqitur para neve. Një detaj që fillimisht dua që ta përmend, e që për ne është shqetësuese, që ky propozim vendim vjen pikërisht në këtë kohë, është që ka ardhur vetëm pak muaj para zgjedhjeve lokale, e që dihet që si proces merr kohë për tu përfunduar në mënyrën më të mirë të mundshme. Ashtu siç edhe është paraqitur këtu, nuk është vetëm interes publik si shkak që e kemi këtë propozim, e që i bie që ky propozim vendim, të ketë ndoshta motive tjera, si shkak i formës së prezantimit. Ne mendojmë se këtu ka të bëjë më shumë me interesin privat, si dhe dyshojmë që gjatë mandatit kanë premtua që kanë me ju përshtatë kriteret e ndërtimit sepse këtu nuk shohim që ka të bëjë diçka me interesin publik. Komplet baza ligjore është më shumë kundërshtim, se sa është në përputhje dhe në harmonizim me legjislacionin në fuqi. Po nisem prej shkeljeve të Udhëzimit Administrativ nr.24/2015, unë nuk pash që tek

propozim vendimi është cituar nenit 34, po ashtu nenit 36 i po këtij Udhëzimit Administrativ, po nisem nga pika 3 ku thuhet që komuna themelon një komision profesional, qoftë kur është bërë hartimi i hartës zonale, ose revidimi apo plotësim ndryshimi i hartës zonale. Pyetja rrjedh a ka ndonjë raport të atij komisioni, sepse aty jepen edhe detajet se si duhet të ruhet në procesverbal, se çka është diskutuar në atë komision. Nëse ka pse nuk është paraqitur sot para nesh, pika tjera janë pika 4 dhe pika 5 e nenit 36 të këtij udhëzimi, këtu nuk janë sjellë bashkangjitur dokumentet e nevojshme, për shqyrtim dhe miratim të dokumentit të cilin e keni prezantuar. Tek po i njëjtë udhëzim gjymë shkelje edhe tek nenit 9,10 dhe 11, sepse këto nene parashihet që të jetë, një analizë e gjendjes ekzistuese, të hapësirave që kanë për tu ndërtuar. I nderuar drejtor, unë nuk kam informacion të mjaftueshëm as në aspektin bazik se si bëhen këto ndryshime edhe jam laik në këtë fushë, nëse ke mundësi të më sqaroni se çka keni paraparë për të mirën e interesit publik. Sepse nuk e kemi përparrë as gjendjen ekzistuese, as atë se çka keni menduar të përmirësoni për të mirën e interesit publik. Këto shkelje për ne janë shumë serioze në aspektin procedural. Duhet me qenë indikatori kryesor, që secili asamblist i cili mendon dhe ka për qëllim interesin e qytetarëve, të ndalet dhe të thotë në këtë pikë, nuk jemi ndoshta as që të diskutojmë pa i plotësuar këto kërkesa dhe kriteret e cilat i parashoh edhe udhëzimi administrativ dhe ligji. Tek procedurat e revidimit të hartës zonale, nuk është zbatuar as ligji të cilit ju keni referuar. Në bazë të nenit 11 ligji 04/L-174 Për Planifikim Hapësinor, revidimi i hartës zonale të komunës thotë se lejohet, vetëm në katër vite pas miratimit, e që i ka bërë Komuna e Fushë-Kosovës katër vite prej që e ka miratuar edhe atë në rast se më pak se 40%, të jetë i zbatueshëm, nuk e di që si drejtori na ke prezantuar ndonjëherë, as qysh ka rrjedhë si proces, as deri ku kemi arritur me hartim të Hartës Zonale, e as ku i kemi ngecjet. Por, arrijmë tek vija ku tentojmë që në këtë formë të bëjmë ndryshimin e hartës zonale. Ju jeni në aspektin e transparencës zero. Dokumenti i cili na u ka prezantuar, nuk i jep as një dëshmi, se harmonizimi i hartës zonale të Komunës së Fushë-Kosovës, është bërë, me hartën zonale te Kosovës, gjë që e parashev edhe ligji, prandaj ne sot nuk e kemi të qartë, se Harta Zonale, të cilën e kemi votuar me shumë se katër vite, a është në harmoni me Hartën Zonale të Kosovës, sipas nenit 11 pika 1.5 e ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor. Propozimi i hartuar, nuk përbën as një referencë në lidhje me aspektin e ligjit 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, sipas nenit 11 të pikës 1.3 të ligjit Nr. 04/L-174 Për Planifikim Hapësinor, çdo propozim vendim, duhet të shoqërohet nga një program i detajuar që specifikon llojin e dokumentit, qëllimin, kufijtë dhe territorin, subjektin përgjegjës për hartimin e mekanizmave të përdorur. Pra, të gjitha këto elemente janë anashkaluar. Ne si asamblist nuk jemi të njoftuar që ka pasur ndonjë diskutim publik në lidhje me këtë çështje, qoftë për një lokacion që do të bëhet ndryshimi. Unë mendoj se hapin e parë që është dashur ta merrni është dashur që të siguroheni që i keni 2/3 e votave, për plotësim ndryshim. Në fillim i nderuar drejtor thatë se është një gabim teknik, por çuditërisht për tema të rëndësishme dhe të ndjeshme, ne përballemi me gabime teknike (gabime te qëllimshme) që i quajmë ne. Ky propozim nuk e ka interesin publik për qëllim.

Mirsad Qyqalla: Ky propozim i cili na ka ardhur është me një fletë, një temë kaq e rëndësishme siç është kjo vjen me një flet material. Këtu nuk ka seriozitet, tekstin bazë e ke për revidim të hartës zonale. Dëgjova drejtorin i cili tha që ligji e lejon. Po i nderuar drejtor ligji e lejon, me ndërhyrë, por 40%, nëse zbatohet, këtu është dashur ta kem një pasqyrë, se sa është zbatuar, tek pjesa tjetër. Udhëzimit te cilit ju keni referuar ju, nenit 10 përgjegjësit që thotë Kuvendit Komunal, për planifikim hapësinorë, e ke në pikën 3, ku thotë Kuvendi Komunal, në baza vjetore shqyrton, raportimin monitorues, të qëllimeve dhe objektivave deklaruese dhe hartës zonale të Komunës. Tri vite e gjysmë asnjë raport nuk e kemi pasur, për hartën zonale, në këtë Kuvend, sepse askush nuk e ka sjell. Pyetja ime është pse të bëhet revidimi, cilën pjesë, pse na duhet, cila është arsyaja. Harta

Zonale qysh në fillim ka qenë me gabim në hapat, sepse fillimi shështë dashur të bëhet plani Zhvillimor Komunal, pastaj Harta Zonale të inkorporohet. Iu kishit referuar nenit 36 të Udhëzimit administrativ, ndërsa neni 34 fletë për hapat, që duhen për fillimin e procedurës. Me këta hapa pse nuk ju keni referuar, qëllimin e dini vetëm ju i nderuar drejtor. Ndryshim-Plotësimi për nenin 34 pika 2,2 thotë, Ndryshim-Plotësimet mund të propozohen nga anëtarët e kuvendit dhe autoriteti përgjegjës. Pika 5.1 fol për propozimin që thotë: Propozimi për fillimin e proceduarve, bëhet me shumicë të thjeshtë, ndërsa propozim-ndryshimi kalon me 2/3 e votave. Por, para se të vije tek fillimi i hapave dhe te votimi i thjeshtë, të cilin ju e synoni këtu i keni edhe do obligime si drejtori, të na e sqaroni dhe të na sillni të dhëna, sepse kjo temë nuk është e thjeshtë. Ne nuk e kemi të qartë pse duhet të filloj revidimi i hartës zonale, nuk e kemi përshkrimin e gjendjes ekzistuese. Të gjitha këto i kërkon ligji jo unë. Unë nuk e kam të qartë ku keni me ndërhy dhe cila është arsyja. Nuk keni seriozitet, sepse po të kishit seriozitet material ishte dashur të sillej në formën e duhur.

Hasan Ismajli: Me datë 15.11.2024, kemi pasur një informatë lidhur me hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, i cili është në hartim e sipër, nga Kompania Insi, ku jemi informuar çka paraqet ky plan, ku ndërhyhet, kjo ka përfundua dhe këta e mbajnë fshehurazi. Planin Zhvillimore e kanë dërguar në Ministri. I kanë pasur disa vërejtje të cilat është dashur të përmirësohen, por këta e kanë një hallë, sepse janë hyrë borxh, tek kompanitë e ndërtimit, sepse ata po i financojnë me të madhe fushatën dhe e kanë interesin e vet personal tek ndërtimet, sepse ju mbetet ndonjë lokal apo ndonjë banesë aty. Për këtë kanë ardhur sot me një propozim për ndryshim plotësimin e Hartës Zonale ose revidimin dhe Drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, me një shkollim të lartë, thirret duke u bazuar në ligjin Nr.04/L-174 për planifikim hapësinor. Këtu shkruan e gjitha, që duhet të bëhet për revidimin e hartës zonale. Ju jeni thirru në nenin 36, ju nuk keni gabuar, por keni menduar ta kaloni sot. Neni 34,35,36 dhe 37 e specifikon saktë çka duhet, ndërsa ju e keni vetëm nenin 36 dhe tek neni 36, janë disa proceduar prej pikës 1 deri tek pika 11 dhe përfundimi pika 12 ku thotë, votohet me 2/3 e Kuvendit, ndërsa ju keni menduar që këtë mund ta kaloni edhe me vota të thjeshta, pastaj të veprohet si me vendimet e tjera të cilat janë kthyer dhe vazhdojnë ti mbajt në fuqi. Zyrtari ligjor herë i bënë të plotfuqishme, herë nuk i bënë. Problemin më të madh e kanë zyrtarët të cilët merren me ato lëndë pastaj dhe ata po shkojnë në prokurori.

Hasan Gjyreveci: I nderuar mos u sillni ju nga Zyrtari Ligjor, thuaje fjalën tënë.

Hasan Ismajli: Nuk ke të drejtë me thënë, sepse ke vendime të cilat nuk i ke bërë të plotfuqishme.

Hasan Gjyreveci: Unë vendimet i bëjë të plotfuqishme, kur kalojnë afatet ligjore dhe e di se çka publikoj.

Hasan Ismajli: Për ata që të ka kaluar afati ligjor, këta tash ta kanë sjellë revidimin. Të nderuar revidimi i hartës zonale bëhet në afat tetë vjeçar, por keni të drejt pas katër viteve që të revidohet, nëse nuk është tejkaluar, plani sipas hartës zonale, plani zhvillimor sipas hartës zonale nëse e ka kaluar 40%, ne nuk e dimi se a e ka kaluar apo jo sepse nuk kemi asnjë informatë dhe këta ta bien këtë. Unë kam thënë, plani zhvillimor komunal është Kushtetuta e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse çdo zhvillim, i komunës që bëhet, duhet të bëhet në bazë të hartës zonale. Drejtor, ju thatë revidimi bëhet në harmonizim me planin zhvillimor komunal, me cilin pyes? ky që është në përfundim e sipër, nuk ka ardhur, i vjetri e ka tejkaluar hartën zonale dhe komuna e Fushë-Kosovës është komuna e parë, që e ka aprovuar hartën zonale, pa plan zhvillimor komunal dhe ju e dini shumë mirë për cilën arsy, ka qenë një pilot projekt, të kalohet Harta Zonale tek një komunë dhe e keni pasur për detyrë që menjëherë të fillon me Planin Zhvillimor Komunal dhe ju keni filluar në vitin e kaluar dhe kompania me sa unë kam informata, e ka përfundua. Po ashtu neni 34 i cili u përmend nga dy parafolësit e mi, neni 34 pika 5 thotë, fillimi i procedurave, por jo revidimi i hartës zonale, kalon me votat e thjeshta. Po ashtu pika 5.2 e nenit 34 thotë, kalon me 2/3 e votave nëse

është iniciativë për fillim ndryshimin e revidimin. Kryesues unë kërkoj nga ju, që ju ti merrni pesë minuta pauzë dhe ta konsultoni Zyrën Ligjore, zyrtarisht përmes e-mailit dhe ata ta kthejnë zyrtarisht qysh votohet sipas nenit 36, pastaj ne jemi në rregull.

Kryesues i Kuvendit: Unë jam dakord nëse edhe ju vendosni, dakordohemi e ndërpremë seancën kthehemë të hënën, sepse Zyra Ligjore nuk e kthen menjëherë përgjigjen.

Shpend Bardiqi: Unë dëgjova drejtorin që tha, ne i kemi plotësuar kriteret, për të pasur të drejtë, që me ndërhy në hartën zonale. Kanë kaluar katër vite është përbush 40%, do ta respektojmë ligjin, udhëzimin. Unë dua ta di pse kemi nevojë që ta ndërrojmë. Ky ndërrim po shkon në vazhdën e përpjekjeve tona, për të ndërhytë si në plan zhvillimor, si në hartë zonale në komunën tonë. Më herët nuk kemi tentuar që ta ndryshojmë planin zhvillimor, votojshit u'a kthente ministria, pastaj nuk e dimë se çka ka ndodhë, pse nuk po e ndërrojmë njëherë planin zhvillimor por hartën zonale? Pas kësaj kemi tentuar disa herë për rregulloren e bonuseve të zoonimit. Pjetje: çka ka ndodh me atë rregullore? Pse heqët dorë? Sepse më herët ka qenë një presion i jashtëzakonshëm, që të ndërrohen bonuset e zoonimit. Unë dua ta di edhe në qoftë se është vetëm fillimi i procedurave për revidimin e hartës zonale, dua ta di arsyen pse kemi nevojë që të fillojmë procedurat dhe ta ndërrojmë hartën zonale? A janë shitur të gjitha banesat? A jena duke dashur me e rrithë ndërtimin apo me ul ndërtimin? Ju këtë e quani zhvillim, ndërsa unë e quaj krim. Unë dua ta shoh çka po doni me arrit me këto ndryshime, dua një dokument. Ne jemi të partë, që kemi bërë Hartën Zonale tash, po duam që ta revidojmë, po ashtu plani i mobilitetit ku kompania ka kushtuar shumë shtrenjtë, besoj se prapë kjo kompani ka për ta bërë revidimin e Hartës Zonale. Po shpenzojmë shumë për këtë kompani dhe për çudi është qyjeti me një urbanizim më të pa jetueshëm në Kosovë. Nuk ke as vend për parking. Vjen në kuvend me një propozim me një faqe të A4 dhe thuani po e ndryshojmë Hartën Zonale. E çuditshme, por duhet te jeni pak më seriozë. Ne kemi pak kritere dhe shumë ndërtim, e çuditshme.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban: E përbashkëta e të gjitha këtyre çështjeve që u ngritën nga asamblistët është baza ligjore. Këtu nuk po duam që të kontrabandojmë asgjë. Ne nuk e kemi përmendur qëllimshëm nenin 36, ju tregova edhe më herët se është një gabim teknik e kemi konsultuar edhe me zyrën ligjore. Por, aludimi juaj është i gabuar, propozimi ka të bëjë me fillimin e procedurave për revidimin e hartës zonale, nëse është gabim teknik baza ligjore me poshtë e keni udhëzimin, i cili flet në përgjithësi. z. Durim Hajra e ngriti një shqetësim të cilin, tha se është filluar si procedurë gabimisht. Tash në fund të mandatit, ne nuk mundemi me thënë se do pauzojmë deri në zgjedhjet e ardhshme, mos me marr asnjë aktivitet nëse është obligative për drejtorin, për të bërë propozime dhe ne vetëm po fillojm me procedur, nuk e dimë se kur përfundon, mund të vonohet sikurse Plani Zhvillimor Komunal. Këto janë çështje procedurale, ne po fillojmë një procedurë, ky propozim do të shkoj në Ministri, do të shqyrtohet nëse konkludohet që është e mundshme, ligjërisht të fillohet me procedurat. Ne mandej fillojmë me fazën e dytë dhe i bashkëngjisim arsyetimet, pjesën tekstuale, hartografin që të fillojmë mandej procedurat, sipas nenit 36 edhe aty fillon puna, sepse për momentin ne nuk kemi kompani të kontraktuar, as nuk dihet se kush do të punoj, as nuk dihet vlera se sa do të kushtoj. Ne mundemi të bëjmë një propozim ku supozojmë se shuma që e kam potencialisht të rezervuar për këtë proces është 50.000.00€, nuk kam më shumë në kuadër të buxhetit. Po ashtu po aludohet tek interes i caktuar, kjo është plotësim ndryshim i hartës zonale, që i harmonizon zhvillimet, me planin zhvillimor komunal, e që është e vërtet që është në funde të procesit. E kemi dërguar në ministri draftin final, me përgjigjen që e kemi marrë prej ministrisë, me vërejtjet vlerësimin numër një, nëse kishte për të shkuar procesi në rregull, ajo shumë shpejt do të kryhet edhe paralelisht pse të mos fillohet me këtë procedurë. Aktualisht komuna e Fushë-Kosovës, e ka një Plan Zhvillimor Komunal që i ka kaluar afati, por

që prapë mbetët në fuqi, për shkak që mos të krijohet vakum ligjor edhe e ka një hartë zonale, po që zhvillimet nuk janë të harmonizuara, për shkak të diskrepancës kohore. Njëra katër vite më herët njëra katër vite më vonë dhe nëse vazhdojmë kështu, ne prapë do ta përsërisim çështjen e njëjtë. Dua të ndalem tek z. Mirsad Qyqalla, arsyeva pse nuk kam bashkangjitur material në këtë propozim, për ta argumentuar më shumë, është sepse unë kam bërë propozim për fillim të proceduarve. Unë nuk dua të paragjykoj se si do të shkoj rrjedha, e kësaj çështje më vonë. Kjo shkon në ministri, nëse jemi në harmoni me ligjet dhe udhëzimet administrative, fitojmë të drejtën me hy në proces. Duhet që të ndryshohet destinimi i sipërfaqeve të cilat janë në Plan Zhvillimor Komunal me Hartën Zonale. Nëse thua që Plani Zhvillimor i Komunës së Fushë-Kosovës 2025-2033, tetë vite pse HZK-po kryhet në 2028 edhe plus nuk janë harmoni destinimet e sipërfaqeve, kjo është arsyeva sa i përket harmonizimit.

Hasan Ismajli: Para dy viteve z. Ali Topalli, e ka sjellë një propozim, për Federatën e Futbollit të Kosovës, me ua dhënë një pronë, për ndërtimin e një akademie të futbollit. Propozimi ka qenë që të fillohet procedura. Qe dy vite ua kemi dhënë tre hektar dhe asnjë procedurë nuk ka filluar. I ka marrë tre hektar tokë, ku gjysma ka qenë, e planifikuar me Hartë Zonale për sport, tjetra ka qenë për botani dhe janë tre hektar që ua keni dhënë Federatës së Futbollit, së bashku me Kryetarin e Komunës. Ju po doni me fillua dhe jeni lidhë tek neni 36, ne nuk kemi faj nëse ju nuk keni ditë. Ky nuk është gabim teknik, sepse para një muaji, në mbledhjen e kaluar kur e keni sjellë si pikë të jashtëzakonshme, ka qenë i njëjtë udhëzimi administrativ dhe neni i ligjit 36, ju asgjë nuk keni ndryshuar dhe e keni sjellë prapë. Gjatë seancës keni dëgjuar që është përfolur dhe tash thuan se është gabim teknik. Dua të me tregoni, nëse ju filloni me procedura, me cilin Plan Zhvillimor Komunal, sepse me këtë të cilin është në proces, duhet pritur edhe disa muaj, sepse kur të përfundon duhet me ardhur këtu në dy lexime dhe duhet me dal në diskutim publik me qytetar një muaj, ndërsa kjo nuk ka filluar ende dhe ky mandat i asamblistëve përfundon. Ne nuk e mbërrimë, por ju e keni hallin të kalohet si pikë, sepse ju e përmendët shkollën afér, e që e keni dhënë për xhami, e që me Hartë Zonale është shkollë dhe e keni quar një tri kilometra ma poshtë në ara, në baltë, ku nuk ka as infrastrukturë dhe jeni duke e ndërtuar. Por, ju këtij zotëriut i'a keni premtuar me i'a dhënë dhe tash po mundoheni me kontrabanduar këtë revidim të hartës zonale. Por, me largu shkollën për xhami... unë i përkas fesë islame dhe nuk jam kundër xhamisë asnjëherë, por unë jam për arsim dhe në rend të dytë për mua është xhamia.

Mirsad Qyqalla: Si pikë e parë drejtore, nuk e di nga është kjo kërkësë tallava, unë te bëjë mandej, kjo nuk është punë e juaja. Ju e quani veten profesionist, e kam sjellë me gabim dhe qe një javë e kemi këtë material dhe nuk ke qenë në gjendje me ndërrua një nenë. Për mua konkretisht ky nuk është gabim por është qëllim. Ne e dimë edhe arsyen pse ndodh kjo, ju jeni nën presion të dikujt, ku ai mundet me qenë një shtyllë e mirë e votës suaj. Ndërsa ne me hy dhe me reviduar hartën zonale, mendoj se nuk e kemi me urgjencë. Nëse në vendin e lartcekur, me Hartë Zonale keni planifikuar shkollë, e keni kthyer në xhami, ju personalisht keni thënë se unë e lëshoj atë leje, atë ua ka kthyer ministria, ndërsa tash tentoni gjithqysh që të filloni me Revidimin e Hartës Zonale para shtatorit. Ky qytet është për qytetarët, për gjeneratat e reja. Ne nuk mundemi me e fut qytetin në pazare, sepse ka ndikim dikush dhe është një votë e fuqishme për zgjedhjet e tectorit. Unë thash pse nuk po e pritni të vije Plani Zhvillimor Komunal dhe me harmonizu Hartën Zonale, pse jeni kaq për ngut, që ne duhet me fillua gjithqysh. Kjo komunë ka do rregulla, ka ligje dhe ne nuk jemi pjesë dhe s'do jemi asnjëherë pjesë e ndikimeve personale. Nëse ju doni që të revidohet Hartën Zonale për qëllime të shëndosha dhe të nevojshme është dashur të jemi të pajisur me komplet materialin dhe sqarimet, për secilin ndryshim.

Durim Hajra: Drejtori tha se arsyja kryesore pse duhet me hy në revidim të Hartës Zonale është, për t'u harmonizuar me planin zhvillimor të ri. Një drejtor i një qeverisje 25-vjeçare, me dhënë këtë arsy, në aspektin moral besoj se jeni në zero e pranueshme kjo arsy. Kur është bërë Harta Zonale, ka mundur t'i parapri Planit Zhvillimor Komunal, qysh edhe duhet. Ju keni qen në qeverisje dhe keni pasur edhe më shumë numra, kështu që për një punë, që nuk e keni bërë ju, pse ne duhet ta pranojmë si arsy. Kjo arsy nuk pranohet dhe këtë problem e keni shkaktuar ju. Ju thatë se baza ligjore ka qenë një gabim teknik, ne mund të dalim dhe të themi se nuk keni bërë punë të mira në këtë aspekt. Në aspektin e ndërtimit nuk e keni pasur parasysh të mirën e përgjithshme por vetëm interesin e caktuar.

Shpend Bardiqi: Drejtori tha se kemi për të bërë një destinim të pronave dhe nuk mundem me paragjykuar se çka do të ndërrrohet. Ju nuk jeni duke e ditur as vet se çka po doni me ndërrua. Vetëm një herë me i fillu procedurat për ndërrim dhe tani vjen një kompani dhe na tregon, si këna me ndryshuar sepse nuk jemi hartues. Kush e ka parë të nevojshme me thirr një kompani që të vije për të na ndryshuar revidimin e hartës zonale. Ju po thoni drejtor, që ligji po na obligon. E nëse nuk revidohet harta, mund të shkoni edhe në burg. Drejtoria për Urbanizëm e Komunës së Fushë-Kosovës, Revidimin e Hartës Zonale, po ia dorëzojka një kompani dhe ata si të duan bëjnë ndryshime. Ju kisha bërë thirrje, që të mos përkrahet dhe të mos votohet, sepse kjo qëndron edhe më keq se krejt atë që e than të gjithë asamblistët. Ne jemi duke e reviduar Hartën sepse një kompani paska nevojë me reviduar ose ligji mundet edhe me ndëshkuar. Kompania private na i ka bërë hartën, planin tash edhe revidimin.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban: Shpendi fol çdo herë me personale, nuk jep asnjëherë një konkludim ligjor, po ma merr mendja, po i bie, po duket. Unë e kam përparrë vendimin për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, ku Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës, e ka pranuar me 16.11.2020, i njëjtë revidohet në vitin 2022. Sot jemi në vitin 2025, Plani Zhvillimor Komunal ende nuk është i finalizuar. Pse ne duhet me hy në këtë fazë tash? Por dikur duhet me fillu ky proces. Unë nuk e kam hallin kur përfundon, sepse as unë nuk e di kur. Ne e kemi të qartë se si zhvillohet procedura për të punuar, sepse mund të referoheni në Planin Zhvillimor Komunal. Mbahen diskutime publike, sipas udhëzime administrative, sepse në të kundërtën ne nuk mund ta kalojmë, e unë nuk e trezikoj procesin, duke bërë ndonjë anashkalim procedural, sepse në fund kjo do të shkoj në ministri, për të marrë pëlqimin final. Nëse tejkalimin më të vogël unë e bëjë, ajo nuk kalon. Unë s'mundem me thënë, hajde po pushojmë deri në zgjedhje dhe pas zgjedhjeve të fillon dikush këtë proces. Unë kam bërë propozim për fillim të procedurës. Ligji i jep të drejtë, organit komunal, për të bërë një vlerësim dhe me konkluduar, se sa e ke zbatueshmërinë. Periudha tetë vjeçare është shumë e gjatë, që të mund të përcaktohen zhvillimet komunale. Nuk mundesh me kornizë buxhetore me ditë, çka ke me punuar ti si komunë, por s'mundemi me e ditë cili ka me qen trendi, jashtë i qytetarëve dhe cilat kanë me qenë kërkesat. Po supozojmë tek sektori i shëndetësisë ose i banimit ose banimit të lartë. Fillon procedura për revidim, pastaj vazhdojmë me hapat e tjerë sipas ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Pasi që u shterua debati, unë kam një propozim nga koleguz Hasan Ismajli, për ta pyetur Zyrën Ligjore, a vazhdon me mbajt qëndrimin apo jo?

Hasan Ismajli: Meqenëse këtu në ligj shkruan me 2/3 e votave, unë nuk e mbaj atë qëndrim, hedhë në votim. Nëse i kanë votat kalon, sepse unë nuk e kam ndërmend që t'i ruaj pronat e Fushë-Kosovës.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e vuri në votim për aprovim ‘Propozim për fillimin e procedurave për revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, vota ‘kundër’ nuk ka dhe asnje ‘abstenim’. Gjithsej pesëmbëdhjetë anëtar të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se: Kuvendi i Komunës nuk e aprovoi ‘Propozim për Fillimin e Procedurave për Revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.

Pika e tretë (3) - Propozim për Fillimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën Urbane në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim ‘Propozimin për Fillimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën Urbane në Fushë-Kosovë’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban të na jap sqarime.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban: Propozim për fillimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën Urbane në Fushë-Kosovë, kjo ka të bëjë me Zonën Urbane të qytetit të Fushë-Kosovës. Pjesa që lidhet prej rrugës ‘Gjergj Fishta’ deri tek rruga e ‘Uglarit’. Ky propozim vjen si arsyé që ne të kemi një plan rregullativ, që të sigurohet një vazhdimësi e proceseve që ndodhen. Në këtë zonë, përballemi çdo ditë me kërkesa të ndryshme, prej qytetarëve me arsyen, që ne nuk po mundemi të ofrojmë shërbime, për momentin. Kjo vjen si rrjedhojë se në Drejtorin e Urbanizmit edhe unë edhe zyrtarët e kemi një pasiguri juridike, për kundër disa interpretimeve, që i ka bërë edhe ministria e pushtetit lokal, që ju jep të drejt një farë forme qytetarëve të asaj zone. Me hartimin e një plani rregullativ, kishim me qenë në gjendje si Komunë që të ofrojmë shërbime të Drejtorisë për Planifikim Urban, mandej edhe te sektorëve të ndryshme, për banorët e kësaj zone. Po të njëjtën kohë kishte me qenë edhe një bazë ligjore që ne me qenë, më të argumentueshëm edhe juridikisht në një pozicion më të favorshëm si zyrtar që të mund të lëshojmë akte administrative. Ato akte administrative munden me qenë të natyrave të ndryshme. Në bazë të ligjit për planifikim hapësinor prapë, ky është një plan i nivelit më detal. Në rangim më i ulët. Ka të bëjë me planin rregullues, që mund të përpilohet për zona të caktuara. Juridikisht ne kemi konstatuar, kemi bërë edhe një pyetje se Plani Zhvillimor Komunal aktual a është i vlefshëm? Interpretimi është se ky planë është i vlefshëm dhe nuk mund të themi se Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka PZHK, se duhet të plotësohet kriteri që me pas PZHK. Së pari edhe ka sepse nuk mund të krijohet vakum ligjor. Deri sa të miratohet, plani zhvillimor i ri, mbetet në fuqi ai i cili është në ligjin për planifikim tek dispozitat kalimtare. PZHK-ja e vjetër mbetet në fuqi, deri sa të aprovohet i riu. Fushë-Kosova ka edhe Hartë Zonale dhe mund të hapet rruga për të filluar procesin për të hartuar plan rregullativ, jo vetëm të asaj zone, por të gjitha zonave. Por, duke marr parasysh që HZK si dokument, e ofron mundësinë që ne të punojmë dhe të lëshojmë kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore, për cilën do zonë brenda komunës së Fushë-Kosovës, përvèç se këtu. Sepse po mos të kishe qenë çështja ma specifike, nuk kishim ardhur në kuvend fare për tu marrë me këtë çështje. Këtu normal që është një çështje pak më e ndjeshme. Ka mbetur një pjesë e vogël e blloqeve, qytetarëve që ka mbet pa shërbime në atë pjesë, ku ju është mohuar e drejta. Këtu disa e kanë shfrytëzuar këtë të drejt disa jo. Një interpretim prej Ministrisë së Mjedisit, është një argument që nuk e kam dhënë sepse pala ka qenë në mënyrë vetanake, nuk ka shkuar

komunikimi përmes drejtorisë dhe nuk kam dashur të ju jap dokument operatorëve ekonomik, me shpërnda tek Kuvendi. Thuhet se Komuna e Fushë-Kosovës, duhet ti ndërmarr të gjitha veprimet e mundshme konform legjislativit në fuqi dhe të shqyrtoj ankesën e palës, lidhur për parcelat kadastrale, në mënyrë që i njëjtë ta realizoj të drejtën e tij. Për sigurimin e kushteve, për ndërtimin e objekteve në Komunën e Fushë-Kosovës, të gjitha këto iniciativa kanë qenë iniciativa private dhe nuk kemi qenë zyrtarisht të përfshirë në proces. Por, palët i kemi refuzuar, pastaj kanë shkuar tek një instance më e lartë për të krijuar interpretim. Situata po të kishte qen e zakonshme do të zgjidhej me hartën zonale katër vite më herët. Por, normalisht nuk është kjo situatë dhe për ata e kam sjell këtë propozim, sepse kemi hapësirë ligjore të fillojmë me hartimin e një plani rregullativ, për bloqet e caktuara, që janë të përmendura në propozim.

Laureat Gojnovci: Duke i parë kërkesat e qytetarëve, shumica prej neve kemi komunikim të vazhdueshëm, me qytetarët e asaj pjese, që nuk kanë shërbime në atë pjesë. Ne e kuptojmë se ka nevojë që të bëhet një dokument, për të na lejuar që t'i përfundojmë gjitha kërkesat administrative, çoftë edhe ekonomike e sociale, të asaj zone. Ju kisha bërë ftesë edhe kolegëve tjerë që ta përkrahin këtë propozim nga Drejtoria e Urbanizmit, sepse qytetarët nuk dinë ku ti adresojnë kërkesat e tyre. Ne si grup parlamentar e përkrahim.

Durim Hajra: Kjo është një temë që kërkon më shumë sqarim dhe më shumë dokumentacion, duke marr parasysh prej fjalisë së fundit të cilën e tha kolegu. Ne jemi laik të fushës, seriozisht nganjëherë nuk dimi si t'i qasemi disa gjërave, kur nuk kemi njohuri, sidomos për këtë pjesën e zonimit të hartës zonale, e disa gjërave të tjera. Mua prapë po më duket e çuditshme për një shqetësim kaq të madh të asaj pjese të qytetarëve, është dashur të kemi më shumë sqarime, me shumë dokumentacion, që të dimë saktë ku qëndron problemi. Pyetja e parë për ju i nderuar drejtor është që duam ta dimë ku është saktë kjo parcelë? Për cilën zonë bëhet fjalë saktë? A bëhet fjalë për objektet të cilat janë të ndërtuara, në zonën Kadastrale të Fushë-Kosovës apo Graqanicës? Pyetja e dytë, a lejohet me ligj që ne me bëré plane të tillë, çoftë si drejtori çoftë si kuvend për atë zonë? Po ashtu përgjigjet me ministrit e linjës, pse nuk i kemi sot përpëra? Sepse mendoj se ato janë transparente dhe ty mendoj se të kishin shërbyer shumë edhe e kishe pasur më lehtë sidomos raportin me opozitën. Nga ajo do të shihej qartë se cili është qëndrimi i nivelit qendror, në lidhje me këtë çështje. Mos të keqkuptohemi, sepse në parim jemi të gjithë për të ua lehtësua dhe për të ua rregulluar jetën qytetarëve. Po ashtu jam për të diskutuar dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme, për shkak se e dimë se në çfarë gjendje janë banorët të cilët jetojnë në atë zonë, si me prona dhe me shërbime e çështje të tjera. Këtu vetëm një përgjigje është e çartë, që fajin kryesor e ka qeverisja 25-vjeçare e Lidhjes Demokratike të Kosovës. Më herët nuk ka pasur interesim për këtë pjesë.

Mirsad Qyqalla: Unë e pash zonën të cilën, jemi duke e diskutuar. Kjo hyrje siç po e shohim është komplet e pa drejt. Ju drejtor thatë se ne kemi të drejt gjithkund. Më habitë, sepse jashtë territorit të komunës së Fushë-Kosovës ne nuk mundemi të planifikojmë asnjë, sepse s'ka logjik. Por, nëse shohim a kanë nevojë ata banor, mendoj se kanë shumë, por në momentin që do të ishte organizuar një bazë e mirë ligjore, që kjo pjesë të kalohet në komunën e Fushë-Kosovës, përkundër krejt përfitimeve dhe interesave që kishim mundur t'i kemi, unë e kisha dhënë votën sepse besoj që ata banor duhet të kenë shërbime. Ata banor sepse janë mbet keq, por banorët nuk janë mbetur

keq me fajin tonë. Me sa e di unë kjo pjesë nuk është e përfshirë as me hartë zonale. Unë kam bindje të plot që kjo nuk është bërë pa qëllim, sepse me dërgua hartën zonale me këtë pjesë të përfshirë, ministria e kish kthyer menjëherë, sepse nuk mundesh të planifikosh me hartë zonale një territor i cili nuk është i yti. Ju përgatituni përmes drejtorisë suaj e jo përmes dorës sonë, për një territor që si përket Komunës sónë. Unë po them që kam pas kërkesa personale prej atyre banorëve për disa shërbime, mirëpo mua më ka ardhur keq të vijë të kërkoi në komunë, sepse janë në territor tjetër. Unë mendoj se banorët e asaj pjese duhet te drejtohen nga qeveria dhe jo nga komuna. Interesant para zgjedhjeve, çdo herë vijnë disa pika rrëth ndërtimit. Unë mendoj se kuvendi e ka të pamundur që ta trajtoj këtë temë, sepse është zonë jashtë kufijve të zonës dhe nuk e di si po e keni të drejtën. Inderuari drejtor po e potencoja, në këtë foltore kur ju keni kërkuar që të bëhet planin zhvillimor komunal, përfaqësuesi i INSIT, që e ka përgatit, në prezencën e gjithë kuvendit ka thënë që unë bëjë plane rregulluese, sepse paguhem, aty ku ju me thoni ju unë e përgatis, në të kundërtën këtë planë me këtë pjesë ta kthen ministria, sepse nuk ka një vendim. Unë pajtohem që duhet që të trajtohet kjo pjesë, sepse e vërtet që shumë keq kanë mbetur. Duhet me i 'u dhënë një ndihmë. Mirëpo jeni duke e shkelur ligjin, sepse këta banor edhe pse janë afér Komunës së Fushë-Kosovës, mbi të gjitha janë banor të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Prandaj kishte qenë mirë që t'i prini me një debat gjithëpërfshirës me Kryetarin, me ministri, që me ju bërë zgjidhje, por jo përmes Kuvendit sepse Kuvendi nuk e ka këtë autoritet.

Hasan Ismajli: Drejtor me gjithë respektin që kam, unë nuk po mundem me të kuptuar. Me ju thënë i padijshëm, nuk jeni, me ju thënë jeni ka doni me na mashtuar, nuk po e di a për interes tëndin personal apo interes të të tjerëve. Këto zona të cilat kanë mbetur pa u trajtuar, me të vërtet kanë mbetur keq. Por, e kanë pasur mundësin që të trajtohen para vitit 2020, para se të bëhej harta zonale, por nuk kanë dashur. Kur keni dhënë leje në atë pjesë dhe i keni ftuar në takim, e ju keni thënë apo doni me hy me i trajtuar, sepse fleta poseduese është tek ne. Plani Zhvillimor Komunal i vjetri, i cili po thua që është në fuqi, e ka trajtuar atë pjesë aty, këta nuk kanë dashur të trajtohen. Harta Zonale ka përfunduar në tetor të vitit 2020. Këtë hartë e ka paraparë kjo kompania që po i merr të gjitha projektet INSI, u'a ka bërë edhe hartën zonale dhe atë pjesë nuk e ka trajtuar, sepse e ka ditur pse nuk e trajton, sepse ajo pjesë me vijë administrative, është pjesë e Graqanicës dhe ata banorë, që i keni trajtuar para vitit 2020, sot kur vijnë në zyrën e ofiqarisë, nuk mund të pajisen me vërtetim që janë banorë të Komunës së Fushë-Kosovës dhe këta nuk paguajnë tatim pronë. Unë po them hartimi i planit rregullativ që ju po doni ta bëni, ai duhet të bëhet në përputhshmëri me Hartën Zonale dhe aty hartë zonale nuk ke, koeficient nuk ke. Qysh e cakton koeficentin, sepse ajo bëhet në përputhshmëri me Hartën Zonale. Ju në mandatin e kaluar e keni bërë, me një koeficient 3,2, keni pas dhënë edhe tek QMF-ja, pjesën tek xhamia, rrugën 'Pajazit Islami' me koeficient 3,2, me një vendim qe ka kaluar në kuvend dhe kur e ka kthyer ministria për me shfuqizuar, ish-kryesuesja e kuvendit, katër muaj e ka mbajtur në sirtar, jashtëligjshëm, deri sa janë përfunduar të gjitha pazaret dhe pastaj e ka sjellë në kuvend dhe e ka shfuqizuar. Një ditë keni me dhënë përgjegjësi ju që keni dhënë leje atje, sepse zyrtari ligjor po më kundërshton mua kur po i them. Ne mbajmë vendime të jashtëligjshme në fuqi. Të njëjtën parcelë e kemi tek tregu. Ka ardhur dy herë që të shfuqizohet, e keni mbajtur në fuqi. Edhe sot pas tre muajve nuk është bërë i plotfuqishëm ai vendim drejtor, për me fut atë pjesë aty. Sepse ju jeni duke tentuar me patjetër që ta bëni Revidimin e Hartës Zonale, atë leje nuk e di se kush ka me lëshuar, sepse ajo është jo e

rregullt. Për ta bërë hartimin e planit rregullativ, duhet me marr pëllqim prej Ministrisë së Planifikimit Hapësinor. Ju mund ta keni pasur pëllqim gojor, mundeni me pas edhe zyrtarish dokumentacion, por ne nuk kemi asgjë nga ai dokumentacion, sepse ju po e kërkon votën nga ne. Ju jeni të pajisur me dokumentacion ndërsa ne e kemi një propozim të vetëm. Unë ju them se ju nuk keni pëllqim nga Ministria e Planifikimit Hapësinor për atë pjesë. Drejtor andej një pjesë të rrugës e ke me emra serb. Pyes, a ke me i ndryshuar ata emra? Sepse këtu e kam kolegen e cila është kryetare e komisionit për ndryshimin/emërtimin e rrugëve dhe ne kemi me kërkuar nëse ju doni me sjellë atë, keni mi ndërruar edhe ata emra. Në shkollën ‘Aneksit 2’, kur i vjen frakturna e ujit vjen me komunë të Graqanicës. Po ashtu kur shkon në restorantin ‘Mero’ në fakturë shkruan Komuna e Graqanicës. Vija që është përcaktuar me planin e Ahtisarit, nuk mundet askush me ndryshuar, përveç Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban: Të nderuar në një fazë të mëvonshme unë e kisha pajisur Kuvendin me informata dhe me dokumentacion të pjesës hartografike, nëse e fitoj të drejtën për të hyrë në përpilim, sepse unë nuk e di se a kam me fituar të drejtën. Ky është propozim për fillim të procedurave dhe besoj se në këtë fazë ishte dashur të konkludohet qe a është e ligjshme kjo çka po propozoj. Unë nuk jam urbanist dhe nuk e kam kompetencë që të projektoj për komunën. Unë jam arkitekt. Na duhet një asistencë e jashtme sepse nuk kemi kuadro profesionale që ta përballojmë edhe një këso pune voluminoze, sepse nuk e kemi bërë as në të kaluarën e as tash, as për revidim as për planin rregullativ. Unë detyrën nuk e kam marrë qe një kohë të gjatë. Unë jam qe një vit drejtor dhe nuk kam mundur t'i filloj të gjitha proceset qe e kam parë në procedurë, e tutje që janë të nevojshme për të funksionuar, që janë të domosdoshme me siguruar një funksionim normal brenda drejtorisë. z. Hasan Ismajli tha kush ka lëshuar leje më herët, normal që zyrtarëve ju duhet edhe një siguri juridike, kjo është Harta Zonale e Komunës së Fushë-Kosovës, që ajo kompani ka punuar me kufij kadastral të Fushë-Kosovës. Pse nuk e ka venfosur këtu një ngjyrë, unë nuk jam përgjegjës. Me pas qenë pjesë e procesit, unë nuk e kisha toleruar një gjë të tillë. Ju po punoni me Zonën Kadastrale në Fushë-Kosovë, por një pjesë po e lënë pa ngjyrosur. Këtu duhet me ia vendos një ngjyrë. A është banim, komerciale, afarizëm një ngjyrë duhet me ia vendos. Ka mundur të lihet bujqësore me koeficient 0, por nuk ka mundur ta lënë “billako”. Kështu që kjo është pjesë e HZK-së, sepse hartografia po e fut brenda. Por ai e ka lënë pa e ngjyrosur. Ndoshta e ka lënë mos me i'a komplikuar procesin, sepse fundi i fundit ai ka qenë konsulent i jashtëm edhe ka dashur me përfunduar projektin. Unë s'kam qenë pjesë e procesit, unë konkludoj që nëse juridikisht zyrtarët e urbanizmit, deri në atë vit e kanë pasur një PZHKA dhe një PZHUA, e që këto të dyat e kanë pasur një destinim. Ata zyrtar nuk kanë bërë asnje shkelje, që kanë lëshuar leje ndërtimore në atë zonë, sepse e kanë lëshuar me dy plane hapësinore, te cilat kjo komunë i ka pasur të aprovuara dhe i ka pasur në fuqi. Kur do që vendos Qeveria e Kosovës që ato prona prej Zonës Kadastrale merren dhe i'a jep Graqanicës, për ne asnje problem nuk ka. Mirëpo ai proces tash e njëzet vite nuk ka ndodhë. Ky kufi nuk u caktua në vitin 2018, kufiri komunal është ashtu siç e prezanton z. Mirsad Qyqalla, Kufiri Administrativ dhe Zona Kadastrale është Fushë-Kosovë, Fleta Poseduese, Kopja e Planit janë Fushë-Kosovë edhe shërbimet ata qytetar i marrin në Fushë-Kosovë. Kur do që qeveria në bashkëpunim, me Agjencionin Kadastral

edhe me të gjithë arteriet vendos që ta dërgoj atë pjesë në Graqanicë, ajo le të ndodhë lirshëm. E nëse është e mundshme le të shkojnë të gjithë me komunën të Graqanices dhe të bëhen votues të Graqanicës, me një kryetar shqiptar në një të ardhmen. Mirëpo ne nuk jemi pjesë obligative e atij procesi, dhe si përgjegjësi e jona është që të sigurojmë bazën ligjore. Të sigurojmë një zhvillim të balacuar. Ne mundemi me heq veten prej përgjegjësisë, që s'jemi kompetent as për ndriçim publik, as për kanalizim, as për rrugë dhe me lënë atë pjesë, në një vakum hapësinor, kjo është e pa drejt dhe nuk krijon zhvillim të balancuar. Në anën tjetër kemi ndërtuar edhe institucion publik shkollë dhe normalisht që është situatë specifike. Sa i përket sistemit të adresave i kemi dy zyrtar të ministrisë, të cilët janë duke i regjistruar banorët dhe janë duke dhënë shërbim, konfirmim të adresës për atë zonë. Kjo është kompetencë e agjencionit. Momentalisht janë duke u regjistruar me Komunën e Fushë-Kosovës, por bartjen mund ta bëjnë kur do që ata e shohin të arsyeshme. Unë për ata po e bëjë vetëm një fillim të procedurës, sepse nuk e di ndoshta ky planë rregullativ, ndoshta mund t'i marr dy vite. Ndoshta mund të vonohet si PZHK pesë vite. Paralelisht jemi në proces me Komunën e Shtimes, ku e njëjtë kompani është INSI edhe atje, VSM dhe PZHK-në, vlerësimin e parë Komuna e Shtimes e merr brenda dy jave, ndërsa ne kemi pritur nëntë muaj, për një përgjigje të thjesht, ku thotë se ju mungon kopja digitale, nuk mundemi me paragjykuar se kur do të përfundoj. Për ata është vetëm fillim i procedurave. Unë mendoj se prej se e kam marr detyrën unë, PZHK-në e kemi mbërritur shumë shpejt në fazën finale. z. Durim Hajra e ka parashtruar një pyetje, ku thotë a bëhet fjalë për objektet në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë dhe Uglar. Me flet poseduese krejt ajo zonë është Fushë-Kosovë, kufiri administrativ është Fushë-Kosovë. Ky që po e shikon që ka qenë Hartë Zonale, por ka mbet i pa projektuar. Nuk mundesh ti edhe me fut në HZK edhe me lënë me kodë 'bllanko', ai u dashtë me i vendos një vlerë, cila do qoftë ajo. Me i vendos koeficientin 1 thonë e ke vendos, me vendos 3 thonë e ke vendos shumë. Unë dhe drejtoria nuk e kemi kompetencë këtë çështje. Neve na duhet një konsultim me një kompani, që ne më vonë mundemi ta kontraktojmë. A është i ligjshëm përpilimi? Unë them që është i ligjshëm, sepse baza ligjore duhet t'i ketë dy planet e përfunduara PZHK-kemi HZK-kemi. Komunikimi ka ndodhur me palë private dhe operatorë ekonomik që kanë qenë në proces. Unë e kam parë të pa arsyeshme, komunikimin edhe me imela edhe vendimin që ua kanë dhënë palëve, sepse palëve u kanë dhënë përgjigje të kthehen në Komunën e Fushë-Kosovës sepse e kanë për obligim që ta trajtojnë. Me pas dashtë me shfrytëzuar atë mundësi, ne kishim vazhduar me atë. Vendimin të cilin e përmendi kolegu z. Hasan Ismajli me sa e di unë nuk është shfuqizuar.

Mirsad Qyqalla: Drejtori që disa herë po e potencon, mos mu ndal me prit. Unë po them që në këtë situatë të cilën është krijuar nuk kemi mundësi pa prit. Pjesa tjetër, komunikimi me ministri, a ju keni drejtuar me ndonjë pyetje për të na sqarua se çka kanë thënë kur ju keni drejtuar? Për mua çka po mbetet e pa qartë, është se ne jemi për të ju ndihmuar por me një kushte! Duke mos e shkelur ligjin asnjëherë, nuk merr përgjegjësi Qeveria, nuk merr përgjegjësi Komuna e Graqanicës, Fushë-Kosovës, vjen në Kuvend dhe barra me na mbetur neve. Pse duhet ne të përballemi me një situatë të pa qartë, qoftë edhe kur keni të drejtë. Për pjesën tjetër këto pika na vijnë për arsyë se jemi afër zgjedhjeve. Por prapë po e them, duhet të gjejmë një rrugë alternative, që është e pranuar edhe në anën ligjore. Rruga e Kuvendit nuk është zgjidhje për këtë.

Hasan Ismajli: Drejtor ju thatë në vitin 2022, është bërë Revidimi i Planit Zhvillimor Komunal. Ju nuk keni pasur revidim por, keni pasur një propozim të ish-drejtorit tuaj. Propozim-vendim për bonuset e zoonimit, sipas HZK-Fushë-Kosovë. Ndërsa më 20.02.2022, unë nuk mbaj mend që ky Kuvend ka bërë revidim. Na the që kompania nuk e ka trajtuar, nuk e ka ngjyrosur, pyes pse? A nuk keni guxuar? Tash ju jeni drejtor dhe duhet me thirr këtë kompani dhe me i thënë ne të kemi paguar, nuk kemi hyr ne pazare me ju. Pse nuk e ke trajtuar këtë pjesë zyrtarisht dhe zyrtarisht me kërkuar përgjigjen dhe atë përgjigje me na e sjellë neve në Kuvend. Ti nuk je më i interesuar se unë, për t'i trajtuar ata qytetar në atë pjesë, sepse unë ata i njoh qe 30 vite. Njëri profesor i nderuar, tash në pension, tjetri biznesmen e me radhë të tjerët. Kur e kanë pasur mundësin që të trajtohen dhe me marr leje ashtu siç e kanë marruar komshiu. Nuk keni dashtë, sepse nuk ka qenë i interesuar. E tash ka mbet as andej as këndeja dhe thotë tash duhet me e trajtuar. Qysh të trajtohet, me na e sjellë neve asamblistëve këtu dhe me një votim të jashtëligjshëm të përfundohet. Ju e dini se edhe unë i kuptojo do gjera, por ju e di se dini më shumë se unë. Por, mos të votojmë diçka, që nuk është në tregull, sepse ju i keni disa voto dhe e votoni e mbanë në fuqi.

Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban: Po thua shumë të pasakta dhe për ata po dal me dhënë kundër argument. Kur e përmenda Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe vendimin e kuvendit, e përmenda me qëllim për të treguar sa shumë kohë ka marrë vendimi i parë, u marr në vitin 2020 dhe u plotësuar 2022. Tash jemi në vitin 2025, pesë vite kanë kaluar deri sa jemi në këtë pikë. Arsyja pse e përmenda ishte kjo, me datë 08.08.2022, është marrur vendimi, e PZHK siç e dimë ende nuk është kryer. Mos të paragjykohet procesi, ia keni dhënë INSIT. Unë edhe njëherë po them ky propozim, e ka këtë arsyeshmëri, baza ligjore është kjo, a ka kundërthënie ka, sepse nuk është situatë standarde, sepse nuk kish pasur nevojë me ardhur këtu fare. Nëse ne e marrim të drejtën që të përpilojmë këtë planë rregullativ, besoj së pari atyre qytetarëve ju kryhet një shërbim i madh, sepse ne nuk mundemi me thënë se e kanë pasur shansin e nuk e kanë shfrytëzuar. E këtë nuk mundesh me i' a thënë as palës, e ke pasur shansin dhe më nuk e ke. Ne duhet me ua mundësuar.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e vuri në votim për aprovim ‘Propozim për fillimin e procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën Urbane në Fushë-Kosovë.

U votua me: trembëdhjetë vota ‘për’, vota ‘kundër’ nuk ka dhe asnjë ‘abstenum’. Gjithsej pesëmbëdhjetë anëtar të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e aprovoi ‘Propozim për Fillimin e Procedurave për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën Urbane në Fushë-Kosovë

Pika e katërt (4) - Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës, nëse kanë pyetje, ta marrin fjalën.

Etnik Berjani: Kam një pyetje për Drejtorin e Inspeksionit, A ka ndërmarrë Drejtoria për Inspektorat ndonjë masë për klimat e vendosura jashtë objekteve banesor, të cilat paraqesin një rrezik për qytetaret që lëvizin poshtë, nëse jo, a pritet të ndërmerrni diçka?

Durim Hajra: Kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, lidhur me projektin e drunjtëve dekorativ, në lagjen ‘Dardania’, a ke ndonjë raport në baza ditore, çka është duke ndodhur me atë projekt, sepse një ditë fillojnë punimet më pas pesë ditë ndërpriten, shkatërrohen. Janë të paktën tri raste në rrugën ‘Pajazit Islami’, ku makineritë e rënda, i kanë dëmtuar bazamentin e çelikut dhe drunjtë në disa raste. Kishte qenë mirë që të merren masa ndaj operatorëve dhe qytetarëve të pa përgjegjshëm. Po ashtu trajtimi i qenve endacak, nuk është që ka qenë problematikë shumë e madhe, sidomos në pjesën e qytetit, por kohëve të fundit janë bërë problem. Rruga ‘Dardania’ dhe rruga ‘Pajazit Islami’, qe janë të frekuentuara më shumë prej qytetarëve, qentë janë kthyer në rrezik sidomos për fëmijët. Po ashtu kam një çështje tjetër për rrugën ‘Hajrulla Zymi’, një përgjigje kam marrë nga Drejtoria e infrastrukturës, të cilët thonë që projekti do të vazhdoj, por me sa po shohim është vonuar në vazhdimin e punimeve dhe në disa raste punët nuk janë kryer siç janë paramasatë dhe paralogarit. Kishte qenë mirë të inspektohet nëse është projekti në proces të implementimit, që të mos na përsëritet ajo situata e mëhershme që u deshtë të intervenohet prapë në një rrugë, pas një kohe shumë të shkurtër, për shkak të papërgjegjshmërisë qoftë të operatorit, qoftë të personit përgjegjës përmbyqyrje. Po ashtu rruga ‘Vellezërit Gërvalla’, këta banor kanë pasur edhe peticion edhe kërkesa të vazhdueshme që kjo rrugë të rindërtohet ose të sanohen dëmet të cilat janë aty. E di që e kam marr një përgjigje para dhjetë muajve nga drejtori, mirëpo ndoshta me këtë projektin e ri do të ndërhyhet edhe në rrugën ‘Vellezërit Gërvalla’.

Migjen Kolshi: Unë kam vetëm një pyetje, drejtorët e drejtorive a janë në shërbim të qytetarëve apo në shërbim të komunës? Nëse janë në shërbim të qytetarëve, si ka mundësi që në fshatin Harilaq, qe 40 ditë, nuk ka transport të autobusëve. Çka ka bërë Drejtoria e Shërbimeve Publike në këtë rast? A ka ndërmarr diçka? Unë edhe më herët e kam ngrit këtë çështje, por nuk është ndërmerrur asgjë. Përgjegjësia i bie Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Kryetarit të Komunës. A ka mundësi drejtoria me subvencionua kompaninë sepse kanë mbetur keq qytetarët e Harilaqit.

Hasan Ismajli: Inderuar Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinis dhe Sportit, në vitin 2024 na e ke sjellë një kërkësë për Federatën e Futbollit, për t’ia dhënë një pronë, tek pishat për ndërtimin e një akademi të futbollit. Kjo pronë është afér tre hektarëve, por me Hartë Zonale janë dy destinime, njëra është për sport dhe tjetra muze natyral. A i keni kryer procedurat? A e keni bërë ndarjen fizike dhe a e keni caktuar cila pjesë i takon federatës së cilës i’ a keni dhënë, apo ka mbetur tre hektar me i marr ai zotriu. Është mirë me na dhënë një përgjigje nëse e ke. Pyetjen tjetër e kam për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit, Pronës dhe Gjeodezisë, është një parcelë prej 300 metra, në rrugën ‘Hamdi Grajqevci’, në vitin 2018 ke pasur ndryshim, keni ndërhyrë në grafik, dhe ja keni bashkangjitur, një pronari privat. Unë e kam në dokumentacion, kjo kështu duhet me qenë dhe si është sot. Ndërsa ju e keni bërë kështu, besoj se po shihet, ku një pjesë e keni ‘hangë’ dhe janë 300 metër, pronë komunale, që iu është bashkangjitur këtyre tri parcelave dhe parcelat e vjetra, kanë qenë diku 25 ari, me bashkangjitjen e këtyre 300 metrave, ka dalë 28 ari dhe leja ndërtimore, me të drejtë, sepse me dokumentacion në Drejtorin e Urbanizmit ka shkuar në rregull, fleta poseduese, kopja e planit, grafika me 28 ari. Atëherë Harta Zonale nuk ka qenë në funksion dhe ndërtimi ka qenë 50 me 50 dhe në këto 300 metra, këtij zotriu i kanë takuar 150 metra katror, për çdo katë dhe kur llogaritet dalin 1550 metra katror që ka ndërtuar me shumë, me këtë pjesë që ju ka shtuar. Këtë çështje e kam ngritur edhe në vitin 2022. Këto dokumentacione u’ a kam shpërndarë edhe Shefave të Grupeve Parlamentare dhe Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, po

ashtu Auditorit tē Përgjithshëm dhe kjo lëndë e di që është në prokurori. Në vitin 2023, keni ndërhyrë dhe e keni kthyer në gjendjen si ka qenë, i njëjtë rast si me parcelën në Bresje, a keni ndërmarr diçka pér këtë çështje? Ose a kishe mundur në seancën tjetër me na tregu, se a jam un i sakt, a ka pas ndërhyrje në këtë pronë, sepse në vitin 2022 u bë bashkimi i parcelave, në të cilën është dhënë leja ndërtimore dhe 2023 prap ka ndërhyrje dhe u kthye në gjendjen e mëparshme, këtu është një përfitim i madh, kur e llogarit me 600€, mundeni me marr me mend sa është fitimi këtu dhe prej kësaj dikush ka përfituar. E njëjtë është duke ndodhur në rrugën ‘Pajzait Islami’ këtu i bashkohet tri parcelave, 1 ari e 80 metra dhe kjo është ende në gjendjen te cilën është ndërhyrë, këtë leje e ka lëshuar Drejtori i Urbanizmit. Kam pyetjen e fundit pér Drejtorin e Inspektoratit, kjo shtëpi në lagjen 028-029 është ndërtuar, me bashkëfinancim, me një marrëveshje tē Kryetarit tē Komunës dhe tē një Organizate Jo Qeveritare, ju e dini se ajo pjesë me Hart zonale, lejohet ndërtimi 8+1 dhe kjo është 8+2, informatat te cila i kam, ka leje ndërtimore vetëm pér 8+0 dhe dy kat jan më shumë, kërkoi tē na sqaroni, a është e vërtet dhe nëse është e vërtet pse nuk ke reagua, sepse komuna e Fushë-Kosovës bashkëfinancim i ka dhënë 150.000.00€ dhe këto para jan tonat, nëse këtu ndërtohet pa leje, a nuk e ki tē drejtën me shkuar dhe me i thënë qytetarit, mos ndërtu pa leje, sepse ne po e shkelim ligjin, pres përgjigjen.

Dardane Sogojeva Shala: Kam një pyetje pér Kryesuesin e Kuvendit tē Komunës, a ka mundësi me na treguar, ku gjendet asistentja juaj e cila merr një pagë mujore prej 500€, në muaj dhe qe katër vite asnjëherë nuk e kemi parë? Po ashtu kam edhe një pyetje pér Drejtorin e Inspektoratit, i nderuar drejtor keni marr aksion pér mbylljen e qendrave te masazheve, por pas tri dite jan hapur prap, a mundemi me dit kush qëndron pas tyre, sepse hapen dhe ju nuk keni te drejt te shkonit dhe ti mbyllni prap, kishte qen mirë me treguar. Kam edhe një pyetje pér Drejtorin e Infrastrukturës, në rrugën, ‘1 Tetori’, ka premtuar drejtori që ka me rregulluar, sepse andej lëvizin fëmijët e fshatit Sllatinë e Vogël, sepse shkojnë në shkollë dhe rruga prap është në at gjendje, nuk është ndërmarr asgjë, aty fëmijët janë tē rrezikuar.

Fidan Berisha: Kam një pyetje pér Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, çështjen te cilën e ngriti edhe kolegu im z. Migjen Kolshi, pér ndalimin e linjës së autobusëve dhe ndriçimin publik, muajin e kaluar na ke premtuar se pér tē dy çështjet do ti ndërmarr hapat e duhur, nëse ka mundësi një pyetje tē sinqertë sepse po pyesin banorët e fshatit Harilaq’.

Hasime Kostanica: Kam një pyetje pér Drejtorin e Shëndetësisë, si është mundësia pér kthimin e departamentit tē gjinekologjisë, në Qendrën Klinike tē Mjekësisë Familjare në Fushë-Kosovë?

Mirsad Qyqalla: Pyetjen e par e kam pér Drejtorin e Infrastrukturës, ndërsa Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis, më ka thënë se ka informatë, ky projekt është prej Pishave tē Sllatinës e që shkon pér Bardh tē Madh, në këtë projekt shihen tri korsi, ne kemi dal dhe i kemi vizituar dhe e kam par se një mungon, nëse ke mundësi me na sqaruar? Pyetjen tjetër e kamë pér Drejtorin e Infrastrukturës, ke prezantuar se kur nuk shtrohet cilësia e asfaltit mirë, mundemi me largu, un ju njoftoj se asfalti i cili u shtruar para 3-4 muajve gjendja ekzistuese është kjo, besoj se po e shihni përmes fotove, po ashtu kërkoi ta di nga këto foto siç po i shihni, ky projekt është i përfunduar, prandaj kërkoi përgjegjësi, kush ka qen ai menagjer i projektit, që e ka pranuar këtë projekt si tē përfunduar, në këtë gjendje, sepse ajo që na u ka prezantuar në projekt dhe gjendja ekzistuese në teren nuk ish e njëjtë. Po ashtu pér oborrin e Komunës, ku keni thënë se se ka përfunduar punën si duhet, e pash se e njëjtë kompani kish marr tender, a’ ka këtu ndonjë mbikëqyrje që kur se përfundon punës si duhet, nuk është mirë me i dhënë prap tē njëjtë tender. Drejtorisë së

Inspektoratit, i nderuar dua te flas për lirimin e hapësirave publike, Nënkyryetari i Komunës, na ka premtuar që nga muaji mars do filloj më me lirimin e hapësirave publike dhe përvëç dy tri fotografive, nuk është ndërmarr asgjë tjetër, gjendja ekzistuese në teren është ashtu siç ka qen më parë. Për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, kemi çdo her probleme me pastrimin e hapësirav publike, vitin e kaluar dilshin disa foto ku jemi duke u marrur me disa varreza, nëse ka ndonjë plan ish dashur me kan tash, un pash në fshatin Bardh të Madh me donator i kryshin edhe nuk është hera e par që ndodhë, e kur po na vin shpenzimet në fund të vitit, po del që një kompani edhe i ka marr parat për ato punë dhe qytetarët po i mbarojnë vet. Drejtorit të Kadastrit dua ta pyes kush e ka të drejtën me hyr në xheo portal dhe me ndërhyrë, po ashtu çfarë hapash janë ndërmarr për këto ndërhyrje. Dua ta pyes edhe Drejtorin e Kulturës, Rinis dhe Sportit, për sallat te cilat një here jan ndërtuar, pastaj jan rinouar dhe prap jan jo funksionale, a mundesh me na shpjegua pse s'po funksionalizohen? Vazhdimi shpesh po insistohet me një transparencë, por sipas një raporti, Komuna e Fushë-Kosovës, është komuna e fundit, në mos transparencë komunale, viti i tret me radhë, kish qen mirë mu merr me shumë me transparencën. Kam një kërkesë nga një qytetar, tek pazari ditën e martë me qen policia prezantë, sepse po bëhet kaos, kjo kërkesë adresohet tek Drejtoria për Inspeksion.

Vlonjat Hasani: Po filloj me pyetjen për rrugën ‘Lumi’ në fshatin Miradi e Epërme, po vazhdon problemi i njëjtë, asnjë veprim nuk po ndërmerr, por shpresoj se tash afër zgjedhjeve, do të ndërmerrni ndonjë veprim. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Kulturës, Rinis dhe Sportit dhe Drejtorin e Arsimit, sepse problemi i ndërlidh te dy drejtorit, me lejen e kujt jan duke operu disa shkolla private te sportit, te cilat po i shfrytzojn sallat e sportit dhe po kërkojn para nga nxënësit e shkollave, për me shkua dhe me kry aktivitetë të ndryshme brenda sallave të sportit, kjo është shumë e rëndësishme me na konfirmuar dikush zyrtarisht. Prap për Drejtorin e Arsimit, qe ka te bez me implementimin e irregulloren e Organizimit nëpër shkolla, ku thuhet, asnjë mësimdhënës, nuk ka të drejtë të mbaj kurse private, për nxënësit të cilët i noton, nëse një mësimdhënës i noton një klas ose dy klas, nuk ka te drejt me mbajt kurse private dhe me marr pagës nga nxënësit te cilët i noton, e ky fenomen po ndodhë në Komunën tonë, fatkeqësisht. Po ashtu me cilat procedura është emëruar drejtoresha e shkollës ‘Daut Bogujevci, a është respektuar ligji dhe procedurat e emërimit të kësaj pozite? Drejtorin e Shërbimeve Publike, kur keni me filluar me bë dezerekimin e hapësirave brenda territorit të Komunës së Fushë-Kosovës. Po ashtu në rrugën Idriz Breznica’ në Fushë-Kosovë, ka munges të infrastrukturës dhe grumbullimi i tepër i mbeturinave në atë pjesë. Kam një pyetje për Drejtorin e Inspektoratit, në rrugën Zona Industriale në Miradi të Poshtme një Operator ekonomik ka vendosur pengesa në rrugë, kur parashihen të largohen këto pengesa? Pse nuk po implementohet plani i mobilitetit, i cili i ka kushtuar komunës 240.000.00€, po po besoj që veç u trajtua në kuend.

Fisnik Sllamniku: Dua të ju informoj, për shkollën në Vragoli, e kemi pasur një marrëveshje me një kompani, për energji solare, po dua që të ju njoftoj se ka përfunduar dhe tash shkolla në Vragoli realisht rrym nuk paguan. Secili ka një park të brendshëm dhe barin që po e kositin me makina, nuk po kanë konenjer, ku mi gju barishtet, a' mundeni me bërë një zgjedhje?

Drejtori i Drejtoris së Kulturës, Rinis dhe Sportit: Pyetjen e par e kam nga asamblisti z. Hasan Ismalji, sa i përket pronës tek kompleksi pishat, i nderuar mundesh me ardhur tek un gjat javës dhe e shohim krejt dokumentacioni e këtij procesi. Sa i përket pyetjes së z. Mirsad Qyqalla, ne kohen e mbikëqyrjes së menagjimeve punimeve në të sallave të sporteve në Miradi të Epërme, Vragoli,

Mes Bardh, Lismit dhe Fushë-Kosovë, punimet janë zhvilluar në mënyrën më të mirë të mundshme, sa janë funksionale, është çështje tjetër dhe janë ekskluzivisht në kompetencën e shkollave, ato i menagjojn drejtorët të shkollave, unë e kam thënë dhe e them kem veshtirsi me furnizimin e sallave, me pajisje sportive për shkak procedurave, sepse për një detaj shumë të vogël që dy her janë duke e kthyer prokurimi, për arsyet përshkrimit të paramasave. Unë kam dal me ekipin tim nëpër sallat dhe e kam bërë një vlerësim dhe një raport me fotografi dhe gjitha dëshmit e mundshme, poa shtu mundeni me ardhur dhe me i pa, un kam kontaktuar edhe punë kryesin dhe ka mbet me ardh dhe me i rregulluar disa probleme te vogla te cilat kan mbetur.

Drejtori i Arsimit: Sa i përket shfrytëzimit të hapësirave publike, të shkolla private të sportit, te cilat po i shfrytzojn sallat e sportit, shkollo private dhe klube private në komunën e Fushë-Kosovës nuk ka, ato jan organizata të OJQ-ve, te cilat marrin pëllqim për shfrytëzimin e hapësirave, janë me statut jo profitabil dhe për vet mbajtje, për pagesën e atyre trajnerëve bordi i asaj shoqate cakton, një tarifë për me mujt fëmija mu edukua, këtë rast për me marr aktivitete sportive, kjo formë nuk funksionin vetën në komunën e Fushë-Kosovës, por edhe në komunat e tjera, klubet sportive OJQ-ët, që janë duke funksionuar në këtë formë, të gjithë janë qytetar të komunës së Fushë-Kosovës te cilët i shfrytëzojnë këto hapësira publike dhe me marrëveshje, ju dhëjm pa pagës në shfrytëzim, ndërsa pagesat te cilat i marrin nga fëmijët, jan për shpenzimet ditore dhe mujore të tyre si refer të ndeshjeve, transport, e besoni që ka raste kur edhe transportin ua mbulojmë ne për arsyet pë pamjaftueshme te mjeteve financiare, për pjesëmarjen në gara nga qyteti në qytet. Në këtë rast institucioni nuk merr asnjë kompensim, ne e bëjmë për fëmijët e qytetarëve tonë, kjo nuk është obligative, është vullnet dhe dëshirë e fëmijëve për të shkuar. Rregullorja e cila është miratuar nga Kuvendi i Komunës në vitin 2023, thotë çart mësimdhënësit nuk kanë të drejt me i përfshirë nxënësit te cilët e tyre në ato kurse, ju e dini se kurset jan biznese individuale dhe rregullorja e përcaktor edhe distancën e shkollës dhe operimin e tyre, në këtë rast un nuk kam asnjë informacion, që një mësimdhënës i komunës së Fushë-Kosovës, i detyron nxënësit e tij, që ti përfshijnë në kursin e tij, sepse këtu kemi të bëjmë me inspektoratin e punës dhe këto raste duhet mi evidentuar menjëherë dhe mi lajmëruar. Emërimi i drejtoreshës Shkurta Bogujevcit në shkollën 'Daut Bogujevcit' si ushtrues detyre e zëvendës drejtoreshës, i ka pesëmbëdhjetë vite përvjoh pune në sistemin e arsimit, emrimi i saj në këtë detyrë, Kryetari i Komunës me propozim të Drejtorisë së Arsimit e ka të drejtën me emëruar një vit, deri në përfundim të procedurave tjera, drejtori i cili ka qenë aty për shkaqe shëndetësorë ka dhënë dorëheqje. Drejtori Sadri Emini, në shkollën Aneksi 3', e ka përfunduar mandatin si zëvendës drejtor, për katër vite, procesi i vazhdimit të mandatit të tij, është në dy fazë, së pari u bë vlerësimi i dosjes së tij nga Drejtori e Arsimit, pastaj vlerësohet nga inspektorati i ministris, të dy këto procesi i ka kaluar dhe Drejtoria e Arsimit i' a ka vazhduar kontratën edhe për një vit e gjysmë.

Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit: Ju falënderoj te gjithë asamblistëve për pyetjet. Projekti i drunjëve dekorativ nga asamblisti Durim Hajra, ky projekt ka afat deri në muajin qershor të këtij viti, për shkak të sezonës dimrore, është e kuptueshme dhe e arsyeshme që nuk mundet të bëhet mbjellja e drunjëve dekorativ, për këtë arsyet projekti vazhdon, sipas planit dinamik. Në rrugën 'Pajazit Islami' jan disa dëmtime fizike nga vetrurat, mirëpo kjo është në përgjegjësi të kompanisë që ti rinoj, sepse e ka për detyrë deri sa ti përfundon kontrata me mbrojt vend punishten, kur pranohet teknikisht pastaj jan ne kompetencë tjetër. Trajtimi i qenve endacak, ne para një javë e kemi nënshkruar një kontratë, për trajtimin e qenve endacak, në këtë kontratë nuk

parashihet eliminimi i qenve dhe strehimi i qenve, por vetëm trajtimi i tyre. Rruga Vëllezërit Gërvalla' vitin e kaluar i kemi bërë dy intervenime në këtë rrugë, shenja e komunikacionit ku është bërë kufizimi i tonazhës, tash duhet te bëjmë mbushjen e gropave, ku edhe kemi filluar. Pjetjen e autobusëve , kemi problem jo vetëm në Harilaq, kompanit e autobusve që kalojnë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, kalojnë edhe në territorin e Komunës së Prishtinës, po ashtu dy kompani që kalojn nga territori i Komunës së Prishtinës kalojn edhe në të Fushë-Kosovës, Komuna e Prishtinës , me një projekt shum të madh me bezhin ika shti kontratë operatorët e Prishtinës edhe i subvencionon, kjo ka shkaktuar probleme sepse, është liruar biletat nga ata operator, ndërsa operatorët e ton e kan mbajtur çmimin e njëjtë, mirëpo edhe banorët normal që e shfrytëzojnë çmimin më të lirë, ky është biznes privat, ata kan aplikuar për licencë dhe nuk e ka për obligim komuna mi mbulua shpenzimet e tyre, ne jemi shërbim qytetarëve jo të bizneseve, ne i kemi ftuar takim disa herë dhe ju kemi sçaruar, mirëpo kjo tash është në kompetencën e inspektoratit, te nderuar drejtoria jon ka për obligim të caktoj vijat dhe ti mirëmbaj por jo ti kontolloj. Kjo ka kaluar tash në inspektoriat. Ne nuk i subvencionojmë kompanitë, subvencionojmë qytetarët. Ne jemi duke punuar dhe shumë shpejt do dalim me një raport. Sa i përket ndriçimit, kemi pasur një kontratë e cila ka shkuar në gjykat, unë skam mundur me mrri edhe ne disa vende për rregullimin e ndriçimit. Sot i kam dërguar në Pomozotin kompaninë, që e ka fitua tenderin e ndriçimit të ri. Unë e kam shpall tenderin për mirëmbajtje, por është anuluar, sepse çmimi i aplikimit të kompanive ka qen i ulët. Pata një pyetje për pishat e Sllatinës, pse nuk është shtegu për këmbësor dhe pushimore, jan dy mënyra për ta bërë një projekt, mënyra e par me bërë një projekt gjigant, por i ke vetëm një pjesë te mjetave financiare dhe shpall vetëm sa ki projekt, ndera pjesën tjetër e shpall por aj projekt të zbatohet vitin e ardhshëm. Por ne kemi pasur mungesë te mjetave financiare dhe u bë vetëm një pjesë. Sa i përket cilësisë, ne kur ta marrim testin e cilësisë, e paguajmë shumën. Pastrimi i varrezave, në vitin e kaluar i kemi pastruar varrezat edhe në qytet edhe fshatra, mirëpo në fshatra banorët jan duke e bërë vet, ndërsa në qytet e bëjmë ne vazhdimisht. Ne kemi pasur një rast në një fshat, banorët nuk na kan lënë me i pastrua varrezat, sepse kan thënë që ne duam ti pastrojmë vetë, ne prap do pastrojmë në qytet. Rruga Idriz Breznica' dhe rruga Lumi' në fshatin Miradi e Epërme edhe pse nuk po implementohet plani i mobilitetit, rruga Lumi' në fshatin Miradi e Epërme është e shtruar më herët dhe ka nevoj për renovim, ne do mundohemi me aq sa kemi buxhet mi përmbyll te gjitha kërkesat e qytetarve, Rruga Idriz Breznica' nuk ka problem me infrastrukturë, mundet me pas mbyllje të kanalizimit, e nëse keni at problem un i kam raportet shum të mira me ujësjellësin dhe ata menjëherë vin sa i përket çështjes së kanalizimit. Plan i mobilitetit, vitin e kaluar, ka dhënë disa rezultate, te cilat i kam edhe në raportin e punës, rrugët një kohore e kan rrjit numrin e parkingjeve, mundem me të thënë që jan mbi 300 parkingje të reja në qytet, prej momentin që u bë me plan të mobilitetit. Nënkalimi në Vragoli projekti është duke shkuar shumë mirë, këtë vit, kemi me bërë edhe një projekt tjetër për ta përfunduar, ndërtimin e trotuarit dhe asfaltimin. Këtë do ta përfundojmë ne me mjetet tona. Pse nuk po bëhen komposterat, ne i kemi pas komposterat dhe e di që komuna ka dhënë.

Pika e pestë (5) - Informatë për shpenzimin e buxhetit janar - mars 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim 'Informatën për shpenzimin e buxhetit janar - mars 2025', ftoi Udhëheqësen e Sektorit për Buxhet dhe Financa znj. Merita Krasniqi që të na jap sqarime.

Udhëheqja e Sektorit për Buxhet dhe Financa - Merita Krasniqi: Kjo informatë për shpenzimin e buxhetit janar - mars 2025, ka 26 faqe por po mundohem sa me e shkurt te ju informoj. Buxheti i aprovuar nga Kuvendi i Komunës dhe Kuvendi i Kosovës, për vitin 2025 është 16.747.839.00€, në tre mujorin janar –mars 2025, ka psuar ndryshime, nga bartja e participimit, në vler 8.804.10€ dhe nga donacioni i jashtëm Council Of Europe në vler 1000€, që do të thotë se për këtë peridh janar-mars buxheti është 16.757.642.00€ nga ky buxhet jan të alokuara 8.082.358.60€, jan shpenzuar 3.046.311.13€ që i bie 37.69%. Nëpër kategoritë ekonomike, paga 2.159.761.52€, mallra 512.568.46€, shpenzime komunale 86.065.72€, Investime Kapitale 280.495.43€, pagesa direktë është nga Qeveria Zvicerane në vler prej 310.608.12€ për vitin 2024, regjistrimi në sistemin e fri balancit nga thesari është bërë janar të vitit 2025 dhe kjo nuk volvohet në buxhetin e përgjithshëm mirëpo kjo duhet të paraqitet vetëm si shënim për informat. Të hyrat vetanake për peridhën janar-mars 2025 është 917.479.23€, këtu jan paraqitur edhe dënimet e trafikut 277.132.00€ dhe gjobat e gjykatave 37.770.00€.

Pika e gjashtë (6) - Informatë për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Informatën për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik’, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik, që të na jap sqarime.

Drejtori i Zhvillimit Ekonomik- Për zhvillim e komunës së Fushë-Kosovës, dinamikën, progresin, numrin e madhe të bizneseve te cilat jan vendosur në Komunën e Fushë-Kosovës, ku jan të dhëna edhe preh gapit, ku Fushë-Kosova, renditet e 4 ose e 5 në nivel vendi, që ka 137 biznese, që kan qarkullim vjetor, përmbi një milion euro. Një zhvillim ekonomik, në një lokalitet ndodhë, kur kem edhe fushën e prodhimit dhe përpunimit, sepse ata krijojnë edhe vende te reja pune. Jemi në fazën e përpilimi të strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal 2025-2030, i kemi grumbulluar të dhënat nga drejtorët, kompania e cila e ka marrur për me punua, jan duke punuar në teren dhe ky dokument shumë shpejt do të vie edhe në Kuvend, është në procedurë të shpalljes së tenderit projekti, për vendosjen e tabelave informuese në Sllatin, Harilaq, Bardh i Madh dhe në qytetin e komunës së Fushë-Kosovës, me qëllim të promovimit të turizmit lokal dhe kemi shpall një thirrje publike për biznese të reja. Kemi edhe master planin për Goleshin, ku kemi qen edhe në një vizit studimore, në Francë, këtë do ta prezantojmë me 23 maj në Klan Arena.

Pika e shtatë (7) - Informatë për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedisit

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike: Sqarimet u dhanë tek pyetjet, pjesa tjetër është në formën e shkruar.

Pika e tetë (8) - Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar ju informoj se shuma e mjeteve financiare prej 5000€, do të mirën nga subvencionet në shëndetësi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovim ‘Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë

U votua me: unanimisht ‘për’, vota ‘kundër nuk ka’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzetë e tre anëtar të pranishëm.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës nuk e aprovoi ‘Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë’ dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Feti Mehdi Breznica nga fshati Miradi e Epërme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë në fazën e metastazës, me Dg: ‘Adcmccatkim metastas cerolo’ dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsyenë të natyrës së sëmundjes së rëndë.

Pika e nëntë (9) - Shqyrtimi i Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025 për lejimin e vendosjes së Trafostacionit Elektrik me interes publik për komunitetin jo shumicë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Shqyrtimi i Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025 për lejimin e vendosjes së Trafostacionit Elektrik me interes publik për komunitetin jo shumicë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë. Hap diskutimin.

Bashkim Krasniqi: Të nderuar këtu kemi një donacion, i cili ka ardhur për lagjet e tona, sepse jan afér 300 shtëpi banimi te cilat kan problem me rrymë, aty është një pronë e cila ka me ju dhënë Kedsit, për vendosjen e asaj trafos dhe zhvendosjen e trafos së vjetër, kjo është përfshirë përfshirë përmes që ta votoni.

Mirsad Qyqalla: Unë dua ta parashtroj një pyetje, në këtë material kemi askund nuk ka baz ligjore, ne duam ta dimë se në çka je thirrur, po ashtu un dyshoj se edhe ministria ka me kthyer si të jashtëligjshme, ndoshta me mirë me marr me përmisuar edhe mbledhjen tjeter me pru prap.

Drejtori i Drejtoris së Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Ky është ‘Projekt investim kapital i Kedsit’, nëse ne nuk e votojmë sot, e ky vendim nëse votohet shkon ministri dhe ministri ka një afat ligjor prej 30 ditëve, ky projekt hup, ashtu me kan thënë, s’kam qit bazë ligjore sepse un vetëm kam propozuar, Kedsit i kan pru të gjitha dokumentacionet dhe kjo jepet në shfrytëzim.

Mirsad Qyqalla: Këtu pasq që jan 11 ari?

Drejtori i Drejtoris së Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Aty janë 28 metra shfrytëzim.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e qiti në votim për aprovimin ‘Për aprovimin e Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025 për lejimin e vendosjes së Trafostacionit Elektrik me interes publik për komunitetin jo shumicë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë

U votua me: unanimisht ‘për’, vota ‘kundër nuk ka’ dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzetë e tre anëtar të pranishëm.

Ne bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Kuvendi i Komunës e aprovoi ‘Për aprovimin e Propozimit Nr. 440, të datës 06.05.2025 për lejimin e vendosjes së Trafostacionit Elektrik me interes publik për komunitetin jo shumicë në lagjen 029 në Fushë-Kosovë

V E N D I M

1. Për aprovimin e Propozimit me Nr. 440, të datës 06.05.2025 për caktimin e lokacionit dhe lejimin e vendosjes së 'Trafostacionit Elektrik', në sipërfaqe të ndarë prej: S=26.9m², pjesë e Ngastrës Kadastrale me Nr. P-72514036-01422-0 në Zonën Kadastrale Fushë-Kosovë, nga sipërfaqja e përgjithshme e saj prej: S=1157 m², sipas numrit të lëndës Nr. 14-942-16451 të datës 08.05.2025, në funksion të dhënisë në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029, në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë.
2. Qëllimi i dhënisë në shfrytëzim të pronës me destinim - infrastrukturë e komunës në të mirën e përgjithshme në pikën një të vendimit, është dhënia e pronës në shfrytëzim për realizimin e interesit publik për banorët e komuniteteve jo shumicë në lagjen 029 në rrugën 'Fridjof Nansen' në Fushë-Kosovë në sipërfaqen e caktuar.

Pika e nëntë (9) - Të ndryshme

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.
Mbledhja përfundoi në ora 17:30 minuta.**

Procesmbajtës


Hasan Gjyreçi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili





**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA**



**KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE**

Ekstrakti nga Procesverbali, i-V, i Kuvendit të Komunës, i mbajtur më datën 22.05.2025, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Bashkim Krasniqi - Zëvendës Kryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Miranda Shabani, Mirlinda Krasniqi, Jetmir Berisha, Vjollca Konjusha, Krenar Dumani, Laureat Gojnovci, Jahush Krasniqi, Fisnik Sllamniku, Etnik Berjani, Durim Hajra, Hasime Kostanica, Shpend Bardiqi, Habib Mekolli, Vlonjat Hasani, Mirsad Qyqalla, Aida Alimi, Dardane Sogojeva Shala, Migjen Kolshi, Qëndresa Ademi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli dhe Radoman Doderovic.

Kryetari i Komunës dhe Drejtoret e Drejtive të Komunës: Besnik Osmani - Nënkyrytar i Komunës, Amir Bullatovci - Drejtore për Administratë, Fatlum Berisha - Drejtore për Arsim, Bardhyl Kojçiçi - Drejtore për Infrastrukturë, Ardit Sekiraça - Drejtore për Shërbime Publike dhe Mjedis, Ilir Hasani - Drejtore për Gjeodezi Kadastër e Pronë, Vjosa Kida Hyseni - Drejtore e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Donat Zharku-Drejtore për Inspektoriat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshtëndetë të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
2. Propozim për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' për vitin 2025 i Komunës së Fushë-Kosovës.
3. Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për punën dhe funksionimin në tre mujorin e parë të vitit 2025.
4. Informatë për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit.
5. Për aprovin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë.
6. Propozimit me Nr. 471 te datës 13.05.2025 për fillimin e procedurës për Hartimin e Planit Rregullues për Zonën Urbane të Fushë-Kosovës.
7. Propozimit Nr. 470, të datës 13.05.2025, për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020- 2028
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në mbledhje. Materialin e keni marr me kohë. Kjo është seanca e pestë e vitit 2025, me këtë rendë të ditës. Në Komitetin për Politik dhe Financa, kemi pasur edhe tri pika shtesë, ku dy kanë qen nga Drejtoria e Urbanizmit dhe një për ndihmë financiare në shërim, të cilat kanë kaluar për shqyrtim në Kuvend. Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, lexoi pikat e rendit të ditës .

Hasan Ismajli: Përshëndetje për të gjithë. Unë kam një propozim, sepse është urgjente përmua dhe qytetarët e Fushë-Kosovës. Propozoj sigurimin ose blerjen e një parcele për varrezat e qytetit të Komunës së Fushë-Kosovës', sepse para pak ditësh kemi qenë në një varrim të një qytetari të komunës tonë dhe hapësira është shumë e vogël për varrim. Në këtë foto hapësira është 36 metra gjatësi dhe 9 metra gjerësi, përafërsisht edhe 90 vdekje deri në fund të vitit. Unë dje kam bërë kërkueshë në Bashkësinë Islame të Komunës së Fushë-Kosovës. Zyrtarisht e kam marrë numrin e të vdekurve në qytetin e Fushë-Kosovës gjatë vitit 2023-2024, ku për vitin 2023 janë 115 raste vdekjes, ndërsa në vitin 2024 janë 121. Kërkoj që të futet pikë e jashtëzakonshme, me urgjencë. Këtë ua kam dërguar edhe shefave të grupeve parlamentare.

Laureat Gojnovci: Ne i kemi edhe dy pika shtesë, pas materialit të rregullt të Kuvendit. Këto pika i kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar, ndërsa sot kanë ardhur me ndryshimet të cilat i kemi kërkuar ne. Po ashtu Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, ka pranuar një kërkueshë nga një qytetar i Komunës së Fushë-Kosovës, Feti Breznica për ndihmë financiare për shërim, për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo është rekomandim i Komitetit për Politik dhe Financa
Durim Hajra: Kërkoj që të respektohet ligji dhe të vinë si pika shtesë, vetëm pikat më urgjencë. Mendojmë se pikën shtesë të cilën e propozoj asamblisti z. Hasan Ismajli, është me urgjencë. Po ashtu pika për ndihmë financiare për shërim, mendoj se janë urgjencë, ndërsa dy pikat tjera të cilat janë në kundërshtim me ligjin, nuk e di pse vinë si pika shtesë dhe si paraqesin urgjencë sepse janë në kundërshtim me ligjin.

Mirsad Qyqalla: Unë dëgjova me vëmendje pikat shtesë, por mendoj se ligji e parashësh shumë qartë, kur pikat janë urgjente, mund të vijnë si pikat shtesë të rendit të ditës. Kryesues mendoj se ju duhet ta vendosni se këto pika, janë apo s' janë urgjente. Po ashtu unë kam bërë pyetje cila është logjika nëse një pikë nuk kalon në Komitetin për Politik dhe Financa pse vjen në Kuvend. Kolegu nga Lidhja Demokratike e Kosovës tha për pikat shtesë që kanë ardhur me ndryshimet të cilat i kemi kërkuar në mbledhjen e kaluar, mirëpo unë i shfletova dhe i pash se aty nuk ka asnjë ndryshim, me tepër përvçë disa neneve. Sa i përket kërkueshës për ndihmë financiare për shërim, kushdo që ka kërkueshë do ta ketë votën nga Partia Demokratike e Kosovës. Sa i përket çështjes së hapësirave të varrezave në qytetin e Fushë-Kosovës, unë besoj se nuk ka asgjë më urgjente se sa kjo, këtu besoj që plotësohet kushti i të mirës së përgjithshme dhe urgjente.

Hasan Ismajli: Pikën të cilën e propozova unë është urgjente dhe mundeni me vërtetuar duke i vizituar. Unë mendoj se nëse nuk ndërmerrni masa më herët aty nuk do të ketë më vend për varrimin e të vdekurve. Ndërsa dy pikat shtesë të Drejtorisë së Urbanizmit, në mbledhjen e kaluar, nuk i keni pasur votat, tash votat i kanë siguruar dhe i kanë sjell si pika shtesë Tash kur të votohet do ta shohim cilët janë ata të cilët kanë bërë pazare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë dua ta lexoj nenin 47 të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale, ku thotë: Anëtari i Kuvendit të Komunës, mund të kërkoj shtimin e një pike në rend të ditës, gjatë seancës së rregullt të Kuvendit të Komunës, nëse çështja që kërcohët të përfshihet në rend të ditës është çështje urgjente dhe me rëndësi publike. Menjëherë vazhdon në çështjen tjetër ku thotë, kërkesa të tillë i miraton ose refuzon Kuvendi. Mua sot më ka ardhur e-maili, sa i përket rregullores nenit 20, më ka thënë të lutem kryesues referoju nenit 47 të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale.

Mirsad Qyqalla: Nëse është e-mail zyrtar pse nuk po na e sjellë?

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme, rekomandimet e Komitetit për Politik dhe Financa, kërkesën e z. Feti Breznica për ndihmë financiare për shërim.

U votua me: unanimitet. Kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës, pikën shtesë ‘Kërkesën e z. Feti Breznica për ndihmë financiare për shërim’, në mbledhjen e sotme.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme, dy pikat shtesë të ardhura nga Drejtoria e Urbanizmit.

U votua me: katërmëdhjetë vota për , katër kundër dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim, rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme rendin e ditës.

U votua me: katërmëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim, rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme, pikën shtesë të z. Hasan Ismajli ‘Propozoj sigurimin ose blerjen e një parcele për varrezat e qytetit të Komunës së Fushë-Kosovës’ .

U votua me: trembëdhjetë vota për , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, nuk e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme ‘Propozimin për sigurimin ose blerjen e një parcele për varrezat e qytetit të Komunës së Fushë-Kosovës’ .

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, i hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme, në terzi pikat e rendit të ditës.

U votua me: unanimitet , kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me shumicë të votave, e aprovuan për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

Pika parë (1) - Pyetje dhe Përgjigje Parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi pikën ‘Pjetje dhe përgjigje parlamentare’, ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës, që të parashtrojnë pyetjet e tyre.

Durim Hajra: Dua ta parashtroj një pyetje për Drejtorin e Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, i nderuar drejtor, një vendim të gjykatës të cilin ke mbete ma na e sjellë këtu, që ka kaluar prej pronës komunale në pronë private P-7214036-004-28-3, Zona Kadastrale Fushë-Kosovë, lagija ‘Dardania’. Ke premtuar që ka vendim të gjykatës dhe ke me na sjellë, e u bënë disa muaj që nuk na u ke përgjigjur për këtë çështje. Një propozim të cilin e kam dhënë edhe në dy mbledhje e kaluar, që ka të bëjë me interesin publik, e që realisht ka ndikime në qytet, për dhënien në shfrytëzim të objektit të AMF-së, që gjendet në lagjen ‘Dardania’ tek Kompleksi 300. Ky objekt t’i jepet në shfrytëzim stacionit policor, sepse lagja ‘Dardania’ është e mbingarkuar dhe ai objekt nuk është duke u shfrytëzuar me diçka tjetër. Pyes për çka është duke u planifikuar ai objekt?

Dardane Sogojeva Shala: Kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedis, tek Bregu i Vogël në Sllatinë, qytetarët kanë kërkuar ta dinë pse nuk ka ndriçim? Tek Drejtoria e Inspektoratit, se pari ju falënderoj për përgjigjen në e-mailin zyrtar, dua të pyes cilat kritere i kanë plotësuar objektet e masazheve që i keni mbyllur? Dua të pyes Drejtorin e Infrastrukturës, kush merret me kontrollimin e mbylljes së gropave nëpër rrugët e qytetit dhe të fshatrave. Po ashtu për sinjalizimet të cilat bëhen në rrugë. Ka disa persona të cilët janë lënduar, pse nuk i têrhiqni me qene se ka hapësirë. T’i largoni terrasat e bizneseve dhe ta rregulloni sinjalizimin e rrugëve.

Hasan Ismajli: Po filloj me Drejtorinë e Drejtorisë së Gjeodezis, Kadastrit dhe Pronës, nëse nuk je guximtar për tu marr me detyrën të cilën e keni pranuar si drejtor, ose je bashkëpunëtor me disa zyrtar të drejtorisë suaj, te cilët kanë keqpërdorur në prona komunale. Mbledhjen e kaluar e kam thënë, që dy prona komunale me Nr 480-3 dhe Nr. 420-3, që në sipërfaqe total janë 300 metra katror, ju kanë bashkangjitur parcelës 479-1, me pronar i ndjeri Z. Sh, ju e njihni shumë mirë dhe parcela 479/2, 479/4 dhe 479/5, janë dakorduar për ndërtimi kolektiv. Këto katër parcela, pa këto dyja të komunës, në total janë 25 ari e 65 metra, kur i janë shtuar tre ari, janë 28.35 metra. Leja ndërtimore u lëshua në fund te vitit 2018, e ke në faqen zyrtare të Komunës nga Drejtoria e Urbanizmit. Drejtorin e keni afér dhe mundeni me pyet, a u lëshua leja ndërtimore për 25.65 metra katror dhe kur e llogarit 1350 metra janë ndërtuar, në hapësirën jo komunale, 1350 metra janë ndërtuar pa garuzhda dhe kur e merr çmimin vetëm 600€, ofrohet afér një milion euro fitim, zbritja ndërtuesit sa ka ndërtuar për këto 1350 metra, ky është keqpërdorim dhe dikush duhet me shkuar në burg. Këtë lëndë unë e kam cekur edhe në vitin 2022, ku u’ a kam dorëzuar edhe shefave të grupeve parlamentare. Këtë dokumentacion do të u’ a jap edhe juve, po ashtu auditorit të brendshëm, i cili e ka dërguar në prokurori dhe ka mbetur atje, sepse keni gjetur lidhje dhe keni të punësuar familjar diku afro 20-30 persona të hetuesve, prokurorëve dhe gjykatësve. Por, unë besoj që deri në fund të vitit nuk do të mund t’i ruani më shumë. Ju i nderuar nuk keni dhënë përgjigje, ta kam bërë edhe pyetjen tjetër, parcela në rrugën ‘Pajazit Islami’ është e njëjtë lëndë, vetëm ka një hapësirë më të vogël për 1 ari e 80 metra, ju kanë bashkangjitur tri parcela, ku në grafik qëndron ende. Në grafik e keni ndryshuar kur unë e kam paraqitur në vitin 2022 dhe kjo u ndryshua 2023. Kur hyn në grafik, tash këto parcela i ke 25.65 ari, por jo 28 ari, si është dhënë leja ndërtimore. I

nderuar, këtu dikush duhet me shkuar në burg. Ndërsa ju jeni duke ndenjur me duar në xhepa, nuk po të kuptoj. Unë jam duke bërë këtu pyetje dhe ju duhet me më dhënë përgjigje dhe faktë që dokumentet të cilat po i paraqes nuk janë në rregull ose pranoje dil në follore dhe thuaj ashtu është. Dua ta ngrisë çështjen e drejtorit të arsimit, një nga drejtorët më të mirë që keni pasur e keni larguar nga puna. Meqenëse ai ka qenë tri mandate dhe mandatin e fundit e ka lënë për arsyen shëndetësore, ai ka kërkuar që të lirohet nga pozita e drejtorit, sepse nuk ka mundur që t'i kryej obligimet si menaxher i shkollës. Duke e parë gjendjen e tij, ju e keni dërguar ne shtëpi. Ndërsa ka punëtor të cilët i mbani mbi 15 vite, pa ardhur asnje ditë në punë, e gjysa janë të shëndoshë. Ju jepni pagë të rregullt, ndërsa ky drejtor shkon në shtëpi me diagnozë jo të mirë dhe e ka fillimin e sëmundjes së parkinsonit, kur e kam takuar mezi fliste. Është turp me dërgu në shtëpi një vit para pensionimit. Unë nuk po ju kuptoj. Për të ngritur karrierën duhet t'i kemi dy gjëra këtu, por unë nuk dua të flas për shkak të kulturës që kam. Pyetjen tjetër e kam për Drejtorin e Inspektoriatit, ndërtohet një objekt në lagjen 028-029, ku është podrumi, përdhesa dhe dy kate, me bashkëfinancim komuna dhe një OJQ-ë, nuk ka leje ndërtimore për gjithë ndërtimin, por vetëm për përdhesë dhe harta zonale që po donë kolegu juaj ta ndryshoj, thotë P+1, përdhesa dhe vetëm një kate. Këtu është tejkaluar ndërtimi dhe ju a keni reaguar, sepse edhe në mbledhjen e kaluar e kam ngrit këtë çështje, ajo çka e bënë interesant, gjatë ndërtimit ka kamera vëzhguese dhe e vëzhgon, e kontrollon. Komuna e Fushë-Kosovës i ka ndarë 150.000.00€, për këtë objekt. Këtu nuk dihet se kush ka me përdor, për çka ka do të përdoret dhe katet e banimit, a do të vendosen ata banor të cilët e kanë dhënë apo kush? Këtu nuk kemi as informatën më të vogël, sepse marrëveshja është bërë përmes Kryetarit të Komunës dhe një OJQ-së. Ky Kryetar bënë marrëveshje pa e sjellë në Kuvend, në vitin 2018 e ka bërë edhe një marrëveshje të njëjtë si kjo, ku i ka marr 20.000.00€, nga xhepi i qytetarëve dhe ka shkuar e ka ndërtuar një shtëpi në komunën e Suharekës dhe këtë shtëpi ia ka ndërtuar një familjareje të një zyrtareje këtu në Komunën e Fushë-Kosovës.

Habib Mekolli: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Para disa dite e pamë një njoftim, që në rrugën ‘Pajazit Islami’ po planifikohet të bëhet një ndryshim i ri dhe modern. Po shpresojmë që të jetë i tillë. Mirëpo përveç këtij njoftimi të cilin e kemi marr përmes rrjeteve sociale, nuk ka pasur asnje konsultim publik me ata banorë. Mendoj se kjo e ngrit një problem tjetër ma madhor, e që janë këshillat lokale të pa formuara. Kjo ka qenë iniciativë prej mandatit të kaluar, që të formohen Këshillat Lokale, të cilat kishin shërbyer për konsultim dhe investime në ato lagje dhe fshatra. Mirëpo, si iniciativë ka mbetur aty ku ka filluar, nuk është vepruar fare në atë drejtim. Ju bëjë thirrje që sa më shpejt t'i formoni Këshillat Lokale. Sa i përket lirimtë hapësirave publike, po e shohim që herë pas here është duke u punuar në këtë drejtim, por realisht ende hapësirat publike janë të uzurpuara. Unë mendoj se është dashur që të mendojmë pak edhe për hapësirat nëntokësore, për parkingje. Jemi dëshmitar që një pjesë e madhe e tyre e ka ndërruar destinimin. Është lëshuar leja për parkingje nëntokësore, mirëpo në realitet, ato shumicën i gjeni në depo ose veprimtari tjera, e jo parkingje. Besoj se kishte qenë mirë me marr një aksion dhe ato hapësira me i' u kthyesh dedikimit, sepse mendoj se na kishte ndihmuar në këtë drejtim. Këtë e dëshmon edhe komunikimi me disa policë të lagjes, ku ata thonë që të gjitha tiketat për parkingje duhet të shkojnë në këtë drejtim, në investimin e parkingjeve të reja. Sepse, në njëfarë mënyre po i bie që komunës po i

konvenon që policia me dhënë sa ma shumë tiketa, sepse rritet buxheti i Komunës. Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike, mendoj se është alarmante pastërtia e rrugëve dhe trotuareve në qytet. Ka disa paralajmërimë se do të bëhet pastrimi, por ne ende nuk jemi duke e parë.

Aida Alimi: Përshëndetje për të gjithë. Unë e kam një pyetje për të gjithë drejtorët apo shefat e grupeve parlamentare, të cilët janë emëruar që të punojnë në rregullore, kur do të filloj puna e atyre rregulloreve dhe kur do të përfundohen këto rregullore për të cilat janë shpenzuare 10.000.00€? Pyetjen tjetër e kam për lirimin e hapësirave publike, si po bëhet, sepse në disa hapësira nuk po kërkohet që të lironen? Po ashtu dua te pyes për qenët endacak qe janë problem permanent për të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë-Kosovës? Në rrugën Gjergj Fishta, shtyllat janë problem për banorët. Unë nuk kam marr përgjigje për ulëset të cilat janë vendosur në disa objekte të Komunës së Fushë-Kosovës dhe qytetarët duan ta din si u bë kjo ndarje e këtyre ulëseve? Po ashtu pas çdo reshtjeje të shiut, shkaktohet një kaos. Kam një pyetje edhe për Drejtorin e Arsimit, a janë mbajtur takime me maturantet që të ju ndihmoni se ku të përcaktohen për të ardhmen dhe a ka rezultate nga këto takime të cilat po mbahen?

Vlonjat Hasani: Përshëndetje për të gjithë. Dua ta ngrisë një shqetësim të cilin ka ndodhur para dy dite në Komunën e Fushë-Kosovës, për grabitjen e një të miture, e cila na ka prekur te gjithëve. Ne i shohim takimet që bëhen me Kryetarin e Komunës për nivelin e sigurisë, brenda territorit të Komunës sonë dhe gjithmonë dalin disa raporte që gjithçka është në rregull, duke funksionuar normal dhe sigurt. Por, për fat të keq këso raste ndodhin shpesh në komunën tonë dhe çuditërisht nuk rriten masat e nivelit të sigurisë. Uroj që rastet e tillë mos të përsërisin më. Po filloj me problemin e rrugës Lumi në fshatin ‘Miradi e Epërme’, në të cilën nuk po ndodhë asgjë, është i njëjtë problem, nuk ka interesim për të ndërmarr diçka për atë rrugë. Rruga ‘Idriz Breznica’ në Fushë-Kosovë, qytetarët çdo herë po ankohen. Problemin që e kemi ngrit më herët në Zonën Industriale, në Miradi të Epërme, është një operator ekonomik i cili ka vendos pengesa në rrugë, të cilat janë në kundërshtim me rregullat e komunikacionit. Lirimi i hapësirave në qytet, rruga ‘Abedin Sogojeva’ dhe ‘Kuvendi i Lezhës’. Hapësirat publike po lironen vetëm momentalisht dhe ata prapë po i vendosin këto pengesa dhe Komuna nuk del në teren, për lirimin e këtyre hapësirave publike. Aty ku ndërmerrni veprime, të paktën të jeni më të kujdeshëm dhe ti përcillni punët të cilat po thoni po i kryejmë. Të nderuar tualetet e komunës janë në gjendje të tmerrshme dhe nuk kemi nevojë të dalim jashtë sepse gjithçka shihet këtu. Këtë e them për herën e dytë brenda këtij mandati. Për shkak se ka shumë nëpunës të komunës të cilët këtë nuk mund ta thonë edhe pse me këtë problem ballafaqohen çdo ditë. Por, ata i adresojnë këto probleme tek ne, sepse e kanë të vështir përdorimin e këtyre tualeteve. Rregullorja e punës në shkolla, ka të pranishëm këtu, që tentojnë ta ndryshojnë atë të cilën thuhet këtu. Rregullorja e punës nëpër shkolla, ka kaluar në këtë Kuvend dhe ne i kemi dhënë vërejtjet tona si grup parlamentar dhe duhet të respektohet sepse, në rregullore decidivisht një mësimdhënës nuk ka të drejtë të mbajë, kurse private dhe të marr pagës nga nxënësit të cilët i noton. Ky fenomen po ndodh në komunën tonë. Të njëjtën çështje e kam ngrit edhe herën e kaluar, mirëpo pa emër, se ka devijim të fjalëve.

Mirsad Qyqalla: Kam një pyetje për Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Mjedis, në mbledhjen e kaluar kemi diskutuar për rrugët që lidhen Pishat me fshatin Bardh i Madh dhe që

janë jashtëzakonisht në gjendje jo të mirë. Të kam njofuar dhe t'i kam dërguar fotografat. Me intereson ta di a keni ndërmarr diçka, sepse ajo e cila u shtrua pa kualitet dhe pa cilësi nuk donë koment. Pjetjen e dytë e kam, rruga prej Kuzmin që shkon në Pomozotinë, është një linjë e ndriçimit që e ka vendosur komuna jo shumë moti dhe është komplet jo funksionale dhe para dy dite ka qenë një rast me fatalitet, pikërisht në këtë rrugë. Pyes pse nuk punon ndriçimi dhe kur ju vjen koha për rregullim? Tek Drejtoria për Inspektoriat, pash një lajmërim për lirimin e hapësirave publike dhe dje unë kur erdha në Komitetin për Politik dhe Financa, i pash pronarët e bizneseve të cilit kishin ardhur për tu takuar me nënkyetarin. Për çudi ata të cilët e kanë uzurpuar pjesën më të madhe, asnjë nuk ishte këtu. Ne si kuvend kemi nevojë për disa informata se ku ka për tu zbatuar dhe kur ka me filluar lirimi i këtyre hapësirave publike dhe ne nuk do të lejojmë që të përdoret në kohë të fushatës. Qyteti është ngulfatur. Te Drejtoria e Arsimit, Aneksi 3' ishin edhe disa pamje televizive për rrugën, a jeni duke menduar që fëmijët mos ta shkelin më atë baltë, por të ndërmerrni masa për rregullimin e asaj rruge. Kam një pyetje për Nënkyetarin e Komunës, në fshatra po ndodhë, një projekt i ujit, i cili ka qenë shumë i nevojshëm. Paralelisht me të është edhe Kompania e Ujësjellësi e cila po ndërhyr dhe në fshatin Bardh është bërë gjendje kaotike, prej këtyre prerjeve dhe ndërhyrjeve të punës. A ka ndonjë memorandum i cili përcillet, sepse projektit ka filluar që një vit dhe nuk po i duket fundi. A ka dikush që po i mbikëqyrë? Drejtori i cili ka qenë në shkollën ‘Daut Bogujevci’ të cilin e njohim të gjithë Sabri Xhigoli’ pyes a duhet të trajtohet ky mësimdhënës në këtë gjendje të cilën është? Mendoj se nuk ka qenë rruga e duhur kjo të cilën e keni bërë. Desha të pyes edhe për një rrugë e cila e di se është në kompetencën e ministrisë, rruga Bardh-Grabovc, e cila është në gjendje tmerruese dhe gati e pa kaluar.

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Përrshëndetje për të gjithë. Po filloj me ankesën të cilën e paraqiti znj. Dardane Sogojeva, ndriçimi në Sllatinë të Vogël, do të zhvendoset i vjetri dhe për këtë arsy do të ketë pengesa deri sa të përfundon. Por, besoj se do të rregullohet shumë shpejtë, me rregullimin e projektit të ri do të rivalizohet edhe ajo linjë. Unë kam dal në teren me menaxheren e projektit për mbushjen e gropave dhe ju siguroj se menaxhimi i projektit është duke shkuar sipas ligjit në fuqi dhe cilësia e punime është në rregull. Unë mendoj se punë ndërtimore pa lopatë nuk kryhet, sepse u përmend nga parafolësit. Ndërsa në qytet jemi në përfundim. Sinjalizimi i rrugëve, kemi kontratën e projekteve kapitale dhe do fillojmë aty ku ka nevojë për sinjalizimin e rrugëve. Për shkak te motit me shi, kemi menduar mos të fillojmë kaq herët, por të fillojmë nga 15 qershori, me pastrimin e rrugëve. Një herë ka do të bëhet fshirja e rrugëve pastaj pastrimi, ashtu siç ka nevojë. Dua t'i përgjigjem znj. Aida Alimi për qentë endacak, jemi në teren me ekipet e kontraktuara, tash kemi kontratë për këtë pjesë. Në rrugën ‘Gjergj Fishta’ ka mungesë të ndriçimit publik dhe në buxhetin e vitit të ardhshëm shpresojmë se do ta përfundojmë këtë rrugë, sepse aty nuk ka shtylla për ndriçim publik. Kanalizimi atmosferik në qytet funksionon, mund të garantoj. Por, nëse ka reshje të mëdha është normale që mundet edhe të bllokohet, por lirohet shumë shpejt. z. Vlonjat Hasani ngriti shqetësimin për grabitjen në Fushë-Kosovë, ne e kemi parë vetëm në media dhe nuk ka raport zyrtar se çka ka ndodhë, mirëpo qyteti i komunës së Fushë-Kosovës e ka sistemin e kamerave funksional 100%. Në momentin që ka ndërprenje të kamerave policia e sjellë kërkessën. Për fat të mirë kompania është shumë e përgjegjshme.

Vlonjat Hasani: Nëse ke mundësi të na tregosh sa kamera sigurie janë të vendosura në qytet?

Drejtori i Shërbimeve Publike dhe Mjedis: Për momentin nuk e kam numrin e saktë, por mundem me ta sjell numrin dhe rrugët ku janë të vendosura, në cilat pika? Rruga ‘Lumi’, e kemi kontratën kornizë, vetëm duhet të prisni, sepse kjo është vetëm çështje kohe, nuk e kemi neglizhuar. Jo vetëm rruga ‘Lumi’ por janë edhe disa fshatra ku ka nevojë për intervenim. Përgjigja e njëjtë është edhe për rrugën ‘Idriz Breznica’. Rruga prej Bardhit të Madh në pisha është projekt që është përfunduar, është nën garacion dhe i kemi ndërmarrë të gjitha masat ligjore, por tash presim operatori që të intervenoj. Në rrugën Kuzmin- Pomozotin, në Kuzmin ndriçimi publik funksionon në fshat, kurse rruga Kuzmin-Pomozotin, dikush e ka dëmtuar kabllon dhe po presim me hapë kanal që ta funksionalizojmë. Aksidenti nuk ka ndodh në ketë pjesë por në pjesën ku ka ndriçim.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë. Dy pyetje i pata nga asamblistët, për drejtorin e shkollës ‘Daut Bogujevci’ Sabri Xhigoli, i cili ka ofruar dorëheqje nga pozita e drejtorit të shkollës. Në parim dorëheqja e tij ka ardhur në vitin 2023, por e kemi cilësuar si një dorëheqje të ngutshme dhe sipas ligjit ka pasur të drejt të pushimit mjekësor dhe vjetor dhe që nga ajo kohë drejtori ka tentuar të mbetet pjesë e shkollës në vazhdimësi. Por, fatkeqësisht gjendja e tij shëndetësore, veç po keqësohet. Duhet ta keni parasysh që nuk është larguar nga puna por, drejtori ka ofruar dorëheqje nga pozita e tij si drejtor. Inderuar z. Hasan Ismajli, ju jeni ai i cili në vazhdimësi thoni, njerëzit të cilët nuk punojnë nuk duhet me qenë në punë dhe tash po thoni që ky nuk mund të punoj por, duhet me qenë në punë. Drejtori Sabri Xhigoli, ka ofruar dorëheqje zyrtare për shkaqe shëndetësore. Ky ka ardhur nga shërbyesi civil drejtor, i njëjtë ka qenë i angazhuar në Shtëpinë e Kulturës. Tash ligjërisht nuk kemi të drejt ta kthejmë në sistemin arsimor. E vetmja formë që ai mund të mbetet pjesë e arsimit është rekrutimi përmes konkursit të tregullt. Ishim të interesuar ta kemi Këshilltar të Karrierës dhe në një aspekt, të tentojmë me liru prej detyrës që ka menaxheriale në shkollë. Por, për ta kthyer në këshilltar të karrierës drejtori duhet të jetë i licencuar. Me gjithë këtë, Drejtori sipas gjendjes që ka nuk ka pasur mundësi të ndjek trajnimin. Koordinator për ngritje të cilësisë, dhjetë orë i mban mësimore pjesën tjetër e ushtron punën si koordinator i cilësisë. Drejtori nuk e ka të drejtën ligjore që të kthehet nga pozita e drejtorit në koordinator. Duhet të jetë mësimdhënës dhe këto forma janë që neve na kanë pamundësuar. Së fundmi para se ta nxjerrim vendimin e fundit e kemi thirru drejtorin, kemi kërkuar mirëkuptim prej sekretarit të shkollës, që për dy vite ka mbajt përgjegjësin edhe të drejtorit por edhe te sekretarit, Betim Ahmeti. I kemi thënë a ka mundësi me i dhënë kohë ende drejtorit, që ta shohim apo ka përmirësim në shëndet. Drejtori Sabri Xhigoli ka kërkuar në mënyrë urgjente të lirohet nga pozita e drejtorit. Ligjërisht nuk kemi pasur të drejt që ta kthejmë mbrapa. Fushatat të cilat i bëjmë tek maturantët, ishte pyetje nga znj. Aida Alimi, ne kemi formua grup punues në tri shkollat e mesme të cilat i kemi edhe tek klasat e nënta. Bëjnë promovimin e drejtimit të tyre, me një qëllim të vetëm, nxënësit e Komunës së Fushë-Kosovës tentojnë me i mbajt në Komunën e Fushë-Kosovës, në shkollat e mesme, në përashtim të drejtimeve të cilat nuk i kemi në komunën tonë dhe ata duan që t'i zhvillojnë në Prishtinë. Dy bashkëpunëtore profesionale të cilat punojnë në drejtorin e arsimit, kanë dal në teren dhe në momentin që kthehen pas përfundimit do t'i sjellin para jush informata, për mësimdhënësit

të cilët e shkelin rregulloren të cilën e kemi miratuar në këtë Kuvend. Në Aneksin 3' projektin e kemi të gatshëm, në momentin që na vije mundësi do t'i zhvilloj procedurat për rregullimin përfundimtar të oborrit të shkollës.

Hasan Ismajli: Drejtor të admiroj që ke filluar kështu, por ju e dini më mirë se unë sepse jeni këtu dhe i njeh sa persona nuk vijnë në punë dhe marrin rrrogë. Unë po e di, se atij ia pamundëson ligji, por ju ku e keni etikën, ku e keni humanitetin, sepse ai nuk mundet me fol. Ai me ka autorizuar të gjitha diagnozat të ia publikoj, por unë po dua me e ruajt etikën. Të gjitha e-mailat çka keni shkruar ju me të, zyrtaret tua, jo ju por Kryetari i Komunës, i ka premtuar ku do ta sistemoj dhe ato i kemi këtu. Është turp në gjendjen të cilën e kam parë, ky drejtor nuk ka qenë vazal i Kryetarit të Komunës. E keni dërguar në shpi dhe nuk e keni mbajtur në vend të punës. Këtu kemi me fol edhe për imoralitetin dhe qysh u' a bëni vendet e punës, i ngriteni në pozita dhe i mbani në vende të punës dhe ai nuk po bejka. Është marre me lënë një drejtor në këtë gjendje. Drejtorin i cili ka qenë katër mandate drejtor.

Nënkryetari i Komunës: Jemi tek rubrika pyetje dhe përgjigje dhe tek pika pyetje dhe përgjigje nuk ka komente dhe debat, këtu ligji është duke u shkelur me dy këmbët. Ligji thotë një asamblistë, nëse ka pyetje duhet të bëhet me shkrim dhe e merr me shkrim. Kjo është sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, i cili është Kushtetutë e Komunës, ligj organik. Nëse doni mund të shkojmë bashkërisht me pa. Rastet të cilat janë në prokurori, drejtorët nuk kanë të drejt me dhënë përgjigje. Politikisht ju jeni korrekt, bëni pyetjet e juaja e bëni diskutimin publik, nuk është e ndaluar. Por, për ekzekutivin në momentin që një rast shkon në dorën e prokurorisë, administrata hesht dhe pritet vendimi i organeve gjyqësore. Kështu që ju sa doni bëni pyetje, në momentin që rasti është në prokurori, për neve debati publik përfundon, pjesa tjetër se a e kryen prokuroria punën e vet apo nuk po e kryen, mos pritni prej neve me dhënë përgjigje sepse, nuk është në kompetencën tonë. Një pyetje ishte me AMF-në në lagjen Dardania' nga asamblisti z. Durim Hajra, aty është një objekt i cili momentalisht nuk është në përdorim. Ne fillimi kemi pasur një marrëveshje në parim me USAIDI-në, që ky objekt të kalohet në shfrytëzim të Qendrës Rinore, nuk kemi vendim sepse vendimin u deshtë me sjell këtu, pse nuk e kemi sjell këtu është se nuk ka qenë e aprovuar nga ana e USAIDIT-ë, që do ta përkrahim përfundimisht dhe kemi pritur përgjigen e tyre, që ta sjellim në diskutim dhe aprovim tek Kuvendi Komunal. Kjo për shkak se ju e dini që projektet e USAID-it, janë pezulluar. Ne jemi informuar, se kjo nuk do të shfrytëzohet dhe s'do të ketë financim nga USAIDI në këtë projekt. Kjo është kthyer para dy muajve. Por varianti i ri që kemi dashur ta përdorim është që kjo qendër të përdoret nga Komuna e Fushë-Kosovës, në bashkëpunim me Bashkësinë Islame dhe të jetë Qendra që shpërndan ushqime falas për personat që kanë nevojë, në Komunën e Fushë-Kosovës. Ky vendim duhet të vijë në Asamblenë Komunale. E kemi dërguar një ekip, në bashkëpunim jemi duke e bërë vlerësimin teknik se ai plotëson kushtet, sepse edhe Bashkësia Islame i ka disa kërkesa, për tu plotësuar kushtet dhe nëse arrijmë pajtim ne do ta sjellim tek ju, me propozimin që të marrim votën e juaj, që kjo të përdoret për qëllimet e qytetarëve të cilët kanë nevojë dhe besoj se do të na shërbej mirë. Këtu u dha edhe një propozim që këtë objekt ta përdor policia, sepse ka nevojë për një nënstacion. Unë sa kam njohuri nga Stacioni Policor nuk kemi marr asnjë kërkesë. Neve na ka ardhur një kërkesë për tokë dhe ua kemi ndarë tokën dhe jemi

në bashkëpunim për pjesën përfundimtare për stacionin e ri policor në Fushë-Kosovë. Kemi pas kërkesë që të ju ndihmojmë me vetura, i kemi ndihmuar, ndërsa për nënstacion nuk kemi pasur kërkesë. Rasti i kidnapimit të një të miture, kemi qen në bashkëpunim të ngushtë me policinë, që nga momenti i parë kur kemi pas sinjal. E kam një lutje, nëse është e mundur për të gjithë ne përfshirë edhe drejtoret, të jemi të përbajtur deri në verifikimin e informacionit për çka po bëhet fjalë. Dje informata e fundit që kemi marr në komunë është se kemi marr falënderim për kamerat e sigurisë që ua kanë lehtësuar shumë punët në zbardhjen e rastit, dhe nuk është në kronikën e policisë për kidnapim. Kështu që kjo pjesë ju takon policisë dhe e lejmë në dorën e tyre. Raporti vjetor i policisë së Kosovës që e kemi dhënë 98% të rasteve në Komunën e Fushë-Kosovës janë të zbardhura, të çfarëdo lloji të vepre që kanë bërë. Në dy vitet e fundit në Komunën e Fushë-Kosovës nuk kemi asnjë rast vdekje, si pasoj e këtyre grupimeve. Ajo çka ka ndodhur kemi raportin original të policisë ku përfshihet Regioni Podujevë, Obiliq, Prishtinë, sipas raportit komuna e Fushë-Kosovës është komuna ma e sigurta zyrtarisht. Ky nuk është raport i komunës, por është raport i Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme e cila është kompetente, raporti është publik. Rruga Bardh-Grabovc, po është e dëmtuar i nderuara z. Mirsad Qyqalla. Është kompetencë e Ministrisë. Kemi një raport shumë të mirë me Ministrin e Transportit. Sot e kemi dorëzuar projektin detal përrugën e nën hekurudhës. Një projekt shumë i rëndësishëm, që është në buxhet i miratuar nga Qeveria dhe do të financohet në bashkëpunim me komunën dhe do të jetë një zgjidhje shumë e mirë për trafikun, një rrugë e re dhe e shfrytëzoj rastin me falënderuar edhe një herë Ministrin. Kemi dërguar tri kërkesa të reja, njëra ka të bëjë me rrugën që shkon nga busti i Adem Jasharit përballë shkollës në drejtim të Nakaradës, deri në Lismir dhe në drejtim të Obiliqit sepse pastaj është rrugë regionale deri tek ura, pastaj pjesa tjetër ka filluar të ndërtohet. Ne i kemi thënë ministrisë se është një nga priorititet tona dhe i kemi dërguar edhe projektin. Kemi dorëzuar edhe rrugën e dytë, rrugën e Uglarit, e cila rrugë kalon nëpër tri komuna Fushë-Kosovë, Graqanic dhe Prishtinë. E kam parë në televizion që e ka nënshkruar Nënkyetari i Graqanicës, kërkesën tonë përrugën, por me rëndësi është që ministria ka thënë po e financoj dhe ka mundësi ta financoj një rrugë shumë të rëndësishme. Ju e dini se Ministria e Transportit është duke e shtruar rrugën ‘Gurët e Gjatë’ në Harilaq, është një projekt tjetër që është duke u ndërtuar me Ministrin e Transportit. Kemi kërkuar rrugën Sllatinë dhe Grabovc që të meremetohet sepse është shumë e dëmtuar. I nderuar z. Vlonjat Hasani, pyetjen të cilën e parashtron një koleg tjetër nuk ke të drejt me ndërhy, me thënë ti nuk mundesh me ia dhënë përgjigjen. Të drejtën time të lejuar të garantuar me ia dhënë një përgjigje një kolegut tuaj, nuk mundesh me ndal. E dyta çka them unë, ti je personi i fundit që mundesh me u pyet vet. Unë përgjigjem dhe bëhem përgjegjës. Kështu që për këto dy sende, kurrë mos provo, sepse ka pasur edhe të tjerë që janë munduar dhe nuk kanë mundur të ma ndryshojnë mendimin, kështu që mos u lodh.

Vlonjat Hasani: I nderuar unë jam i zgjedhur i popullit, ndërsa juve u' a ka dhënë dikush tjetër pozitën.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar nëse ju jeni lodhur e kemi të drejtë ligjore me ndërprerë seancën dhe shkojmë në pauzë, pastaj vazhdojmë me pikët tjetër të ditës. Nëse ke mundësi të vazhdosh, Nënkyetar.

Nënkyetari i Komunës: Populli ka zgjedh deputet, që kanë votuar një ligje edhe që është më i madh se asamblisti, me votat e veta që është këtu. Bardh i Madh- Grabovc është rrugë regionale. Kemi bërë kërkësë tek Ministria vitin e kaluar, po ashtu këtë vit. Kemi pretime serioze dhe besoj se do të intervenojnë. Ne në të njëjtën kohë kemi shpreh gatishmërinë meqenëse nuk kanë një kod në buxhet sepse kanë probleme teknike buxhetore, që ne me kontratën që e kemi për renovim, që është e nënshkruar në Komunën e Fushë-Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë dhe në pajtim të plotë me ta që të intervenojmë tek pjesa e hekurudhave, sepse kalimet në një pjesë janë shumë të vështira, në Pomozotin, Bardh dhe para shkollës në Grabovc. Gjithmonë ne kemi shprehur gatishmërinë, që nëse ka dakordim Ministria së bashku me Komunën ti japim një përfundim kësaj çështje kaq të rëndësishme. Sa i përket rastit të drejtorit të shkollës z. Sabri Xhigoli, kishte fjalë që na ka munguar humanizmi në këtë rast, besoni që drejtori dy vite në mënyrë të përsëritur ka kërkuar dorëheqje dhe në mënyrë të përsëritur për çështje humane i kemi kthyer një përgjigje. Drejtor vetëm rri, në mënyrë humane po vijmë dhe po të ndihmojmë, sepse e ke edhe një vit për të dalur në pension. Ligjërish drejtori nuk është post politik, mund të jetë i motivuar politikisht por ligjërisht e kemi mundësin që të akomodojmë në një vend që mund tu përshtatet nevojave tua dhe dy vite e ka shtyrë për aq sa ka mundur me shty. Unë nuk e di humanizëm më të madh çka mundet me pas. Jemi munduar të bëjmë zgjidhje ne te gjitha mënyrat.

Vlonjat Hasani: Nënkyetar Besnik Osmani, është njerëzore me kërkua falje nëse dikush gabon dhe kërkon falje. Pajtohem me Kryesuesin e Kuvendit të Komunës i cili tha se Nënkyetari asnjëherë nuk ndërhyn kur ne jemi duke folur. Ju dy herë i cekët rastet të cilat janë në prokurori. Ekzekutivi apo drejtorët nuk kanë nevojë të përgjigjen. A e dini ju sa pyetje janë drejtuar këtu dhe drejtorët nuk kanë dhënë përgjigje? pyes a janë të gjitha këto raste në prokurori? E dyta ju thatë se 98% rastet janë të zbardhura. Është hera e tret që ju bini në kundërshtim. Ju thatë se jemi komuna, ma e sigurt dhe deri 98% të rasteve janë të zgjedhura sipas raportit të policisë. Raportin e fundit që e keni dhënë për sigurinë e Fushë-Kosovës, para pak ditësh ka ndodh një incident në Komunën e Fushë-Kosovës, i cili ka qenë shumë banal. Dua ta rikujoj i nderuar Nënkyetari i Komunës që të drejtën time, për të folur këtu na e ka dhënë populli ndërsa ju jeni i emëruar nga Kryetari i Komunës. Të gjithë ne jemi dal para popullit dhe e kemi pyetur a mundemi me ju përfaqësuar, ndërsa ju nuk jeni dal. E sa i përket listës që e përmendet më herët pyes a e ke frik apo vetëm kujdes se s'do të hyj unë në listë apo jo?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Të nderuar nuk keni të drejt replike tek pyetje dhe përgjigje, por për hir të respektit po ia jap fjalën nënkyetarit.

Nënkyetari i Komunës: Po heq dorë nga e drejta që ma dhe, sepse është në kundërshtim me ligjin dhe po shkoj po ulem.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Shkojmë në pauzë deri në ora 1:00.

Pika e dytë (2) - Propozim për shpalljen e titullit ‘Qytetar nderi’ për vitin 2025 i Komunës së Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Në emër të Drejtorit të Kulturës, Rinis dhe Sportit ka kërkuar falje për mos prezencën në mbledhje, sepse ka shkuar në një takim për homazhe dhe ne në

dakordim me Shefat e Grupeve Parlamentare e mirëkuptuam, kurse këtë pjesën tjetër të biografisë e morën përsipër asamblisti z. Laureat Gojnovci, për qytetar nderi qytetarin Nazmi Kelmendi.

Laureat Gojnovci: Për shkak se Drejtori i Kulturës ndodhet në ceremoninë e homazheve në fshatin Harilaq, kërkoi mirëkuptimin e juaj drejtori. Të nderuar anëtar të Këshillit Komunal me nderin dhe respektin më të madh, po e paraqes propozimin për ndarjen e titullit 'Qytetar Nderi' i Fushë-Kosovës për vitin 2025 për z. Nazmi Kelmendi një njeri që ka kontribuar ndjeshëm në komunitetin tonë dhe që meriton këtë vlerësim për angazhimin dhe përkushtimin e tij. z. Nazmi Kelmendi është një personalitet i njohur jo vetëm në Fushë-Kosovë, por edhe më gjërë. Ai ka luajtur rol të rëndësishëm si delegat i Kuvendit të Kosovës, gjatë viteve të 90-ta, kur ka qenë pjesë e proceseve historike që e kanë formësuar fatin e Kosovës. Ky angazhim ka treguar guxim dhe sakrificë duke vendosur, atë në radhën e individëve, që kontribuan për lirin dhe pavarësinë e Kosovës. Gjithashtu z. Nazmi Kelmendi ka shërbyer si Asamblistë i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, ku ka luajtur një rol të rëndësishëm, për zhvillimin e politikave lokale dhe ka kontribuar në përmasimin e kushteve për qytetarët e këtij komuniteti. Si politikan i angazhuar ai gjithmonë ka pasur interesat e qytetarëve të komunës në qendër të punës së tij. Po ashtu angazhim i tij në fushën e Kulturës dhe Sportit është i pa harrueshëm. Ai ka qen një aktivist i dalluar duke qen pjesë e organizimeve të shumë ngjarjeve kulturore dhe duke u mbështetur në zhvillimi e talenteve të ri. z. Nazmi Kelmendi, ka kontribuar në ruajtjen dhe zhvillimin e traditave kulturore të Fushë-Kosovës. Në përfundim titulli 'Qytetar Nderi' i Fushë-Kosovës, është një shenjë mirënjoye dhe respekti për atë që ka dhënë kontribut të veçantë për të, për zhvillimin e komunitetit dhe për promovimin e vlerave që ne i mbështesim. Kërkoi mbështetjen e juaj për këtë propozim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Më lejoni që në emër të Partisë së Drejtësisë, ta mbështes këtë propozim dhe mendoj se z. Nazmi Kelmendi, me plot mërit e meriton që të jetë 'Qytetar Nderi' për shkak te aktiviteteve dhe kolegut që unë e kam pas. Kam një vërejtje për z. Ali Topalli, të cilin e kam thënë edhe në Komitet, kishte qen mirë para se ta sjellë në Kuvend që të komunikoj me Shefat e Grupeve Parlamentare të Kuvendit me qëllim që në hulumtimin e tij, mos po kanë edhe Shefat e Grupeve Parlamentare ndonjë ide, për ndonjë aktivistë të Fushë-Kosovës, për ta shpallur Qytetar Nderi'. Unë sot do ta sillja një kundër kandidat dhe për mos me ardhë deri tek një kundër kandidat nga ana ime ose e subjekteve tjera është mirë të këshillohem, me arsyen që kur të sjellën në Kuvend mos të zgjatemi shumë dhe me qen unik. Këtë e kanë cilësuar edhe asamblistët z. Mirsad Qyqalla dhe z. Vlonjat Hasani në Komitetin për Politik dhe Financa.

Durim Hajra: Vërejtja jonë qëndron, ajo e cila u tha në Komitetin për Politik dhe Financa, ne e mbështesim këtë propozim.

Mirsad Qyqalla: Kryesues ju e potencuat edhe atë që e kemi thënë në Komitetin për Politik dhe Financa. Ne jemi për me mbështet këtë propozim.

Hasan Ismajli: Kolegu i Lidhjes Demokratike të Kosovës e lexoi, biografin e z. Nazmi Kelmendi, kushdo që e ka propozuar z. Nazmi Kelmendi e përgëzoj sepse me të vërtet e ka merituar. Për të folur për z. Nazmi Kelmendi ka shumë dhe unë jam njeriu që më së shumti e njoh sepse jam rritur me të dhe i di aktivitetet e tij dhe kontributin e tij, duke filluar nga Bashkësia Islame, organizimeve

të ndryshme, si sportist, delegat, asamblistë dhe është një familje që me të vërtet e meriton z. Nazmi Kelmendi me qenë ‘Qytetar Nderi’ për vitin 2025.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Ndjejhem krenar dhe i priveliguar që të votoj për ‘Qytetar Nderi’ për vitin 2025 z. Nazmi Kelmendi, për shkak të kontributit që e ka dhënë z. Nazmi Kelmendi.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme pikën ‘Propozim për shpalljen e titullit ‘Qytetar nderi’ për vitin 2025 i Komunës së Fushë-Kosovës, të z. Nazmi Kelmendi’.

U votua me: unanimitet, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave, e aprovuan ‘Propozim për shpalljen e titullit ‘Qytetar nderi’ për vitin 2025 i Komunës së Fushë-Kosovës, të z. Nazmi Kelmendi dhe mori:

VENDIM

1. Për shpalljen e veprimtarit, aktivistit, delegatit të Kuvendit të Kosovës dhe asambleistit të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës z. Nazmi Avdi Kelmendi “Qytetar nderi” i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2025, është i lindur me datën 04.11.1957, në lagjen e Nakaradës në qytetin e Fushë-Kosovës, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje në Fushë-Kosovë, Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës.
2. I lartë cekuri në pikën një të këtij vendimi është veprimtarë dhe aktivistë me kontribut të çmuar që në fëmijërinë e tij, kryetar i Organizatës së Rinisë në Gjimnazin e Fushë-Kosovës, Sekretar në Bashkësinë Lokale në vitet 1978-1987, në vitet e tetëdhjeta 80-ta i angazhuar në kulturë dhe sport, referent për mbrojtje dhe vetëmbrojtje në Fakultetin Teknik 1987-1990, delegat në Kuvendin e Kosovës që shpalli ‘Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës’, me datën 2 korrik 1990 dhe ‘Kushtetutën e Republikës së Kosovës’ me 7 shtator në Kaçanik, asamblesitë në Kuvendin e Komunës së Fushë-Kosovës në tre mandate zgjedhore 2007-2017 dhe i dekoruar me ‘Medaljen e Artë për Pavarësi’, nga Presidenti Historik i Kosovës Dr. Ibrahim Rugova dhe shumë mirënjohje e falënderime tjera nga institucione të ndryshme të vendit.

Pika e tretë (3) - Informatë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës për punën dhe funksionimin në tremujorin e parë të vitit 2025.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Falënderoj z. Hasan Gjyrevci i cili e ka përgatit Informatën e Kuvendit për tre mujorin e parë. Në këtë informatë janë të gjitha vendimet, të cilat janë marr për tre mujorin e parë, po ashtu i kemi përmendur edhe sfidat të cilat kanë qen në tre mujorin e parë. Në emër të Lidhjes Demokratike a ka diçka me për të shtuar?

Laureat Gojnovei: Falënderoj Kryesuesin e Kuvendit të Komunës dhe Sekretarin e Kuvendit për Informatën e Kuvendit për tre mujorin e parë të viti 2025, kjo është një pasqyrim i punës sonë për këta tre muaj.

Durim Hajra: Këtu është bërë një përbledhje e aktivitetit, veç besoj se këtu është dashur të hyn edhe mangësitë, sepse unë nuk i pash vendimet të cilat janë kthyer të kundërligjshëm.

Mirsad Qyqalla: Kam një vërejtje tek pjesa e sfidave, ku është dashur të shkruhet edhe për Planin e Punës së Kuvendit sepse ka pasur tentativë, që të ndërhyhet dhe ka qenë mirë që të përshkruhet.

Hasan Ismajli: Këtu është dashur të ceket, si Kryetari i Komunës ka ndikuar në disa pika, pastaj ka shumë vendime të cilat prej vitit 2022 kur e kemi marr mandatin, të cilat i ka marr ky Kuvend me vota të shumicës, e të cilat Ministria i ka kthyer mbrapa dhe kanë mbetur në fuqi. Por, shumë vendime nuk janë të plotfuqishme dhe është mirë të na sqaroni pse nuk janë bërë të plotfuqishme nga zyrtari ligjor? Këto vendime nuk janë as në faqen zyrtare.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë pajtожem me disa kolegë, të cilët thonë tek sfidat duhet të shtohen edhe disa çështje. Informata është për periudhën janar/mars e vendimet për këta tre muaj janë të prezantuara. Unë disa herë e kam potencuar se është duke u shkelur Ligji për Vetëqeverisje Lokale. Së pari mos publikimi i audioincizimeve, e për te cilat kemi kërkuar në vazhdimësi. Ne do ta përmirësojmë këtë raport me pjesën të cilën e kërkoi asamblisti z. Mirsad Qyqalla. Po ashtu vendimet e bartura të cilat i kërkoi z. Durim Hajra. Unë dua të ju njoftoj se nuk ka vendim të cilin e ka kthyer Ministria dhe unë nuk e kam sjellë në Kuvend, përkundër sfidave të cilat i kam pasur. Ndërsa sa i përket ndikimit të Kryetarit, ai është Kryetar Komune me votat e qytetarëve dhe ne duhet ta respektojmë çdo verdikt të Kryetarit. Ligji për Vetëqeverisje Lokale është shumë i çart ku thotë pikat e rendit të ditës i cakton Kryesuesi i Kuvendit bashkëpunim me Kryetarin e Komunës. Po ashtu herë pas here kemi pas sfida, por edhe unë i kam politikat e mia dhe dua të bashkëpunoj dhe ta ruaj një unitet dhe një bashkëpunim zyrtar. Secili kemi përgjegjësi për aq sa jem votuar.

Pika e katërt (4) - Informatë për Punën dhe Aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim dhe analizim ‘Informatën për punën dhe aktivitetet e Drejtorisë së Arsimit, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit që të na jap sqarime shtesë.

Drejtori i Arsimit: Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam marr vërejtjet nga ju, në Komitetin për Politik dhe Financa dhe njëkohësisht ju kërkoi falje përvonesën e dërgimit të materialit. Sot e kam dërguar informatën vetëm për periudhën janar-maj. Falënderoj Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i cili çdo herë janë aktiv dhe janë duke e bërë një punë shumë të mirë. Ky komitet ka inkorporua informata të cilat duan përkujdes të veçantë. Nuk po ndalem tek të gjitha aktivitetet të cilat janë mbajtur përkohësive, sepse do të u’ a dërgoj secilit prej juve në e-mail adresën e juaj. Dua të ndalem në Investimet në Infrastrukturën Edukativo- Arsimore. Para se të vijë në Kuvend sot së bashku me Organin Mbikëqyrës, punëkryesin ishim prezant tek shkolla ‘Amir Elmazi’ dhe oborri i shkollës shumë shpejt do të përfundoj. Çerdhja në oborrin e shkollës ‘Selman Riza’, është duke u vendosur inventari dhe besoj që me një afat sa më të shkurtër do të përfundoj. Po vazhdoj tek oborri i shkollës ‘Selman Riza’ do të ndërtohet një shkollë e re me 24 dhoma mësimi. Po ashtu ndërtimi i Çerdhës në rrugën ‘Shukri Obërtinca’. Unë sot kam bërë zotimin e shumës së mjeteve financiare prej 50.000.00€. Ndërtimi i çerdhes në fshatin ‘Miradi e Epërmë’ dhe Sllatinë të Madhe. Para dy dite nga shtëpia projektuese, kemi marr projektin e detajuar dhe procedohet për prokurim, që të zhvillohen procedurat e tenderimit. Shuma e planifikuar për inventar për institucionet edukativo-arsimore, përkohësive, është 50.000.00€ dhe sot ka filluar të bëhet furnizimi me banka, karrige dhe tabela në shkollën ‘Mihal Grameno’. Do të furnizohen shkollat të cilat kanë inventarin e dëmtuar. Ju e dini se vitin e kaluar nga raporti i punës, që ne bashkë me një donator, kemi vendosur panelet solare përgjashtë objekte shkollore dhe ato janë duke funksionuar dhe kursejnë energjinë elektrike. Në këtë vit së bashku me Drejtorin e Zhvillimit Ekonomik, e kemi planifikuar që të vazhdojmë këtë projekt edhe në tri shkolla tjera. Sa i përket

subvencioneve janë përfitues të gjithë të rinjtë : bachelor, studime master, fëmijët me nevoja të veçanta, transportin e fëmijëve në lokalitetin ku shkolla është mbi katet kilometr larg, sipas udhëzimit administrativ. Kanë qen 950 aplikantë, transporti është realizuar. Ka filluar të bëhet ekzekutimi i pagesave. Këtu kemi pasur kërkesa edhe për disa botime të librave, revista shkollore, e të cilat i kemi mbështet me aq sa kemi pasur mundësi. Trajnimet e vazhdueshme për stafin arsimor, ku ju hapin rrugë mësimdhënësve që të licencohen. Kryetari i Komunës së bashku me Nënkyryetarin e Komunës dhe Drejtorin e Administratës, kanë vizituar edhe Bashkësinë Islame dhe kemi marr premtim se shumë shpejt në fshatin Lismir, do të filloj edhe ndërtimi i shkollës filliore në Lismir. Në rrugën ‘Fazli Grajqevci’ një projekt për ndërtimin e shkollës e kemi përfunduar katin e parë. Shkolla do të ketë 18 dhoma mësimi. Po ashtu në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit do ta ndërtojmë çerdhen afér ‘Aneksit 2’ dhe deri në fund të vitit besoj përfundon.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për transportin në lagjen Nakarad, a kanë filluar pagesat? Po ashtu a keni ndonjë data bazë, që drejtori i shkollës kur e dërgon ndonjë mësimdhënës në trajnim? A shkojnë me radhë, sepse po hasim që disa drejtor kanë preferenca dhe i dërgon vetëm disa. Unë mundem me ti dhënë me emër. Po ashtu është duke u mbajtur një trajnim në shkollën ‘Selman Riza’ dhe a janë zgjedhur me kritere apo si?

Drejtori i Arsimit: Mjetet financiare po thuajse të gjithëve iu kanë dal. Interesimi i mësimdhënësve për ti ndjek trajnimet me poentim është shumë i madh, sepse është hapur mundësia e aplikimit, për licencë të karrierës dhe të mësimdhënësit. Ndërsa, në një shkollë drejtori i shkollës nuk duhet me pas preferenca, për përzgjedhjen e këtyre mësimdhënësve, ata e thonë një arsy pse në disa raste ndodhë që i dërgojnë disa, sepse kur nuk ka qen e hapur mundësia e aplikimit. Për licencë një numër i madh i mësimdhënësve nuk ka pasur fare interes për të shkuar në as një trajnim. Ndërsa sot me çdo kusht duan që të shkojnë dhe tash ata të cilët kanë shkuar vazhdimisht në trajnime, sipas tyre iu dhënë prioritet. Mendimi im është prej zyrës së Drejtorisë së Arsimit të bëjë përzgjedhje për mësimdhënës, gaboj shumë më shumë sesa drejtori, por në raste konkrete nëse ka ndonjë rast dhe duhet të intervenohet unë çdo herë ju them ejani dhe bisedojmë, për secilën ankesë për të mirë të përgjithshme.

Fisnik Sllamniku: Këtë vit Drejtoria e Arsimit ka bërë investime të shumta nëpër shkolla. Po ashtu po shohim një performanca edhe tek Drejtorët e Shkollave të cilëve iu është vazhduar edhe për katër vite udhëheqje. Po ashtu edhe performanca e nxënësve ka qen e mirë dhe siguria është në nivel dhe nuk po ka raste. Sfidë mbetet mësimdhënia dhe mësimnxënia. Sa i përket trajnimeve, këto bëhen në bazë të një analize, vlerësimi i brendshëm i shkollës është një CV e shkollës ku këtu parashihen edhe mësimdhënësit dhe nevojat e tyre për trajnime të caktuara dhe shkolla i delegon nevojat për trajnime për mësimdhënës. Sfidë e kemi pas mungesën e mësimdhënësve, tash po thuajse ai problem vec ka përfunduar me regjistrimin e numrit të banorëve.

Durim Hajra: Pjesa e përbajtjes dhe strukturës çuditërisht është për lëvdatë, është gjithëpërfshirës. Mirëpo, ka edhe vërejtje dhe mendoj se vërejtja duhet të jetë primare. U befasova nga parafolësi i cili është mësimdhënës këtu dhe prita që ka me qen më shumë kritik sepse ai i përjeton në vazhdimësi këto mungesa që janë në fushën e arsimit, pasi që e dimë që në Fushë-Kosovë janë pak, disa për shkak të keq qeverisjes dhe disa të tjera që kanë rrjedh natyrshëm dhe është problem të kontrollohen. Unë po i jap disa kritika, nuk e pash saktë atë se çka ne kemi bërë

në Komitetin për Politik dhe Financa, po ashtu të gjeturat e komitetit të vitit paraprak nuk janë përmirësuar. Mesa e pash unë, disa prej aktiviteteve që janë paraqit, për periudhën janar-maj, e pash se ishin edhe të viti 2024 dhe për deri sa i pash disa, kishte qen mirë edhe të Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe sport të paraqiten. Unë kam mbajt takime që kemi pasur me Komitetin e Arsimit, disa vërejtje dhe disa të gjeturave qe kanë dal gjatë vizitatave, sidomos në shkolla. E disa prej tyre kanë të bëjnë me disa mungesa që në aspektin e zgjidhjes se tyre janë shumë të lehta, tek vizitat e anekseve të dy shkollave të 'Mihal Gramenos', disa kërkesa të cilat kanë dal nga mësimdhënësit, e të cilat i kemi adresuar gjatë mbledhjeve të Kuvendit, unë nuk i pash në informatë. Në 'Aneksin 2' mungesa e një sigurimi fizik, nuk është marrë për bazë edhe pse ka qenë e menaxhmentit të shkollës. Tek shkolla 'Selman Riza' nuk e kemi parë që është zgjidhur problemi komplet, sepse gjatë reshjeve oborri mbushet me ujë. Ka pasur kërkesa prej shkollave në qytet për renovim të klasave, po ashtu ndërrim të inventarit ne disa klasë, vërejtje dhe kërkesë e lëndëve të fizikës, kimisë për krijimin e kushteve laboratorike, mungesë të llap topave, kanë problem me rrjet, për shkak të mungesës së hapësirës klasat janë kthyer në kabinet, për prona është përgjegjësi e kryetarit. Po ashtu me shikuar listën e stafit të rekrutuar, sepse kem dyshim që janë rekrutuar personat qe nuk kanë qen urgjent.

Mirsad Qyqalla: Materiali ka ardhur me vonës, është voluminoz. Kur e kemi futur në planin e punës, ideja ka qen sfidat e fillimit të vitit shkollor. Dua ta ngris çështjen e trajnimeve të cilën e potencoi edhe Kryesuesi dhe z. Fisnik Sllamniku, sepse një pjesë e madhe ankohen se këto trajnime bëhen me favorizime dhe është mirë të merren masa. Pash një prezantim te shkolla 'Minatori'. Me aq sa unë kam informata, desha të pyes a qëndron ajo që ju i keni ftuar disa mësimdhënës të drejtimit të xehetarisë për ta shqyrta mundësin e mbylljes së atij drejtimi? Këtu kam nevojë për sqarime. Po ashtu Bashkësia Islame, thatë se kanë marr vendim që ta ndërtojnë shkollë në 'Lismir'. Kjo po lë shije jo të mirë, tash para zgjedhjeve. Pse duhet me investua në një shkollë në 'Lismir'?

Hasan Ismajli: Materiali ka ardhur me vonës, është voluminoz dhe nuk kemi arritur ta lexojmë. Unë i kam disa pyetje. Unë kam kërkuar nga ju për ta bërë një zgjedhje tek 'Aneksi 2', sepse unë kam parë fëmijët duke mbajtur lëndën e edukatës fizike, ku fëmijët dhe drunjtë ishin në tokë. Këta fëmije ishin të ciklit të ultë. Po ashtu lëndën edukatës fizike e mbanin në beton në mungesë së sallës së sportit. Po ashtu tek 'Aneksi 3' e kanë ndërtuar shkollën afér xhamisë. Këtu nuk ka të keqe, sepse xhamia është qe 10-15 vite më herët e ndërtuar, por në fund është një pjesë ku përgatiten kufomat, që është ceremoni fetare, në rregull, e domosdoshme dhe nuk ka të keqe asgjë, mirëpo në vijë ajrore, prej katit të dytë dhe të tretë në pjesën e perëndimit dhe veriut, fëmijët e klasës së parë, të dytë kanë qasje me pa, kah hyn dhe del kusoma. E di se në disa klasë janë organizuar prindërit dhe i kanë blerë perdet. Po ashtu, pse ajo shkollë nuk ka pranim teknik? Sa i përket trajnimeve nuk mundet bash gjithkush të shkoj aty, duhet me pas lidhje me ekzekutivin dhe me i pas sytë e kaltër. Nuk mundet të më pengoj mua z. Laureat Gojnovci, se çka flas unë. Nëse këta kanë vërejtje që unë po shpifi, kanë të drejtën të më padisin. Sa i përket kësaj që e thash, unë mundem t' i publikoj me emra dhe me mbiemra. Kjo oferta e myftiu Naim Tërrnava, që do ta ndërtoj një shkollë në fshatin Lismir', dua të pyes a e keni pronën dhe na tregoni ku është?

Laureat Gojnovci: Te Raporti i Punës së Kuvendit e lavdërova këtë Kuvend, për gjuhën e përdorur, e sot një prej momenteve të rralla kur më vjen turp që jam pjesë e këtij Kuvendi. Reagimi im është me vend, sepse kemi kolege nga këtu që janë pjesë e atyre trajnimeve. Unë asnjë familjar timin nuk e kam në atë grup, por kemi kujdes me gjuhën sepse janë nëna të dikujt, motra të dikujt dhe bija të dikujt.

Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për Komunitete: Drejtor në Komitetin për Komunitete ka ardhur një kërkesë prej asamblistëve, për uniformën e nxënësve, çka mund të ju ndihmojmë ne si Komunë, nëse fëmijët nuk i kanë mundësit me e blerë uniformën dhe këta fëmijë ta kenë uniformën obligative.

Fisnik Sllamniku: Rilicencimi dhe licencimi që janë duke u bërë, MASHT-i trajnimet kur i organizojnë nuk i organizojnë me nevoja të mësimdhënësve. Unë i kam orët por asnjë trajnim nuk kam marr pjesë. Unë shkoj në trajnime më të mëdha që janë nga niveli qendror. Performancen fillostarte e kanë mësimdhënësit edhe në bazë të përvojës, e dyta është e avancuara. Unë personalisht i kam orët por nuk kam aplikuar për perfomancë të avancuar, sepse rroga rritet 0.5%, në rrugën 585€ rritet 3.94€ rruga dhe për këtë arsyе për këtë rritje nuk aplikon askush.

Durim Hajra: Unë në fillim e pasq që ishte një raport shumë i mirë ku edhe e potencova dhe isha kurioz në këtë dokument dhe e ngarkova në id dektort, ku del se 98% e këtij raporti është gjeruar me inteligjencë artificiale. Nëse Drejtoria e Arsimit, gjeneron një raport me inteligjencë artificiale për mendimit tim kjo mundet me qen skandal.

Hasan Ismajli: Zgjidhen në mënyra të ndryshme për të shkuar dhe për tu trajnuar, por nuk po e kuptoj pse po reagojnë, sepse unë kurrë asnjëherë emër këtu s'kam përmend, por ne e dimë dhe koleget atje të tyre e din se në çfarë forme kanë shkuar dhe kush shkon në trajnime. Unë nuk pata qëllim ta lëndoju askënd.

Drejtori i Arsimit: Inderuar z. Durim Hajra, mungesa ma e madhe e gjetjeve ka qen mungesa e mirëmbajtjes së Institucioneve Edukativo- arsimore sanitaria. Kontrata është në zhvillim e sipër në zyrë të prokurimit e shpallur për mirëmbajtjen e atyre hapësirave. Vitin e kaluar ju kam treguar se sa lloaptopave janë të vendosur nëpër shkolla. Ndërsa tek ‘Aneksi 3’ do ti sigurojmë këtë vit, të gjitha shkollat tjera janë të furnizuara me lloaptopa, secila klasë. Mungesa e internetit, testi pisa i cili u realizuar dje në Komunën e Fushë-Kosovës, online kreinë është një organizatë që e ka bërë lidhjen e internetit nëpër të gjitha shkollat e kontraktuar prej Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe për pesë vite Komuna e Fushë-Kosovës dhe Komunat e gjithë Kosovës, atë rrjet nuk kanë me paguar dhe pas këtyre viteve fillojmë ne me pagës. Rrjet ka sepse testi Pisa online është organizuar dje. Në mungesë të një lektore në Komunën e Fushë-Kosovës është e vërtet se korrigimi i drejtshkrimit u bë përmas inteligjencës artificiale, ndërsa shkrimi i raportit, qysh ka mundësi ta dijë chat gbt qysh ne i kemi realizuar aktivitetet e tona. Drejtshkrimi është bërë për arsyë të mungesës së lektores. Tek trajnimet, projekti për kodim, është viti i dytë që nënshkruhet marrëveshja për bashkëpunim me Organizatën Joqeveritare “Shpik”, e cila vitin e kaluar edhe në këtë vit, kemi arritur që t’ i trajnojmë më shumë se 85%, të mësimdhënësve dhe këtë projekt e udhëheq mësimdhënësi Jeton Ismajli. Nëse këta 85% janë familjar të dikujt, atëherë po u dashka të ulemi dhe të bisedojmë me Hasanin, qysh ka mundësi 85% me qen me preferenca. Atë projekt

e udhëheq pikërisht djali i juaj. Uniforma kemi provuar me përdor por s'ka dal e suksesshme. Me koordinatorin për cilësi në shkollën 'Minatori' Arben Simica, e kemi diksutuar mundësin, në mungesë të numrit të nxënësve. Vitin e kaluar në drejtimin e xehetarisë, kemi pasur numër shumë të vogël, si rezultat i hapjes së madhe të vendeve të punës a në KEK. Në këtë vit, na kemi planifikuar ta kemi një klasë edhe nëse ndodh që këtë vit mos të kemi fare numër të nxënësve. Nuk do ta mbylli si drejtim, por do të tentojmë një vit me hap, një vit jo ndërsa me e mbyllë jo.

Vlonjat Hasani: Një aktivitet i DKA-së, është bërë certifikimi i mësimdhënësve për identifikimin e nxënësve me inteligjencë të jashtëzakonshme, me dhundi dhe talente. E di se ky është në bashkëpunim me Institutin Atomi, e mbështetur nga MASHT-i, në mënyra që ata i kanë marr dhe i kanë certifikuar disa mësimdhënës të cilët do të duhej të kuptohet, që këta mësimdhënës kanë për t' i hulumtuar nxënësit me dhundi të veçantë dhe ti identifikojnë nxënësit brenda territorit të Komunës së Fushë-Kosovës. Unë deri sot nuk kam parë një hulumtim të kthjellët të pastër, të saktë, konkret se çfarë hulumtime bëjnë dhe si i përzgjedhin cilat janë kriteret? Pash që shpërndahen mjete për botuesit e librave edhe këtu nuk po shoh diçka konkretisht dhe me kriterë të veçanta. Po ashtu çështja e lektoreve brenda komunës, që ka mungesë të lektoreve. E diskutuam që ka mungesë të lektoreve edhe dje por, jemi duke folur për Drejtorin e Arsimit, Drejtoria e Arsimit hiq mos me pasur lektor, a e dini sa mësimdhënës të gjuhë dhe letërsi shqipe i kemi brenda Komunës që japid gjuhë shqipe, me këta të konsultoheshit ju ndihmojnë, mos me pas gabime. Sepse jemi duke folur për Drejtorin e Arsimit.

Pika e pestë (5) - Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për Lejimin e Mjeteve Financiare për Shërim dhe Trajtim Shëndetësor.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Dje në Komitetin për Politik dhe Financa na ka ardhur një kërkesë nga Feti Mehdi Breznica, i cili ka shkruar: Kërkoi nga ju, që të më ndihmoni, me mjetë të konsiderueshme për sëmundjen që ka prindi ynë Feti Breznica. Raportin e sëmundjes së bashku me material përcjellës e keni në kërkesë. Në Komitetin për Politik dhe Financa, një anëtare na e laboroj për këtë sëmundje, ku tregoj se kjo diagnozë është e rëndë, ku e ka kapluar komplet kokën. Zotriu ka punuar një kohë të gjatë në Komunë. Në seancën e kaluar kemi hapur një portë. Unë jam ndjerë shumë sepse një familje më ka thirrur disa herë për një kërkesë për ndihmë financiare për fëmijun dhe ne nuk kemi pasur mundësi përmes Kuvendit me i ndihmu. Unë e telefonova këtë familje pasi që u hap një derë seancën e kaluar për ndihmë financiare për shërim, por kur telefonova fatkeqësisht, fëmija kishte ndërruar jetë. Kryetari i Komunës ka thënë nëse keni mjetë në Kuvend, mundeni me marr vendime. Por, mjetet i cakton vet Kryetari, sepse është çelësi i buxhetit, në çdo kërkesë e cila ka ardhur, e kemi dërguar tek komisioni. Një komision i cili është profesional dhe varësish nga gjendja shëndetësore është subvencionuar me një shumë të mjeteve deri në 2000€, ndërsa tash e tutje ju kam njoftuar që çdo kërkesë e cila vjen në emër të Asamblesë Komunale do ta sjellë tek ju dhe në fund vendosni, a doni mi mbështet apo jo.

Laureat Gojnovci: Dje në Komitetin për Politik dhe Financa, kemi qenë një zëri, ku kemi konstatuar që raste të tillë në Komunën e Fushë-Kosovës ka shumë. Kisha kerkuar që kërkesa të tillë mos të na arrin më, për të vetmen arsyet që kemi mungesë të buxhetit, jo që nuk kemi dëshirë

të ju ndihmojmë. Ne sot do ta mbështesim, sepse kemi biseduar edhe me Drejtorin e Shëndetësisë, sepse parat do të merren nga kodi i subvacioneve për shëndetësi. Kryesues edhe një herë po ju lutem që raste të tillë mos të ta vijnë më, shkak i mungesës së buxhetit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo nuk ka të bëjë me dëshirë, kërkesa ka ardhur në Kuvend dhe unë e kam sjellë këtu.

Vlonjat Hasani: Normalisht që e mbështesim kërkesën e cila ka ardhur në Kuvend, për ndihmë financiare. Ne e kemi parë raportin e sëmundjes dhe duhet të mbështetet nga Kuvendi Komunal, sepse ka nevojë, se nëse nuk kishte pas nevojë nuk ju, nuk iu kishte drejtuar Kuvendit Komunal.

Mirsad Qyqalla: Kërkesa jonë ka qenë mos me e sjellë në Kuvend për shkak që mos të bëjmë dallime për dikën po për dikon jo. Ne kemi vendosur që çdo kërkesë e cila vjen në Kuvend ta përkrahim, sepse këtë derë e kemi hapur mbledhjen e kaluar.

Hasan Ismajli: I nderuar Kryesues, unë mendoj se nuk e ke të drejtë, kërkesat e tjera të cilat vijnë me i dërguar në Drejtorin e Shëndetësisë sepse edhe këto dy kërkesa ju kanë drejtuar Kuvendit dhe nuk e kemi problem me votua, sepse personi në fjalë ka një sëmundje të rëndë. Por, unë nuk mundem të kuptoj sepse para pak kohësh, ndoshta në vitin e kaluar i kanë sjellë dy propozime, njëra ka qenë e Hasan Krasniqit me kancer në pankreas dhe nuk ka kaluar dhe tjetra ka qenë Rajmonda Pajaziti, një vajzë 23 vjeçare, të cilën në klasën e 9-të në gjimnaz e ka sulmuar një virus në tru dhe ka mbetur në karrocë. Unë kam kërkuar dy herë dhe nuk ka kaluar ky rast, e cila ka pasur mundësi shërimi në Turqi dhe ju kanë nevojitur shuma e mjeteve prej 5000€. Asnjëri prind nuk i punon. Ky rast nuk ka kaluar ose që e ka propozuar asamblisti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ose nuk keni pasur ndjeshmërinë për një vajzë të moshës 23 vjeçare. Ndërsa, sot karrocën e shtyjnë prindërit e saj për 5000€, kurse shuma edhe më të mëdha ne kemi lënë për dreka dhe darka. Sa i përket kërkesës së Feti Breznicës, unë do ta votoj, sepse është punëtor i komunës sonë dhe ka një sëmundje të rënd. Por, çdo kërkesë tjetër duhet me sjellë, ata që mendojnë me sjellë, po dal edhe nga modestia ime, sepse para tre muajve unë e kam pasur nusen e djalit të diagnostikuar dhe unë nuk kam kërkuar deri sa kam pasur çka me shitë, i kam krye vet krejt, por njerëzit nuk kanë dhe janë në halle. Unë nuk jam për të bërë dallime sepse kam ndjerë dhimbje shpirtërorë për Rajmondën cila sot është në karrocë. Ajo vajzë është e Komunës së Medvegjës dhe ka ardhur refugjate, e nuk është etikë ajo mos të votohet, e tash vijnë raste tjera të cilat duhet me i votuar.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë jam i detyruar, t'i sjell këtu. Nëse ju Shefat e Grupeve Parlamentare me thoni sot Kryesuesi, këto raste ju duhet me i dërguar tek Komisioni i Drejtorisë së Shëndetësisë, unë automatikisht do ta përcjelli me një shkresë, në emër të Asamblesë Komunale dhe ju them referohuni tek Drejtoria e Shëndetësisë.

Bashkim Krasniqi: Kryesues, në mbledhjen e kaluar keni thënë, mos ta hapim një portë, sepse nuk do të kemi mundësi t'ia dalim. Nuk jam kundër kësaj kërkesë, por ka edhe shumë raste tek komunitetet dhe nuk përkrahen. Në seancën tjetër po me detyrohet të sjellë edhe shumë kërkesa tjera, sepse ju e keni hapur një derë. Mendoj se herën e kaluar u bë shumë politike situata.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: A është e mundur Nënkyetar që të na sqarosh këtë situatë?

Mirsad Qyqalla: Edhe ne kemi pasur kësuo kërkesash dhe për mos me sjell në këtë pozicion ekzekutivin, të gjithë e dini që është një qytetar në fshatin Bardh i Madh që ka pas një aksident

dhe e ka humbur dorën dhe këmbën, e i cili ka kontaktuar me mua dhe unë kam mundur me sjell me futë në pikë të rendit të ditës, por unë i kam propozuar që të shkon tek Nënkyetari dhe ti pyet se si i kanë mundësit buxhetore. Unë politik nuk kam bërë, e as nuk jam për të bërë. Deri para kësaj mbledhje, si i keni trajtuar i nderuar Kryesues ju këto kërkesa? Vazhdo me të njëjtën, nëse e ke mundësinë, nëse se ke mundësin sjelli këtu ti vazhdojmë. Bara bie mbi ekzekutivin, nëse i paguaj, nëse nuk paguajnë, nuk i paguajnë politikisht, sepse ne nuk humbim asgjë.

Nënkyetari i Komunës: Grupet parlamentare u deklaruan dhe besoj se është e çartë, do të jetë një vendim unanim dhe Feti Breznica do të ndihmohet. Tani dua që të ju them, Fetiu është mik i familjes sime dhe mos me keqkuptoni, sepse kemi lidhje familjare të afërt. Feti Breznica është punëtor i joni, Komuna për aq sa ka pas mundësi me përkrah në mënyrë të vazhdueshme i ka ndihmu. Komisioni për Trajtimin e Sëmundjeve është duke punuar prej mëngjesi dhe ka shumë raste me diagnoza të ndryshme. Ky vendim ju takon që ta merrni ju, në aspektin procedural besoj se gjithçka e kemi të çartë. Rregullorja thotë para se të merret një vendim, çoftë nga Kryetari apo Asamble Komunale duhet të jepet edhe mendimi mjekësor dhe pas atij mendimi deri në 2000€, nuk ka nevojë me ardhur në Kuvend, ndërsa mbi këtë shumë duhet të kaloj përmes Kuvendit, por kjo u paraparë që të kalon në Kuvend, sepse sëmundja është e rëndë. Por, nëse vazhdojmë kështu edhe në seancën e ardhshme me nda nga 5000€, buxheti do të shteret, kur të shteret buxheti pagesa do të mbetet përvitet tjera. z. Hasan Ismajli ka qen shumë insistues edhe për kolegun tonë të cilin e kemi pasur, i cili edhe është ndihmuar nga Komuna më herët dhe nuk ka qenë një person i cili nuk është ndihmuar. Personi i cili ka qenë në mbledhjen e kaluar nuk ka qenë një sëmundje por, ka qenë një aksident dhe kjo dallon. Por, unë ju kisha thënë që për rastet tjera merreni mendimin e komisionit pastaj nëse duhet me ardhë në Kuvend le të vije edhe të kalon, sepse këto dy raste nuk kanë kaluar përmes komisionit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë jam në mes të një dileme, ky Kuvend ka nxjerr vendim deri në 9.999.00€, me të drejt ligjore që është deri në 10.000.00€, kur unë kam qenë asamblist në të kaluarën, mirëpo specifikat kanë ndryshuar edhe me Udhëzimin Administrativ në shëndetësi. Unë mendoj se kjo duhet të kaloj dhe pastaj të mblidhem Shefat e Grupeve Parlamentare dhe të dalim me një vendim se si do veprojmë pastaj.

Etnik Berjani: Për këtë rast, ne mundemi me i hy në hak Feti Breznicës edhe me shumën e mjeteve prej 5000€, po a kemi mundësi ne si Kuvend me autorizua komisionin që në bazë të diagozës me caktua shumën?

Laureat Gojnovci: Unë kam komunikuar me Drejtorin e Shëndetësisë dhe Drejtorin e Financave të cilët me kanë kërkuar që shuma e mjeteve të jetë deri në vlerën prej 3000€, për mos me mbet keq tek Subvencionet e Shëndetësisë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë shpirtërisht nuk mundem me përballu këtë, mendoj se duhet me shumën e njëjtë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme pikën "Për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë" në rendin e ditës.

U votua me: unanimitet, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave, e aprovuan ‘Për lejimin e mjeteve financiare për shërim dhe trajtim shëndetësorë’, për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme.

V E N D I M

Për aprovimin e Kërkesës Nr. Nr. 02-070/05-0016665/25, të datës 12.05.2025, për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej: 5,000.00€, për shërim dhe trajtim shëndetësorë, për palën Feti Mehdi Breznica nga fshati Miradi e Epërme, i cili vuan nga sëmundja e rëndë në fazën e metastazës, me Dg: ‘Ademccatkim metastas cerolo’ dhe i duhet trajtim i vazhdueshëm intenziv shëndetësorë, për arsyen e natyrës së sëmundjes së rëndë.

Pika e gjashtë (6) - Për aprovimin e Propozimit Nr. 470, të datës 13.05.2025, për fillimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020-2028

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Besoj se debatin e kemi shterë, kemi dal edhe në televizion. Unë nuk kam asgjë për të shtuar, mirépo unë po i’ a kaloj fjalën Drejtorit të Urbanizmit, Për të na e sgruar një arsyeshmëri.

Drejtori i Urbanizmit: Përvendetje për të gjithë, para jush kam një propozim të cilin e kemi diskutuar edhe në seancën e kaluar. Unë e kam përmirësuar propozimin në aspektin teknik, tek pjesa ligjore, që të fillojmë procedurën për ndryshimin e Hartës Zonale ndryshtë mund ta quajmë revidim. Për ne është shumë e nevojshme fillimi i procedurës, me qellim harmonizimi të aspektit hapësinor, ku ne si Komunë të jemi në gjendje të afrojmë shërbime dhe t’i përkrahim zhvillimet në teren. Të arrihet një harmonizim i zhvillimit të planifikuar në të gjitha nivelet e planifikimit hapësinor, tek nisi 5 keni pikën, ku janë të renditura planifikimet në nivelin lokal dhe tri planet hapësinore, Plani Zhvillimor Komunal, Harta Zonale dhe Planet Rregullative. Komuna e Fushë-Kosovës asnjëherë në asnjë fazë, nuk i ka pasur të tri planet njëkohësisht të aprovuara edhe pse planet rregullative janë për zonat e veçanta, jo për krejt Territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, por zakonisht ka qenë një ose dy, kështu që Revidimi i Hartës Zonale apo Rishqyrtimi na garanton që për periudhën e mbetur, ta sigurojmë një zhvillim që të japim mundësi dhe të jemi të gatshëm të japim edhe shërbime sa më të sakta. Kërkoi përkrahjen e juaj për fillimin e procedurës.

Durim Hajra: Këmbëngulja për ta kaluar këtë pikë, sidomos në këtë fazë ku jemi, sinqerisht nuk ka arsyen tjetër, përveç të ndonjë interesit personal, për deri sa ka ardhur në këtë kohë, në këtë formë dhe në mënyrën që po doni me kaluar kjo pikë e rendit të ditës. I nderuar drejtor nuk e di a diskutuan në mbledhjen e kaluar, kur e vunë në pah rëndësin e këtij dokumenti, ku kolegu z. Hasan Ismajli tha se Harta zonale është Kushtetuta e Komunës së Fushë-Kosovës, ku determinohet jeta e qytetarëve për tetë vitet e ardhshme. Përveç këtyre ndryshimeve teknike dhe bazës ligjore, që ju e keni ndryshuar edhe tek pjesa e titullit që e ke bërë propozim për fillimin e procedurave për ndryshim plotësim të Hartës Zonale, unë nuk pash diçka tjetër. Kemi kërkuar që edhe në pjesën tekstuale, të na furnizoni me material shpeshtë. Nuk mundesh me thënë po e ndërrojmë dokumentin kryesor, edhe ju keni me ma dhënë votën, por nuk keni nevojë me ditë se çka. Ne nuk jemi ekspert sikurse ju drejtor dhe nuk mundemi me ditë, nuk e njohim Fushë-Kosovën në harta ashtu siç e njeh ti. Ju e keni obligim ligjor me na pajisur me material adekuat për këtë pikë të rendit të ditës. Këtu

ka interes personal dhe me doemos po tentoni me shty përparrë këtë proces. Neni 34 dhe nen 36 i udhëzimit i parashevë do procedura, po ashtu edhe ligji i parashevë disa procedura. Nuk e përmenda rastësish ligjin për tokën bujqësorë. Drejtor a i keni 2/3 e votave ashtu siç është e përcaktuar me ligji, për ta reviduar Harta Zonale? Udhëzimit Administrativ të cilit ju keni referuar edhe ju, thotë që duhet 2/3 e votave, për me të kaluar plotësim ndryshimi i hartës zonale. Në mbledhjen e kaluar nuk i patet 14 vota, sot i keni bërë 14. Arsyja kryesore pse ne e kundërshtojmë dhe e kontestojmë formën e tillë të kontrabandimit të një vendimit të kundërligjshëm, nuk është në përputhje me bazën ligjore që vet ju keni referuar. Aty shkruan kush e propozon? Forma se si kalon? Cilët janë hapat të cilët duhet të ndjekeni? Çka duhet me pas asamblisti përparrë që të mund të marr një vendim? Këto ne nuk i kemi sot. Me një propozim në këtë formë, për një dokument strategjik, qysh është harta zonale, nuk e di qysh do të votojnë sot ata asamblisti, që mendojnë me ngrit dorën për të votuar. Nëse ka zyrtar në Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, e fatmirësisht që ka, që e trajtojnë drejt dhe korrekt, në përputhje me ligjin ky vendim kthehet, edhe pse këta mendojnë me mbajt në fuqi. Këtu interes publik nuk mbrohet.

Mirsad Qyqalla: Qasja e drejtorit është duke më habitur, nuk e di çfarë presioni dhe stresi ke? Unë nuk besoj që ti je aq i pa aftë që me i sjellë kështu, sepse ato pika vetëm i ke kopjuar dhe i ke sjellë këtu. Në mbledhjen e fundit ka qenë një konkludim i përgjithshëm, ku kemi kërkuar me ditë pse do të ndryshohet harta zonale? Me na treguar ku ke me ndërhyrë? Të dimë pse ka nevojë? Ne si të afrohemë në kohë të zgjedhjeve, duhet me ndërhyrë në Hartë Zonale. Ne jemi duke folur për qytetin edhe ju një ditë keni me ec, si shumë të tjerë që nuk janë më, ky qytet ka me mbet. Nëse ka arsyeshmëri dhe bazë të mirë që i duhet qytetit shpjego i nderuar, edhe ta votojmë. Ne çdo herë po kërkojmë arsyë pse duhet të ndryshohet harta zonale? Çka ke me prek me atë hartë zonale? S'ka arsyë! Unë e them duhet me ekzistua arsyëja. Po me befason tërë ky insistim. Ju vet e dini se ky material nuk është i mjaftueshëm, është marre për një drejtori dhe ju që jeni profesionist i fushës me ta sjellë për të dytën herë një material duke iu referuar një pike, një nen i një ligji, mos me qenë në gjendje katër pyetjeve mos me ju dhënë përgjigje. Pse duhet? Ku ka me u prek? Çka ka në Fushë-Kosovë që sot është keq edhe ti me hartë zonale ke me ndryshua dhe ke me bërë më mirë? Nevoja, gjendja reale, shpjegona, cila është gjendja reale që duhet me bërë këtë ndryshim? Qëllimin po e dimë dhe është vetëm për të kërkuar vota dhe për të na e fyer inteligjencën. Kjo duhet të kaloj me 2/3 e votave. Kjo është në dëm të qytetit.

Hasan Ismajli: Propozimi që na ka ardhur sot, u cek ligji 04/L-174 të Udhëzimit Administrativ që lidhet me Udhëzimin Administrativ të 2015, dy herët e kaluar kur zotri e ka sjell në kuvend, e ka cek në propozim nenin 36, dhe kur ne i kemi thënë nen 36 pika 12 thotë votohet me 2/3 e Kuvendit i nderuari Kryesues i Kuvendit. Mbledhjen e kaluar kur unë e kam thënë, këta janë ka duan ta kontrabandojn, e vërtetoj me herët drejtori, sepse kur z. Durimi ishte duke folur në follore, dhe tha ky vendim ka me ardhur edhe një herë dhe ka me u votua me 2/3, ky tha nuk vjen kurrë dhe nuk votohet me 2/3, ndërsa kur unë i thash se këtu po shkruan, që ke me sjell edhe një herë dhe ke me votua me 2/3 tha ajo nuk vjen kurrë më. Ky tregon që nëse sot kalon, e i cili do të kaloj me pazarin të cilin e ka bërë, sepse unë e di çfarë presioni ke pas kryesues prej Bashkësisë Islame, prej myftiut dhe çfarë interesa ka pas ai unë nuk e di, apo për me vu gurë themelin në Bresje, ai

nuk ka kurfarë problemi ligjor, sepse dy herë ky Kuvend, e ka votuar atë parcelë, i' a ka ndarë Bashkësisë Islame dhe në vërejtjet tona ka qenë pyetje e njëjtë edhe e z. Mirsad Qyqallës edhe e imja, ku ju kemi drejtar drejtorit dhe i kemi thënë se a je ti ai që ke të drejt ligjore me ia lëshuar lejen Bashkësisë Islame, ky ka thënë po unë e lëshoj këtë leje. Pse nuk po ia lëshoni lejen? Pse duhet të shkosh atje në zyre tek ai për të bërë politik, për vota dhe përfushat, ku ka shkuar treshi i famshëm para disa dite në vazit dhe u dashtë të thonë, myfti kemi ardhur me ta dhënë një lajm të mirë, Kuvendi Komunal ta ka ndarë pronën. Drejtori i Urbanizmit po thotë ligjërisht kam të drejt me ta lëshuar lejen, hajde vendose gurthemelin pasnesër. Na thirrë neve si përfaqësues të partive politike dhe vijmë marrim pjesë. Nëse nuk është çështja me reviduar atë parcelë aty, atëherë mua me lë të kuptoj se këtu ka interesa personale të juajat. Ka borpjeku ndaj ndërtuesve. Ka një pjesë që ka mbet në pikën tjetër që po donë ta rregulloj dhe ju e dini shumë mirë që ajo pjesë është me Graqanicë dhe nuk mund të bësh aty asgjë, edhe pse jeni munduar, por ju kanë kthyer përgjigje se me kë është. Por, nëse ju me thoni mua, që kjo nuk vjen më me 2/3, atëherë unë ia kam qëlluar që kam thënë po donë ta kontrabandosh dhe më nuk e sjellë fare. Por, nëse i përbahesh Udhëzimit Administrativ, L-174 dhe ia nisë prej neni 34 dhe e përfundon me nenen 37 këtu ka procedura dhe tek neni 34 ku e ke bërë kopy past, thotë neni 4 ndryshim plotësimet përdoren vetëm për të përshtatur dispozitat e Hartës Zonale të Komunës si rezultat, i ndyshimeve të kushteve rishtas të identifikuara, të cilat kushte i ke identifikua. Tregonë sepse ne jemi laik, ndërsa ju jeni magjistër i kësaj lëmie. Tregonë cilat kushte i ke identifikuar, që ke me harmonizuar dhe këtu e ke shkuar në propozim. Revidimi ose fillimi i procedurave, bëhet në harmonizim, me planin zhvillimor komunal, me të cilin pyes? Sepse i riut nuk ka ardhur, pak diçka edhe ne kuptojmë dhe aty ku nuk kuptojmë pyesim, ekspertët. Nëse ju doni ta kryer këtë punë, nuk ka asnjë problem, por cila është ngutia tregonë? Cili është halli? Bëni presion atij i cili u pagua për Planin Zhvillimor Komunal, ta përgatit dhe ta sjellë këtu e votojmë Planin Zhvillimor Komunal dhe t'i filloja proceduarve menjëherë, që ta Revidosh Hartën Zonale, në bazë të Planin Zhvillimor Komunal, por ti je pjesë e atij Planin Zhvillimor Komunal dhe dyshimet e mia janë, që ju e dini se çka ka në atë Planin Zhvillimor Komunal dhe nuk ti përfshin këto që po donë me i bërë këtu. Por, koha do të tregoj, nëse ju doni me ju shkuar prej A deri në Zh këtyre proceduarave, këtij propozimi. Unë kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar, që ky Kuvend nuk ka kohë dhe nuk mbërrin me kaluar këtë Revidim të Hartës Zonale. Unë edhe një herë po kërkoj, thirreni myftiun Naim Tërrnava, bëjani për hajër dhe le të vjen ta vë gurthemelin. Lëshoja lejen sepse ke thënë fjalë këtu në Kuvend dhe mbaje fjalën sepse publikisht je i inqizuar dhe i regjistruar në ekstrakt se ti ia lëshon lejen. Mos luani me të, duke i thënë opozita nuk deshi të votoj. Është kundër fesë, jo absolut. Vetëm lëshoja lejen dhe unë do të jem prezent.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme pikën 'Për fillimin e Revidimit të Hartës Zonale në rendin e ditës.'

U votua me: katrëmbëdhjet për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim, gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të pjesëmnarrsve në votim, e aprovuan 'Për Fillimin e Revidimit të Hartës Zonale për shqyrtim në rendin e ditës për mbledhjen e sotme' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Propozimit Nr. 470, të datës 13.05.2025, për fillimin e procedurës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2020- 2028

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Aprovohet Propozimi Nr. 470, i datës 13.05.2025, për Fillimin e Procedurës për Ndryshimin dhe Plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për Periudhën 2020-2028, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 24/2015 mbi elementet dhe kërkasat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Hartës Zonale të Komunës.

Neni 2

Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Me këtë vendim përcaktohet fillimi i procedurës për dokumentin e planifikimit hapësinor - propozimi i Drejtorisë së Planifikimit Urban për Revidimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën 2020-2028, si një planë strategjik multi sektorial që përcakton objektivat afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, për periudhën e përcaktuar, në përputhje me nenin 11, paragrafi 1.7 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor.

Pika e tetë (8) - Propozimit me Nr. 471 te datës 13.05.2025 për fillimin e procedurës për Hartimin e Planit Rregullues për Zonën Urbane të Fushë-Kosovës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtim Propozimin me Nr. 471 te datës 13.05.2025 për fillimin e procedurës për Hartimin e Planit Rregullues për Zonën Urbane të Fushë-Kosovës, ftoi Drejtorin e Drejtorisë së Planifikimit Urban që ta na jap sqarime.

Drejtori i Urbanizmit: Duke u bazuar tek Ligji për Planifikim Hapësinorë dhe akti nënligjor, ka të bëjë me Hartimin e Planit Rregullativë, niveli i tret i planit hapësinor, që është kompetencë e nivelit lokal. Kompetencë e nivelit lokal është fillimi i procedurave, për të ofruar edhe shërbime për qytetarët, në planet të cilat janë në afat vlefshmërie në kohën kur po punohet. Nëse Komuna e Fushë-Kosovës nuk ka asnjë Plan Rregullativë, kjo nuk do të thotë që ne me pauzua, deri në një periudhë kur vlerëson opozita dhe pozita që është e përshtatshme për të filluar një procedurë. Kjo ndoshta mundet të përfundohet pas dy ose tri viteve, njëjtë si Plani Zhvillimor Komunal, i cili ka filluar qe tri vite dhe ende nuk është aprovuar. Ne e dimë që është në procedurën finale dhe është duke pritur pëlqim, paralelisht ne vetëm po fillojmë procedurën, po kërkoj prej Ministrisë një aprovim, pastaj arrijmë në fazën e dytë dhe kemi pët të filluar procedurën për plotësim ndryshim dhe për hartimin e planit rregullativë, ku mandej mundeni me i pa ndryshimet hartografike.

Hasan Ismajli: Përfundimi i Hartës Zonale kur të vjen, me sa vota kalon dhe kryhet Revidimi i Hartës Zonale ?

Drejtori i Urbanizmit: Kjo është çështje, të cilën e konsultojnë zyrtar ligjor. Unë e kam sjell propozimin për fillimin e procedurës. Në mbledhjen e kaluar thash, nuk po me duket e arsyeshme, të shkojmë dhe t'i fusim specifikat e ligjit edhe të udhëzimit. Ajo çka po kërkohet është të fillohet një procedurë. Nuk kemi material sepse unë nuk mundem me i paragjykuar dhe nuk kam mundësi me e sjellë pjesën grafike para jush, sepse nëse më pyet në Departamentin e Infrastrukturës unë nuk di me të treguar sepse nuk është punuar ende ajo. Plotësim ndryshimi donë punë teknike që

do të prezantohet. Do të mbahet një debat publik me qytetarët dhe do t'i kenë propozimet, kërkesat e veta. Pasi të përfundon kjo procedurë, të shqyrtohen ato kërkesa pastaj, të dërgojmë në Ministri që të aprovohet dhe prapë të kthehet në Kuvend. Këtu është një zingjirë i gjatë për të ardhur deri tek pika. Ka shumë kërkesa të cilat Drejtorit të Shërbimeve Publike, i orientohen bash për atë pjesë si: ndriçimi, rrugët, problemet me infrastrukturë. Të gjitha këto zgjidhen nëse ne e kemi një plan dhe për këtë arsy po kërkojmë propozimin për fillimin e proceduarave. Nëse unë them se ajo zonë është Zonë Kadastrale e Fushë-Kosovës, unë po e them një të vërtet, sepse kjo është gjendja. Fleta Poseduese, Certifikata e Pronësisë dhe Kopja e Planit, janë në Kadastrën e Fushë-Kosovës, nuk ekziston në Graqanicë. Kufiri në Geo Portalin RKS e ke me Fushë-Kosovë. Ndërsa, Kufiri Komunal është Graqanicë edhe ju duhet me u deklaruar me thënë që, ne mendojmë se ajo pjesë nuk duhet të trajtohet dhe nuk duhet me dhënë shërbime. Të njëjtën kohë kerkohen shërbime komunale, të infrastrukturës rrugore, kanalizimi ujësjellësi, ndriçimi dhe të njëjtën kohë për këtë çështje kaq të rëndësishme kerkohet me i dhënë konotacion për interesa personale. Unë kisha me mirëkuptuar dhe e mirëkuptoj, nëse kjo është një farë propagande politike. Nëse me të vërtet ky është mendimi i juaj, atëherë është për keqardhje. Mbledhjen e kaluar kolegu z.Hasan, Plani Zhvillimor është Kushtetutë e Komunës së Fushë-Kosovë, ashtu mendoj edhe unë sepse i trajton të gjitha fushat: arsimin, shëndetësin, infrastrukturën, destinimin e sipërfaqeve sepse ne vetëm këtu po ndalem. Por, këtu nuk është vetëm kjo fushë që po trajtohet. Atëherë nëse ai zhvillim paraprakë ka ndodhë me një Kushtetutë të Komunës, cili është arsyetimi dhe argumenti ku ne prej vitit 2020, nuk e japim më atë shërbim? Çka duhet ne me ju thënë qytetarëve për këtë çështje? Unë mendoj se është e ligjshme sepse e kam dhënë arsyetimin, Komuna e Fushë-Kosovës, ka Planë Zhvillimor Komunal i cili është në fuqi, ka hartë.

Durim Hajra: Kjo është në kundërshtim me ligjin.

Mirsad Qyqalla: Drejtor me siguri të plotë e them, që vetëm interesin e qytetarit ju këtu nuk e keni në pyetje. Të gjitha tjerat mundemi me i debatuar, por interesin e qytetarit nuk e ke. Mos provo të punosh diçka dhe me ardhë me kerkuar votën në emër të qytetarëve, duke na fajësuar neve. Unë e dëgjoja më herët nënkyetarin, kur tha Ligji për Vetëqeverisje Lokale është Kushtetutë e Komunës, në nenin 12 thotë, aktet e vendimet të cilat i merr ky Kuvend, vlejnë për territorin e kësaj komune, ndërsa ju jeni duke folur për një territor të komunës tjetër. Me pas qenë kështu e thjeshtë si ju po e bëni, nuk e kishit sjellë në Kuvend hiq, ju e kishit përfunduar vet, ashtu siç i keni kryer shumë të tjerë. Ju e dini saktësish, ty po të vyen me vendos këtu në Kuvend një bazë, për me ju ec punëve tua, sepse interes i qytetarëve është i fundit këtu. Ju thatë që po vijnë për të kerkuar shërbime. Çfarë plani të duhet kur shtatë drita t'i ka kerkuar qytetari, ke thënë se është me territor të Graqanicës. Atje qytetarët pas kësaj informate kanë filluar edhe prona me ble. Kjo nuk është në dorën tonë. Ju të gjitha këto i dini më mirë se unë, por po kërkoni paligjshmërinë, ta bëni nevojë për qytetarët edhe ne qenkemi ata për keqardhje siç e thatë me lartë. Ti i nderuar, ne jemi shumë për ata qytetar, por në bazë të ligjit të ju ndihmojmë, nuk jeni ju i thirrën për të bërë planë rregullative, për një territor të huaj, këtë kuptoje. Ndërsa, unë e di se ju jeni profesionist i fushës dhe e dini me mirë se shumica këtu, por nuk po ju konvenon. Interes personal jeni i pari ju që keni aty, sepse ne nuk e kemi asnjë interes personal aty. Shumica e qytetarëve në atë pjesë janë votues

të Partisë Demokratike të Kosovës dhe nëse është dashur me pas interes, ishte dashur ne me qenë. Por, unë nuk dua me shkel ligjin dhe nuk dua me dhënë votë për interesa të dikujt. Kjo temë u trajtua edhe në nivelin e Qeverisë së Kosovës dhe i kemi arsyet pse kjo pjesë nuk i ka takuar Komunës së Fushë-Kosovës. Je duke e ndjek të njëjtën logjik si ish-drejtori juaj. Në rregulloren e banueseve, të gjithë e dimë sigurt se kjo do të kthehet e paligjshme. Ne nuk duam me qenë pjesë e përfitimeve të askuji dhe për ata jemi kundër.

Hasan Ismajli: Me bërë një ndryshim të planit, drejtor po ndjej dhimbje, sepse me tërë njohurit profesionale të cilat i ke dhe me ra nën ndikimin e dikujt, por edhe në tëndin personal, sepse ke interesa atje, le të jetë në ndërgjegjen e juaj. A mundesh të na sqarosh, kur të bësh Planin Rregullativë, sa ka me qenë koeficienti? Si do të ia japësh lejen? Kur nuk keni qenë ju drejtor, pjesën tek xhamia, me vendim të Kuvendit, atje ku me Planë Zhvillimor ka qenë ndërtim i ulët dhe me një vendim të cilin e votuat në këtë Kuvend, kaloj me koeficientin 3.2, e kthej Ministria mbrapa dhe e detyruat këtë zonjën si Kryesuese e Kuvendit, e cila sot nuk është këtu, me mbajt katër muaj mos me e sjellë në Kuvend. Ajo trezikon tash në gjykata me dhënë përgjegjësi, sepse dokumentet kanë ndenjtë në sirtarë deri sa përfunduan interesat, u dhanë atje lejet dhe pas katër viteve e sollën dhe e shfuqizuan, por lejet për atë pjesë janë dhënë. Nëse e ke hallin ti të atyre qytetarëve andej, pse nuk e ke hallin që kur ata të vijnë në ofiqari me marr vërtetimin që është banor i Fushë-Kosovës dhe sistemi nuk e pranon, rregulloja këtë së bashku me Drejtorin e Administratës. Ata nuk munden me marrë vërtetim që janë banor të Fushë-Kosovës dhe ju doni me i fut në ndërtim, sepse e keni interesin e juaj. Unë s'po dua me ta përmend atë që e përmendi kolegu për punën e golf 2, veç unë po them ishalla ke kaluar mirë me ndërtuesin, tash që ke qenë në Gjermani, ne këtu jetojmë. Unë i njoh të gjithë me familje edhe çka ka pasur para lufte edhe tash. Po ashtu e njoh edhe ish-drejtorin tuaj, se çka ka pas edhe çka ka. E njoh edhe Kryetarin e Komunës se çka ka pas. Në prokurori janë mbi 20 lëndë dhe shkaku i atyre lëndëve, auditori i brendshëm ka shkuar në shtëpi. Këtu i ke përafërsisht 30 persona të punësuar, të cilët janë të atyre që këto lëndë i mbajnë në sirtarë. Ata të cilët kanë mbetur të trajtohen, të gjithë e kanë pas shansin sepse kur hyn në atë lagje atje është znj. Aida atje dhe fqinjët e tyre atje kanë ndërtuar, në mexhë kanë ndërtua. Ndërsa, në atë kohë nuk kanë dashur të ndërtojnë. Tash kur kanë mbet, hajde t'i trajtojmë dhe për t'i trajtuar tash kanë interesa dhe unë e di se tash votat i ke, keni bërë pazar, e keni listën serbe, e cili u 'a voton.

Nënkryetari i Komunës: Po dua me i diskutuar dy çështje. Po e shtroj në formë të pyetjes, të parën a mund të bëhet kjo deri sa kemi një Planë Zhvillimor, në proces e sipër dhe çështja e dytë është kjo që po flasim, a është në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, sepse ligji për Vetëqeverisje Lokale na ka dhënë mundësin që të flasim për territorin e Komunës së Fushë-Kosovës dhe jo për komunat e tjera. Sa i përket Planin Zhvillimor Komunal, do të vijë në Kuvend ose këtë legjislaturë ose tjetrën. Ligji për Vetëqeverisje Lokale, ka thënë vetëm në territorin tënd. Ligji për Kufijtë Administrativ, për çështjen që po flasim është territor i Komunës së Fushë-Kosovës, ligji për Kufijtë Administrativ i miratuar në Parlamentin e Kosovës, paketa e Ahtisarit është në territor të Komunës së Fushë-Kosovës, po ua them me kompetencë të plotë. Unë po flasë për territorin e Komunës sime dhe po ju them, çka ka kontestuese. Po është e saktë, kemi ardhur në situata, kur kjo tokë është bërë kontestuese. Nëse e trajton sipas sistemit të adresave të bërë në

vitin 2018, është Graqanicë, nëse e trajton sipas kufijve të miratuar në Parlamentin e Republikës së Kosovës, nëse e trajton sipas Ligjit Kadastral është Fushë-Kosovë, nëse e trajton sipas Ligjit të Arsimit është Fushë-Kosovë. Ne ofrojmë për të vazhduar një pjesë të ofrimit të Komunës së Fushë-Kosovës edhe në këtë territor përfshirë shkollën. Jemi në një situatë ku duhet t'i japim përgjigje kësaj pune. Zgjidhja përfundimtare e kësaj pune nuk është Asambleja Komunale jo kryetari Burim Berisha, nuk mundet me ia dhënë Kryetari i Gracanicës e as Asambleja e Komunës së Graqanicës. Ne mundemi vetëm të kontribuojmë. Përveç që kemi dërguar letra dhe harta, që i kemi thënë Agjencionit Kadastral i ke gabim, përveç që kemi dërguar letra në Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me gjithat, çështja mbetet e kontestuar. Ne po japim zgjidhje përmes këtij dokumenti dhe po themi ne po duam ta trajtojmë si territor të komunës sonë, sepse kemi dhjetëra argumente, përfshirë ligjet dhe paketën e Ahtisarit dhe përfshirë shërbimet që jetojnë aty, është territor i Komunës së Fushë-Kosovës. Argumentet që nuk është territor, është pala tjeter, i dorëzojnë aty ku duhet, në Qeveri, në Parlament. Qeveria thotë ma keni sjellë këtë dokument të miratuar. Jeni dalë jashtë territorit të Komunës së Fushë-Kosovës, është territor i Graqanicës. Ne nuk kemi më para me për të ju paguar shkollat prej buxhetit tonë. Nuk kemi para për të paguar shërbimet e tjera aty. Nuk kemi më çka të paguajmë, por po ju them edhe një, se ne dje kemi marr çarkoren buxhetore për vitin 2025 dhe kemi dy lajme të mira. Lajmi i parë që edhe aty është Territor i Komunës së Fushë-Kosovës, prej Ministrisë së Financave. Lajmi i dytë mund të ketë ndonjë interes personal, por besoni se ka një interes shumë të madh publik. 25 milion buxhet i Komunës së Fushë-Kosovës e keni bërë ju, unë këtë e kam gjete të gatshme.

Aida Alimi: Për arsyet e konfliktit të interesit nuk marr pjesë në votim.

Mirsad Qyqalla: Inderuar Kryetar këtë hartë e kam nxjerr në kompjuter, nuk e kam bërë unë, kjo pjesë në të cilën po fol drejtori është territor i Graqanicës'. Unë e di se ky problem ka shkuar deri tek kryeparlamentari kur ka qenë i yni, ka shkuar ky problem dhe argumenti kryesor ka qenë që mos të bëjmë ndarje etnike, me përdor si model Graqanicën' pastaj të shkoj i njëjtë problem në Mitrovicë. Unë e kam edhe një pyetje, sa i përket qytetit dhe ndërtimit. Kemi botëkuptime të ndryshme, ju i keni do numra të cilët janë real, e di që qëndrojnë. Kjo është një rrugë të cilën e ka ndjek kjo Komunë. Unë e di se me pas punuar më shumë, këtë buxhet e kishim edhe ma të mirë dhe më të zhvilluar. INSI kur ka qenë prezent, Hartën Zonale të cilën e kemi ekzistuese, pikërisht këtë zonë. Për këtë arsy, mbledhjen e kaluar e prezantoj edhe drejtori. Ta ka lënë pa ngjyrë, sepse nuk e ka marr të drejtën, për të hyrë me e bë Hartën Zonale, për këtë pjesë për shkak se e ka ditur që nuk ka të drejtë. INSI në të gjitha komunat e përgatit Planin Zhvillimore Komuna. Drejtor ju keni qenë prezent kur unë ia kam parashtruar këtë pyetje, sepse ju i'a keni bashkëngjitet atë pjesë edhe këtu ka qenë përfaqësuesi i INSI-të. Kur unë kam pyet a është kredibil Agjencionit Kadastral, me ta sjellë një dokument të cilin jeni thirr ju, përfaqësuesi i INSI-të ka thënë jo, nuk e ka atë drejtë. Në momentin që e dërgon në ministri kanë për ta kthyer dhe drejtori nuk reagoj. Në momentin kur ke të drejtë, dil ballafaqohu me profesionistë të fushës. Prapë kur e kam pyetur, e pse ju bëni Plane Zhvillimore, për një komunë tjeter, për një drejtor tjeter? Përgjigjja e tij ka qenë unë punë e kam. Arsyja pse INSI ta ka lënë atë fushë të pambuluar është pikërisht për të mos e kthyer Ministria të paligjshme, sepse i kalon edhe Vijat Administrative Komunale. Unë e di

nënkyetar që është një shkollë e dimë se qysh funksionon, e dimë që është me leje të Komunës së Fushë-Kosovës, fëmija tonë shkojnë atje. Unë po them veç adresa për me bërë planë, këtu nuk është adresa e duhur Kuvendi Komunal i Komunës së Fushë-Kosovës. Nëse do të varej prej neve i kishit pas votat tona çdo here, por unë jam i sigurt që kjo punë nuk varet prej neve dhe jam e sigurt se kjo do të kthehet e paligjshme, nëse ka transparencë kur nënshtrohet ky vendim në ministri.

Hasan Ismajli: Nënkyetar, ju thatë që kjo pjesë shkon me Fushë-Kosovë. E përmende edhe çarkorën buxhetore, kjo kompania e cila është duke e bërë edhe Planin Zhvillimor Komunal edhe ka marr para. E ka bërë Hartën Zonale dhe në Hartë Zonale nuk është trajtuar ajo pjesë. Të njëjtën e ke tash që je Anëtar i Komisionit, për Planin Zhvillimor Komunal dhe pyes: A e ka përfshi ky Planë Zhvillimor atë pjesë andej? A je duke punuar për ata banorë, që ata banorë të pajisen me certifikata të vendbanimit në Fushë-Kosovë.

Nënkyetari i Komunës: Ne nuk mundemi të lëshojmë certifikata, sepse sistemi i adresave u bë në vitin 2018, po i trajton si Komunë e Graqanicës. Unë i solla disa argumente pro dhe kundër që varësish nga sektori dhe varësish nga lloji i shërbimit, kjo pjesë e territorit herë po trajtohet Fushë-Kosovë herë Graqanicë. Dëshirojmë ne si anëtar të Fushë-Kosovës, të luftojmë bashkarishtë, që nëse kemi bazë ligjore dhe argumente të jetë një pjesë e Komunës së Fushë-Kosovës, apo kemi interes publik që kjo pjesë të jetë në territorin e Graqanicës dhe kjo popullatë e populluar me shumicë shqiptare të kontribuoj në çështjet demografike, që lidhen me Komunën e Graqanicës. Unë si Nënkyetar i Komunës, do të luftoj gjithmonë që Komuna e Fushë-Kosovës të prosperoj të ketë më shumë para, të ketë më shumë territor dhe të luftojmë edhe për këtë territor që të jetë pjesë e jona. Ne njëfarë mënyre po bëjmë një lloj provokimi që të na kthehet një përgjigje përfundimtare. Nëse nuk është pjesë e Komunës së Fushë-Kosovës, le të ia dërgojnë krejt Graqanicës, por nuk mundemi me i lënë ata banorë në mëshirë. Ky dokument do ta sjell një provokim të ri, që ne me pa a kanë me kthyer përgjigje. Unë kam qenë në një tryezë ku kam diskutuar për Planin Zhvillimor Komunal dhe ka pas një debat rreth kësaj, kur kemi ardhur tek kjo pikë dhe pyetja jonë ka qenë. A është Plani Zhvillimor Komunal i Graqanicës me qenë se ata kanë ecur para nesh, përgjigjja ka qenë jo, nuk është. Nëse nuk janë me Graqanicë me ke qenka ky territor që po flasim, ky territor me një planë nuk mundet me qenë, mundet me qenë, tash ose me Fushë-Kosovën ose me Planin Zhvillimor të Prishtinës, në Prishtinë nuk është, e besoj se do të jetë me Fushë-Kosovë dhe ne kemi insistuar edhe tek Plani Zhvillimor, që me të gjitha argumentet të dorëzon një Planë Zhvillimor që përfshinë edhe këtë pjesë të territorit në propozim. Përveç kësaj, unë së bashku me Drejtoren e Urbanizmit, kemi bërë takime në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, para se ta dorëzojmë, pasi e kemi dorëzuar. Po ashtu edhe dy takime këtu, kemi takuar edhe Ministrinë e Bujqësisë dhe po provojnë që të japim argumentet që këtij territori duhet me ia lënë emrin, sepse nuk bënë me lënë më kështu, sepse qytetaret vijnë çdo ditë në Komunë dhe kanë të drejtë, por ne duhet si politikan që të luftojnë me dhënë një përgjigje përfundimtare. Ne po fillojmë procedurat, le të shkon në ministri dhe nëse nuk është në rregull ata e kthejnë dhe Kryesuesi e sjell në Kuvend, ashtu siç vepron çdo herë.

Drejtori i Urbanizmit: Dua të ndërlidhem me pyetjen e Mirsadit, unë nuk vazhdoj të lëshoj leje, sepse nuk kam planë dhe nuk kam koeficient. Nuk është puna se territori i kujt është, por mua me vyen një Planë Hapësinor i cili përcakton vlerat numerike, për me të mundur me dhënë kushte ndërtimore. Për derisa unë nuk e kam atë planë, unë po duhet me hy në fillimin e procedurës për ta hartuar një planë. Përndryshe edhe argumentin se nëse INSI ka thënë kështu ose ashtu, nuk e kisha marr si referencë, sepse duhet me pasur parasysh se ai, që është i kontraktuar shikon edhe procesin vetvetes me ia lehtesar, për ta krye kontratën, ajo është me procedurë të prokurimit dhe unë nuk e kam përzgjedhur INSI-në. Nëse INSI ka thënë ashtu dhe unë nuk kam reaguar, unë ju them se kam reaguar përmes e-maili zyrtar edhe ajo pjesë në Planin Zhvillimor Komunal është trajtuar. Nëse ai ka tendencë me ia lehtesar procesin vetes si procedurë, kjo nuk ka qenë tendencia ime, kështu që mos e merrni si referencë.

Pas sqarimeve Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, e hodhi në votim për shqyrtim në mbledhjen e sotme pikën 'Për Fillimin e Procedurave për Hartimin e Planit'.

U votua me: katërmëdhjetë për, kundër nuk ka dhe asnjë abstenim. Gjithsej njëzet e gjashtë anëtarë të pranishëm në mbledhje.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, konstatoi se Anëtarët e Kuvendit të Komunës me unanimitet të votave të pjesëmarrësve në votim, e aprovuan 'Për Fillimin e Revidimit të Hartës Zonale për shqyrtim rendin e ditës për mbledhjen e sotme' dhe mori:

V E N D I M

Për Aprovimin e Propozimit me Nr. 471 te datës 13.05.2025 Për Fillimin e Procedurës
për Hartimin e Planit Rregullues për Zonën Urbane të Fushë-Kosovës

Neni 1 - Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinorë

Për aprovimin e Propozimit me Nr.471, të datës 13.05.2025 për Fillimin e Procedurës për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për pjesën e Zonës Urbane të Fushë-Kosovës, që përfshinë ngastrat kadastrale në mes të rrugës 'Gjergj Fishta' dhe rrugës së 'Uglarit' për blloqet e banimit; E5, E6, E7, E18, E19, E20 dhe E21, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikimin Hapësinorë Nr. 04/L-174 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2018 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

Neni 2 - Përkufizimi i Dokumentit të Planifikimit Hapësinorë

Me këtë vendim përkufizohet dokumenti i planifikimit hapësinorë - Fillimi i Procedurës për Hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për Pjesën e Zonës Urbane të Fushë-Kosovës, që përfshinë ngastrat kadastrale në mes të rrugës 'Gjergj Fishta' dhe rrugës së 'Uglarit' për blloqet e banimit; E5, E6, E7, E 18, E19, E20 dhe E21 dhe përcakton kushtet për rregullimin e hapësirave për Zona Urbane apo Zona Rurale si çështje të përcaktuara me dokumentet e planifikimit hapësinor.

Pika e nëntë (9) - Të ndryshme


Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Tani jemi në pikën 'Të ndryshme', ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë çështje për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 16:20 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevcı



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Ali Ismaili

